STUDIM HULUMTUES

NJË ANALIZË E NDËRHYRJEVE DHE ARRITJEVE TË PROJEKTEVE TË NDRYSHME QË MBËSHTESIN PËRFSHIRJEN NË ARSIM TË DJEMVE DHE VAJZAVE ROMË, ASHKALI DHE EGJIPTIANË



INCLUDE – Ngritja e Kapaciteteve për Gjithëpërfshirje në Arsim

Tetor 2020

Funded by the European Union and the Council of Europe

EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE

CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented by the Council of Europe

Përgatitur nga Prof Dr Petra Roter dhe Znj Hana Zylfiu-Haziri

Ky publikim është përgatitur në kontekstin e projektit "INCLUDE - Ngritja e Kapaciteteve për Gjithëpërfshirje në Arsim" me mbështetje financiare të Bashkimit Evropian.
Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk i pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian ose Këshillit të Evropës.

© Këshilli i Evropës, tetor 2020. Të gjitha të drejtat e rezervuara.
Licencuar në Bashkimin Evropian me kushte.
Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të përkthehet, riprodhohet ose transmetohet, në asnjë formë ose në asnjë mënyrë, elektronike (CD-ROM, Internet, etj.) ose mekanike, duke përfshirë fotokopjimin, regjistrimin ose ndonjë sistem të ruajtjes ose rikthimit të informacionit, pa lejen paraprake me shkrim nga Drejtoria e Komunikimit (F-67075 Strasbourg Cedex ose publishing@coe.int).

Të gjitha kërkesat në lidhje me riprodhimin ose përkthimin e tërë dokumentit ose të një pjese të tij duhet t'i drejtohen Drejtorisë së Komunikimit. E gjithë korrespondenca tjetër në lidhje me këtë publikim duhet t'i drejtohet Departamentit të Arsimit, Divizionit për Bashkëpunim dhe Ngritje të Kapaciteteve të Këshillit të Evropës.

Departamenti i Përgatitjes së Publikimeve i Këshillit të Evropës (SPDP) nuk është përgjegjës për faqosjen dhe e as përmbajtjen e tij.

Cover image credits: Andrey Popov/shutterstock.com

Tetor 2020

Tabela e përmbajtjes

1 Hyrje 4
1.1 Problemi i hulumtimit dhe qëllimet e Studimit hulumtues 4
1.2 Struktura dhe metodologjia për Studimin hulumtues 5

2 Vlerësimi i kontekstit shoqëror, ligjor dhe institucional 6
2.1 Një kornizë ligjore për arsimin gjithëpërfshirës cilësor për të gjithë: standardet thelbësore ndërkombëtare dhe dokumentet kombëtare 6
2.2 Arsimi gjithëpërfshirës në një shoqëri të larmishme: rëndësia e tij për personat që u përkasin komuniteteve kombëtare ose etnike, fetare ose gjuhësore dhe për integrimin shoqëror 8
2.3 Gjendja e përgjithshme në nivele të ndryshme të arsimit, e rëndësishme për përfshirjen e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë dhe për synimet strategjike 13

3 Analiza e të gjitha raporteve përkatëse, ndërhyrjeve dhe arritjeve të bëra nga projekte të tjera të financuara nga donatorë ose organizata të shoqërisë civile në lidhje me gjendjen e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm 18
3.1 Peizazhi i projektit 18
3.1.1 Çështjet e mbuluara 18
3.1.2 Fushëveprimi gjeografik i projekteve 26
3.1.3 Kohëzgjatja e projekteve dhe vazhdimësia 27
3.1.4 Donatorët dhe fokusi i tyre specifik 27
3.1.5 Aktorët lokalë të përfshirë (implementimi i projekteve) 29
3.1.6 Përfituesit (numri, përfitimet, kohëzgjatja) 29
3.2 Vlerësimi i përgjithshëm i fushëveprimit të projekteve të financuara nga donatorët dhe i ndërhyrjeve të tjera në fushën e arsimit të fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë nga nivelet parafillore në ato të mesme 31

4 Analizimi i qëllimeve të projekteve, sukseseve (praktikave të mira), vështirësive dhe pengesave 32
4.1 Praktikat e mira dhe pengesat në arritjen e qëllimeve të projekteve 32
4.2 Mësimet e nxjerra dhe hendeqet që mungojnë 34

5 Anketa në lidhje me qëndrimet e shkollave ndaj aspekteve të ndryshme të arsimit cilësor gjithëpërfshirës 37
5.1 Metodologjia dhe mostrat 37
5.2 Gjetjet dhe analizimi i tyre 38
5.2.1 Perceptimet e nxënësve për gjithëpërfshirjen sociale në shkollë 38
5.2.2 Mësimdhënësit 39
5.2.3 Drejtorët e shkollave 40
5.2.4 Përfaqësuesit e komunave 41
5.2.5 Përfaqësuesit e qendrave mësimore 43
5.2.6 Zyrtari për komunitete i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës 46

6 Përfundime dhe rekomandime për autoritetet përkatëse 47

1 Hyrje

1.1 Problemi i hulumtimit dhe qëllimet e Studimit hulumtues

Përkundër shumë projekteve për të ndihmuar personat që u përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të kenë qasje në arsimin gjithëpërfshirës cilësor dhe përfundimin e tyre të suksesshëm të arsimit në të gjitha nivelet, ata persona ende përballen me shumë pengesa dhe ata arrijnë nivele disproporcionalisht më të ulëta të arsimit sesa bashkëmoshatarët e tyre që i përkasin popullatës shumicë.[1] Shkalla e braktisjes së shkollës vazhdon të jetë e konsiderueshme, dhe arsimi në përgjithësi është në nivel më të ulët. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) ka raportuar se ka pasur një përmirësim të vazhdueshëm në atë që "braktisja e shkollës nuk është më një problem sistematik" dhe ka një trend pozitiv në vijueshmërinë e shkollës së mesme, i ndihmuar me bursa nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT).[2] Sidoqoftë, hendeku i përgjithshëm në arsim vazhdon, gjë që reflektohet në përfshirjen e dobët të personave që u përkasin tri komuniteteve në tregun e punës.[3] Si autoritetet në nivele të ndryshme (qeveria dhe autoritetet komunale)[4] ashtu edhe shumë akterë të tjerë (veçanërisht donatorë ndërkombëtarë dhe organizata zbatuese ndërkombëtare dhe kombëtare) kanë kërkuar adresimin e këtyre problemeve për vite me radhë. Për më tepër, shoqëria civile është përfshirë shumë, duke marrë përsipër shpesh përgjegjësinë për të adresuar hendekun në rezultatet arsimore (jo vetëm për nivelin e arritur të arsimit, por edhe për pjesëmarrje më të mirë dhe përvetësim të rezultateve të mësimnxënies) të personave që u përkasin komuniteteve 'të cenueshme/të margjinalizuara', ku cenueshmëria/margjinalizimi mund të shoqërohet me një hendek në të dhënat e matshme midis popullatës së përgjithshme dhe atyre komuniteteve, si dhe me perceptimet dhe ndjenjat e pafuqisë, neglizhimit afatgjatë dhe të një paaftësie të perceptuar për të luftuar në mënyrë aktive për barazi.[5]

Shumë projekte - shih listën jo të plotë të projekteve që mbulojnë (edhe) arsimimin e personave që u përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Shtojcën I - kanë ndihmuar në adresimin individual të shumë prej këtyre çështjeve. Sidoqoftë, kuptohet që shumica e projekteve kanë pasur fushëveprim të kufizuar të zbatimit, qoftë gjeografikisht (duke mbuluar disa komuna), nivelet e arsimit ose në aspektin e çështjeve të adresuara, si dhe kohëzgjatjen e aktiviteteve. Megjithëkëtë, një progres - në të vërtetë, në disa raste progres i konsiderueshëm - është arritur edhe për shkak të këtyre projekteve, por çështjet e përgjithshme të pabarazisë sa i përket qasjes efektive në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës dhe rezultateve të barabarta arsimore për personat që u përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian mbesin për t'u adresuar. Ky studim hulumtues kërkon të ndjekë dy qëllime hulumtimi:

- së pari, ai kërkon të shqyrtojë projektet ekzistuese (të kaluara dhe aktuale) në këtë fushë nga perspektiva e përcaktimit të asaj që kanë mbuluar projektet, çfarë ka funksionuar mirë, cilat çështje janë adresuar me sukses dhe në çfarë mase (në aspektin e fushëveprimit gjeografik dhe personal, si dhe në cilat nivele të arsimit dhe duke mbuluar cilat çështje problematike), dhe cilat probleme janë hasur gjatë implementimit të atyre projekteve

1 OSBE: Pasqyra e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, 2020.

2 *Po aty*., f. 5.

3 Perspektivat e të rinjve rom, ashkali dhe egjiptian mbi mundësitë dhe sfidat për punë të denjë në Kosovë, 2018, Kapitulli 3.

4 Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian jetojnë kryesisht në 24 komuna të Kosovës, ku ata janë prezent në mënyrë më të konsiderueshme në komunat e Ferizajt, Fushë Kosovës, Gjakovës, Pejës dhe Prizrenit. Shih OSBE: Pasqyra e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, 2020, f. 4.

5 Me ekzistimin e perceptimeve të tilla, të cilat tentojnë të stimulohen edhe nga mungesa e modeleve nga vetë komuniteti, në mesin e të rinjve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, shih Perspektivat e të rinjve rom, ashkali dhe egjiptian mbi mundësitë dhe sfidat për punë të denjë në Kosovë, 2018, f. 43.

dhe më pas (pasi të kenë mbaruar projektet - d.m.th. çfarë mund të shihet në lidhje me qëndrueshmërinë e atyre arritjeve);

- së dyti, ai kërkon ta krijojë kornizën për zbatimin e projektit të përbashkët BE/KiE "Ngritja e Kapaciteteve për Gjithëpërfshirje në Arsim - INCLUDE" në mënyrë më efikase, duke siguruar hendeqet që mungojnë në peizazhin relativisht të dendur të projekteve të përqendruara në arsim dhe duke realizuar një anketë fillestare me palët përkatëse të interesit në fushën e arsimit me qëllim të përcaktimit të pengesave ekzistuese për përfshirjen e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në arsim dhe për arritjen e barazisë në aspektin e rezultateve arsimore - d.m.th. të sigurojë qasje në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për personat që u përkasin komuniteteve të cenueshme/të margjinalizuara në përgjithësi.

1.2 Struktura dhe metodologjia për Studimin hulumtues

Studimi hulumtues është kryer duke përdorur një kombinim metodash të ndryshme hulumtimi. Hulumtimi sekondar që përqendrohet në analizën e burimeve përkatëse primare synon së pari të shpjegojë **kornizën ndërkombëtare** për arsimin gjithëpërfshirës cilësor dhe ta paraqesë gjendjen e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në arsim (në Hyrje) duke u mbështetur në të dhënat ekzistuese statistikore dhe informacionin në dispozicion në dokumente të ndryshme (mbi të gjitha, në raportet e projekteve dhe burimet dytësore). Një analizë dhe interpretim i hollësishëm i dokumenteve përkatëse primare përdoret më pas për të paraqitur **kornizën institucionale dhe ligjore** për arsimin gjithëpërfshirës. Kjo përfshin analizën e standardeve ndërkombëtare si dhe analizën ligjore të kornizës ligjore arsimore për arsimin gjithëpërfshirës në Kosovë* dhe analizën e standardeve ndërkombëtare për menaxhimin e diversitetit. Kjo e fundit është e nevojshme pasi rezultatet e arsimit gjithëpërfshirës në një shoqëri të larmishme do të varen gjithashtu nga qëndrimet e gjera shoqërore ndaj diversitetit dhe organizimit të sistemit arsimor sa i përket menaxhimit të diversitetit. Kjo analizë bazohet në supozimin se konteksti ligjor, institucional dhe shoqëror duhet të kuptohet plotësisht për zbatimin efektiv të arsimit gjithëpërfshirës për personat që u përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe atyre që u përkasin të ashtuquajturave "komunitete të cenueshme/të margjinalizuara". Pjesa e parë e këtij studimi analizon kështu kontekstin brenda të cilit të gjithë individët marrin arsim cilësor - d.m.th. kanë qasje në arsim dhe mund të arrijnë rezultate të barabarta arsimore.

Me qëllim të **analizimit të projekteve përkatëse arsimore** (siç renditen në Shtojcën I), hulumtimi sekondar pastaj përfiton nga një analizë e hollësishme dhe sistematike e dokumenteve (kryesisht raportet e projekteve) dhe e materialeve të tjera. Ky seksion synon të përcaktojë atë që është arritur nga arsimi gjithëpërfshirës cilësor, atë që ka dhënë rezultate të dëshiruara dhe se cilat ishin pengesat me të cilat u përballën shumë projekte të zbatuara për këtë qëllim nga aktorë të ndryshëm (shih Shtojcën I).

Analiza e projekteve të kaluara ndiqet nga **analiza empirike e qëndrimeve** të palëve të mundshme të interesit të projektit INCLUDE. Në mënyrë të veçantë, janë realizuar një sërë intervistash gjysmë të strukturuara dhe intervista në fokus grupe me palët e interesit të përfshira në këtë temë (ku lista e të intervistuarve është përpiluar gjatë hulumtimit sekondar të të gjitha projekteve përkatëse). Së fundmi, Studimi hulumtues shqyrton nga afër pikëpamjet dhe qëndrimet e palëve të ndryshme të interesit si për arsimin gjithëpërfshirës ashtu edhe për projektet e ndryshme të kryera për këtë qëllim. Është kryer një anketë parësore, megjithëse fushëveprimi dhe mënyra e saj në të cilën është kryer është dashur të përshtatet me pandeminë (për të shmangur kontaktet personale të rrezikshme). Studimi ka synuar të mbulojë komunat më të rëndësishme të zgjedhura ku jetojnë

* Ky përcaktim është pa paragjykuar pozicionet rreth statusit, dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të KS të OKB-së dhe opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

romë, ashkali dhe egjiptianë dhe të gjitha nivelet e arsimit të përfshira në projektin INCLUDE. Faktorë të tjerë të diversitetit janë marrë gjithashtu parasysh (grupmosha të ndryshme dhe gjinia e mësimdhënësve, si dhe përvoja e tyre e ndryshme me diversitet në shkolla). Për më tepër, stafi tjetër në shkollë (në sektorin arsimor) është përfshirë në anketë, mbi të gjitha drejtorët e shkollave, punëtorët e tjerë pedagogjikë, si dhe edukatorët në institucionet arsimore joformale (siç janë qendrat mësimore) dhe përfaqësuesit e autoriteteve (MASHT-i).

Bazuar në të gjitha këto lloje të ndryshme të të dhënave, seksioni përfundimtar i Studimit hulumtues përfshin **rekomandime** për autoritetet pasi ato mund të nxirren nga ky studim.

2. Vlerësimi i kontekstit shoqëror, ligjor dhe institucional

Qëllimi i këtij kapitulli është të analizojë kontekstin në të cilin do të kryhet arsimi gjithëpërfshirës, me fokus në analizimin e pengesave të ndryshme për arsimin gjithëpërfshirës të fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në përgjithësi, dhe në Kosovë në veçanti. Ky kapitull së pari përqendrohet në kornizën ligjore ndërkombëtare për arsimin gjithëpërfshirës cilësor për të gjithë. Kapitulli pastaj i vë këto standarde në kontekstin e qasjes në arsimin gjithëpërfshirës cilësor të personave që u përkasin 'komuniteteve të cenueshme/të margjinalizuara', përfshirë komunitetet cenueshmëritë e të cilave janë komplekse (p.sh. të ashtuquajturat pakica të dyfishta - kombëtare dhe socio-ekonomike). Ai më pas paraqet një përmbledhje të shkurtër të treguesve të arsimit që demonstrojnë hendeqet në arsim midis popullatës në përgjithësi dhe komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, dhe përgjigjet e politikave nga autoritetet për të zvogëluar mospërputhjet dhe për të reduktuar ato hendeqe.

2.1 Një kornizë ligjore për arsimin gjithëpërfshirës cilësor për të gjithë: standardet thelbësore ndërkombëtare dhe dokumentet kombëtare

E drejta për arsimim është një e drejtë themelore e njeriut. Kjo normë ndërkombëtare është përfshirë në të gjitha instrumentet thelbësore globale dhe rajonale të të drejtave të njeriut, përfshirë Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (1948, Neni 26), Konventa e UNESCO-s kundër Diskriminimit në Arsim (1960/1962), Pakti Ndërkombëtar për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1966/1976, nenet 13–14), Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (1989/1990, Neni 28) dhe Protokolli (i parë) i Konventës (Evropiane) të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (1952/1954, Neni 2). Kjo e drejtë ka evoluar me kalimin e kohës në një normë ndërkombëtare komplekse që bazohet në detyrën e shteteve (d.m.th. autoriteteve të tyre në të gjitha nivelet) për të siguruar **qasje** të plotë, falas dhe të barabartë **në arsim** (në formën e arsimit fillor falas dhe të detyrueshëm për të gjithë, arsimit të mesëm të qasshëm me një futje progresive të arsimit falas edhe në nivelin e mesëm, dhe me arsim të lartë barabartë të qasshëm në bazë të meritës) dhe **detyra për të parandaluar diskriminimin në arsim**.

E rëndësishmja, e drejta për arsimim si e drejtë themelore e njeriut "mund të ushtrohet plotësisht vetëm nëse arsimi është i cilësisë adekuate", siç vuri në dukje Komiteti i Ministrave (KM) i Këshillit të Evropës (KiE) në vitin 2012.[6] Vetëm arsimi cilësor mund të sigurojë që shoqëritë të zhvillohen dhe individët të realizojnë plotësisht potencialet dhe ambiciet e tyre. Arsimi cilësor është përkufizuar si arsim që:[7]

6 Rekomandimi CM/Rec(2012)13 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për sigurimin e arsimit cilësor. Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 12 dhjetor 2012; tani e tutje si CM/Rec(2012)13.

7 Cm/Rec(2012)13, para. 6.

a. u ofron mundësi për mësimnxënie të gjithë nxënësve, veçanërisht atyre në grupe të cenueshme ose të pafavorizuara, i përshtatur për nevojat e tyre kur është e përshtatshme;
b. siguron një mjedis mësimnxënie të sigurt dhe jo të dhunshëm në të cilin respektohen të drejtat e të gjithëve;
c. zhvillon personalitetin, talentet dhe aftësitë mendore dhe fizike të secilit nxënës, në potencialin e tyre të plotë dhe i inkurajon ata të përfundojnë programet arsimore në të cilat regjistrohen;
d. promovon demokracinë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe drejtësinë sociale në një mjedis mësimnxënie i cili njeh të mësuarit dhe nevojat shoqërore të gjithsecilit;
e. u mundëson nxënësve të zhvillojnë aftësitë e duhura, vetëbesimin dhe mendimin kritik për t'i ndihmuar ata të bëhen qytetarë të përgjegjshëm dhe ta përmirësojnë aftësinë e tyre për punësim;
f. ua bart vlerat kulturore universale dhe lokale nxënësve ndërsa i pajis ata me aftësi edhe për të marrë vendime vetë;
g. certifikon rezultatet e mësimit formal dhe joformal në një mënyrë transparente bazuar në vlerësimin e drejtë duke bërë të mundur njohjen e njohurive dhe kompetencave të fituara për studime të mëtejshme, punësim dhe qëllime të tjera;
h. mbështetet në mësimdhënës të kualifikuar të cilët janë të përkushtuar për zhvillim të vazhdueshëm profesional;
i. nuk ka korrupsion.

Arsimi cilësor presupozon **arsim gjithëpërfshirës** dhe shtrihet përtej thjesht qasjes në arsim. Një arsim i tillë do t'i përgatisë nxënësit për qytetari demokratike dhe kulturë demokratike, aktivitet ekonomik dhe për aftësi në dialog ndërkulturor. Për më tepër, zhvillimi i qëndrueshëm varet nga arsimi cilësor, i cili është përfshirë si qëllimi i katërt i zhvillimit të qëndrueshëm në Agjendën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, në të cilin vendet anëtare të OKB-së u zotuan të:[8]

> sigurojnë arsim gjithëpërfshirës dhe me cilësi të barabartë në të gjitha nivelet - trajnim për fëmijëri të hershme, trajnim për arsim fillor, të mesëm, terciar, teknik dhe profesional. Të gjithë njerëzit, pavarësisht nga gjinia, mosha, raca ose etnia, dhe personat me aftësi të kufizuara, emigrantët, popujt indigjenë, fëmijët dhe të rinjtë, veçanërisht ata në situata të cenueshme, duhet të kenë mundësi të mësojnë gjatë gjithë jetës që i ndihmon ata të fitojnë njohuri dhe shkathtësi të nevojshme për të shfrytëzuar mundësitë dhe për të marrë pjesë plotësisht në shoqëri. Ne do të përpiqemi t'u sigurojmë fëmijëve dhe të rinjve një mjedis ushqyes për realizimin e plotë të të drejtave dhe aftësive të tyre, duke i ndihmuar vendet tona të korrin dividentin demografik, përfshirë përmes shkollave të sigurta dhe komuniteteve kohezive dhe familjeve.

Prandaj, **arsimi gjithëpërfshirës** nuk duhet të reduktohet vetëm në përfshirje fizike (megjithëse çdo pengesë për këtë duhet të largohet) ose vetëm në parandalimin e diskriminimit në arsim në kuptimin e individëve që kanë qasje të kufizuar në mundësitë arsimore për shkak të përkatësive të tyre, dallimeve të atribuuara nga shoqëria ose ato të perceptuara. Në vend të kësaj, **sistemet e arsimit gjithëpërfshirës**, siç theksohen vazhdimisht nga Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e OKB-së (UNESCO)[9] dhe institucione të tjera ndërkombëtare, promovojnë nga njëra anë **qasjen e barabartë në arsim dhe pjesëmarrjen në arsim** pa ndonjë pengesë në këtë drejtim, dhe nga ana tjetër **arritjen e barabartë për të gjithë nxënësit**, duke i respektuar nevojat, aftësitë dhe

8 Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, A/RES/70/1, Rezoluta e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme më 25 shtator 2015, para. 25, https://www.un.org/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/RES/70/1&Lang=E.

9 UNESCO: Gjithëpërfshirja në arsim, https://en.unesco.org/themes/inclusion-in-education.

karakteristikat e tyre të larmishme. Mjedisi i mësimnxënies duhet të jetë **pa diskriminim** për çfarëdo arsye.

Në një sistem të tillë arsimor gjithëpërfshirës,**të gjithë fëmijët janë në gjendje të bëhen pjesë e komunitetit të tyre dhe të zhvillojnë një ndjenjë të përkatësisë dhe të përgatiten më shumë për jetën në komunitet si fëmijë dhe si të rritur. Kështu, arsimi gjithëpërfshirës ofron mundësi më të mira për mësimnxënie për të gjithë.** Për të arritur tek komunitetet e përjashtuara dhe të margjinalizuara, të cenueshme dhe personat që u përkasin atyre me qëllim që t'u sigurohet atyre arsim cilësor gjithëpërfshirës kërkohet zhvillim dhe zbatim i politikave dhe programeve gjithëpërfshirëse - domethënë: **sistemet e arsimit gjithëpërfshirës që heqin barrierat që i kufizojnë pjesëmarrjen dhe arritjen e të gjithë nxënësve; të respektojnë nevojat, aftësitë dhe karakteristikat e larmishme; dhe të eliminojnë të gjitha format e diskriminimit në mjedisin e mësimnxënies.**

Arsimi siç është rregulluar nga instrumentet ndërkombëtare, përfshirë traktatet ndërkombëtare të detyrueshme ligjërisht, është i rëndësishëm jo vetëm për sa i përket detyrës së shteteve për të siguruar zbatimin e së drejtës për arsim **për të gjithë**, por edhe për të siguruar **përmbajtjen** e tillë të arsimit që këto të fundit "do të drejtohen", siç parashihet në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (1948, Neni 26), "për zhvillim të plotë të personalitetit njerëzor dhe forcim të respektimit të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore" dhe "do të promovojë mirëkuptimin, tolerancën dhe miqësinë mes të gjitha kombeve, grupeve racore ose fetare". Kjo është veçanërisht e rëndësishme për shoqëritë e larmishme etnikisht, gjuhësisht, fetarisht dhe kulturalisht - d.m.th. shoqëritë ku banojnë komunitete të ndryshme etno-kombëtare - dhe për personat që u përkasin këtyre komuniteteve, pavarësisht nga gjendja e tyre dominuese ose jo-dominuese, shumicë ose pakicë.

Të gjitha këto standarde ndërkombëtare janë aplikuar edhe në dokumentet aktuale strategjike të Kosovës për arsimin (**Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021**[10]) dhe për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian (**Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021**[11]), të dy që kërkojnë të përmirësojnë rezultatet arsimore të personave që u përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian[12] si dhe grupeve të tjera të margjinalizuara.

2.2 Arsimi gjithëpërfshirës në një shoqëri të larmishme: rëndësia e tij për personat që u përkasin komuniteteve kombëtare ose etnike, fetare ose gjuhësore dhe për integrimin shoqëror

Arsimi në një kontekst të larmishëm shoqëror duhet të arrijë dy qëllime të rëndësishme, përveç ndihmës për të gjithë individët të arrijnë arsim cilësor: së pari, **arsimi cilësor duhet të jetë në mënyrë të barabartë i qasshëm për të gjithë** (ku qasja nuk është e kufizuar në qasjen fizike në arsim, por më tepër në mundësinë për të marrë kualifikimet dhe të gjitha rezultatet e pritura të mësimnxënies), pavarësisht nga përkatësia e tyre kombëtare ose etnike, gjuhësore ose fetare, dhe rezultatet arsimore nuk duhet të varen nga këto përkatësi; së dyti, arsimi duhet **të promovojë në**

10 Plani Strategjik i Arsimit në Kosovës 2017-2021, korrik 2016, gjendet në https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-kesp-2017-2021-1.pdf.

11 Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021, prill 2017, https://www.rcc.int/romaintegration2020/docs/27/strategy-for-inclusion-of-roma-and-ashkali-communities-in-the-kosovo-society-2017-2021--kosovo.

12 Sidoqoftë, vini re se komuniteti egjiptian nuk është mbuluar nga strategjia e re dhe plani i veprimit, i cili bëri që Komiteti Këshillëdhënës të rekomandojë se "/m/ënyra alternative për personat që i përkasin komunitetit egjiptian për të përfituar nga masa të ngjashme me ato të parapara në strategji gjithashtu duhet të identifikohen pa vonesë." Shih Komiteti Këshillëdhënës për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Opinioni i Katërt mbi Kosovën*, miratuar më 8 mars 2017, ACFC/OP/IV(2017)001, para. 29.

mënyrë aktive një diversitet të tillë si vlerë duke kontribuuar kështu në integrimin shoqëror. Përmes nënkuptimit, arsimi nuk mund të injorojë diversitetin, as - në rastin më të keq - nuk mund të promovojë unitetin kombëtar duke promovuar një komunitet etno-kombëtar dhe identitetin e personave që i përkasin atij në kurriz të të gjitha komuniteteve të tjera dhe të të gjitha identiteteve dhe përkatësive të tjera. **Diversiteti është i favorshëm për krijimtarinë dhe inovacionin. Në arsim dhe karrierë, do të ketë rezultate më të mira nëse pikat e forta, identitetet, aftësitë, perspektivat dhe interesat e larmishme njihen, kuptohen dhe mbështeten.**

Por, përkundër këtij nocioni të diversitetit si vlerë, shumë komunitete etno-kombëtare (pakica) dhe persona që u përkasin atyre janë të margjinalizuar ndërsa shtetet kërkojnë homogjenizim, të cilin ata e shohin si një parakusht për stabilitetin dhe madje edhe sigurinë. Homogjenizimi në formën e pranimit dhe promovimit të një gjuhe, një kulture, një etnie, një historie dhe një feje, ndan 'ne' mbizotërues nga 'ata' të margjinalizuar, të cenueshëm dhe problematik. Kjo do të çojë në **diskriminim, pabarazi dhe mundësi të pabarabarta, dhe kështu në pakënaqësi, ankesa dhe konflikte të hapura të mundshme.** Me fjalë të tjera, **eliminimi i diversitetit bazuar në çdo perceptim të tij si problematik ka pasoja të qarta negative për individë dhe shoqëri.**

Në të vërtetë, ka qenë pikërisht kjo frikë e paqëndrueshmërisë që i ka bërë shtetet të menaxhojnë diversitetin kombëtar/etnik/gjuhësor dhe fetar duke miratuar dokumente shumëpalëshe për mbrojtjen e pakicave, të tilla si Konventa Kornizë e KiE-së për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare,[13] e cila është e zbatueshme edhe në Kosovë.[14] **Të drejtat e pakicave** si pjesë e sistemit universal të mbrojtjes së të drejtave të njeriut janë zhvilluar për të parandaluar konfliktet dhe paqëndrueshmërinë duke mbrojtur dhe ruajtur diversitetin - d.m.th. me qëllim që t'u mundësojë personave që u përkasin pakicave kombëtare të mbrojnë, ruajnë dhe zhvillojnë identitetet etnike, gjuhësore, kulturore, fetare. Shtetet e kanë kuptuar që këto identitete duhet të mbrohen pasi ato janë jo dominuese në një shtet të dominuar nga një (ose disa) komunitete dominuese, kombe kushtetuese ose shtet-mbajtëse. Por pozicioni jo dominues i komuniteteve pakicë nuk përcaktohet vetëm nga përkatësia etnike, gjuhët, kulturat ose fetë. Në vend të kësaj, disa nga këto pakica janë margjinalizuar më tej nga **gjendja e tyre socio-ekonomike**. Këto komunitete zakonisht referohen si pakica/komunitete të cenueshme/të margjinalizuara. Është e rëndësishme **të njohim dhe kuptojmë gjendjen e tyre si 'pakica' të dyfishta**: si pakica socio-ekonomike (të privuara nga barazia në aspektin socio-ekonomik) dhe si pakica kombëtare/etnike/gjuhësore/fetare/kulturore. Ky dyfishim është i rëndësishëm për arsimin gjithëpërfshirës dhe për arsimin cilësor në përgjithësi. Në mënyrë thelbësore, 'komunitetet e cenueshme/e margjinalizuara' nuk mund të reduktohen dhe nuk duhet të reduktohen vetëm në pakica socio-ekonomike pasi kjo inkurajon, nëse nuk forcon, asimilimin dhe në rastin më të mirë një mohim të kulturave, gjuhëve, identiteteve të tyre, të cilat do të ndikojnë negativisht në rezultatet e arsimit të personave që u përkasin këtyre komuniteteve.

Prandaj, arsimi gjithëpërfshirës dhe cilësor duhet të kryhet në kornizën më të gjerë ndërkombëtare normative të të drejtave të njeriut dhe të drejtave të pakicave (si të drejta të njeriut). Në të vërtetë, të drejtat e pakicave janë një mjet dhe një mënyrë, në shumë fusha të ndryshme me arsimin që është një nga ato më të rëndësishmet, për arritjen **e barazisë efektive në nivelin e individëve dhe integrimin në nivelin e shoqërive të larmishme**. Në shoqëri të larmishme, të drejtat e pakicave sigurojnë kështu një mjet për arritjen e integrimit, koherencës shoqërore (por jo uniformitetin ose homogjenitetin). Integrimi ose kohezioni shoqëror është:

13 Për tekstin e Konventës shih https://www.coe.int/en/web/minorities/text-of-the-convention.

14 Procesi i monitorimit siç aplikohet për Kosovën*, me të gjitha dokumentet, gjendet në https://www.coe.int/en/web/minorities/unmik/kosovo.

proces dinamik, me shumë aktorë të angazhimit të ndërsjellë që lehtëson pjesëmarrjen efektive nga të gjithë anëtarët e një shoqërie të larmishme në jetën ekonomike, politike, sociale dhe kulturore dhe kultivon një ndjenjë të përbashkët dhe gjithëpërfshirëse të përkatësisë në nivelet kombëtare dhe lokale. Për ta mbështetur procesin e integrimit, shtetet duhet të miratojnë politika që synojnë të krijojnë një shoqëri në të cilën respektohet diversiteti dhe të gjithë, përfshirë të gjithë anëtarët e grupeve etnike, gjuhësore, kulturore ose fetare, kontribuojnë në ndërtimin dhe ruajtjen e një identiteti të përbashkët dhe gjithëpërfshirës qytetar. Kjo arrihet duke siguruar mundësi të barabarta për të gjithë për të kontribuar dhe përfituar nga politika. Kjo kërkon që shteti të sigurojë që të drejtat e të gjithëve janë respektuar dhe të krijojë kushtet që të gjithë anëtarët e shoqërisë të marrin pjesën e tyre të përgjegjësive. Shoqëria në tërësi përfiton nga një politikë e tillë. Ky proces mund të çojë në ndryshime në kulturat e shumicës dhe pakicave.[15]

Si pasojë, **integrimi aplikohet për një shoqëri të larmishme**, jo për pakicat ose individët që u përkasin atyre komuniteteve pakicë. Individët duhet të **përfshihen** në proceset e vendimmarrjes, në institucione, në politika etj., por **nuk mund të pritet që ata të integrohen (përshtaten/asimilohen) në komunitetin dominues (etno-kombëtar)**. Integrimi shoqëror është **proces i dyanshëm** i bashkërendimit të ndërsjellë, i përshtatjes reciproke dhe i ndryshimit të ndërsjellë për të akomoduar të gjithë, pavarësisht nga përkatësitë e tyre etnike/gjuhësore/fetare. Një shoqëri e larmishme e integruar, koherente, bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut për të gjithë, përfshirë të drejtat e pakicave, dhe vlerëson të gjitha komunitetet, përfshirë pakicat kombëtare, si pjesë integrale dhe po aq të rëndësishme (në vend se si një 'problem' socio-ekonomik ose gjuhësor ose kërcënim i sigurisë). Për më tepër, një shoqëri e integruar **i respekton të gjitha format e diversitetit, përfshirë diversitetin brenda komunitetit (p.sh. sipas gjinisë, moshës, profesionit) dhe kërkon t'i kapërcejë pengesat në qasjen në të gjitha të drejtat e njeriut, pa diskriminim.**

Integrimi nuk duhet të ngatërrohet me asimilim, ose presione (personat që u përkasin) pakicave kombëtare për të ndryshuar ose braktisur identitetet e veta të pakicave, përkundrazi t'i shprehin dhe promovojnë ato lirisht. Integrimi shoqëror është një proces i vazhdueshëm që do të çojë në rezultate të pritura vetëm nëse vlerësohet ndonjë politikë-bërje përmes llupës së efekteve në të gjitha komunitetet, përfshirë pakicat. Çështjet duhet të adresohen përgjithmonë dhe mekanizmat e krijuar për këtë qëllim duhet të themelohen. Prandaj, integrimi shoqëror nuk duhet të ngatërrohet me sigurimin e mundësive të barabarta të bazuara vetëm në promovimin e identitetit dominues.

Është **përgjegjësi** e shtetit (autoriteteve në të gjitha nivelet) të krijojë kushte për personat që u përkasin të gjitha pakicave për të ruajtur dhe zhvilluar plotësisht identitetet e tyre të pakicave ndërsa kanë qasje të barabartë në të drejtat e njeriut (përfshirë të drejtën për arsim cilësor), pa diskriminim, dhe duke iu mundësuar atyre arritjen e barazisë efektive. Kur të realizohet plotësisht, e gjithë kjo shërben si parakusht për kohezionin dhe integrimin shoqëror. Sidoqoftë, mbrojtja dhe zhvillimi i identiteteve të pakicave **nuk duhet të kuptohet si ndarje e pakicave nga pjesa tjetër e shoqërisë së larmishme.** Për shembull: 1) shkolla të ndara për fëmijët romë, apo edhe klasa të ndara për nxënësit romë nuk janë të pranueshme; 2) të mësuarit dhe të folurit e një gjuhe të pakicës është e drejtë që mund të ushtrohet krahas gjuhës(ve) shtetërore/zyrtare/dominuese, dhe jo si zëvendësim i saj. Të dyja gjuhët (në fakt disa, pasi shoqëritë janë të larmishme në kuptimin e shumëfishtë jo binar) kanë nevojë të bashkëjetojnë. Zgjidhjet e pranueshme (d.m.th. të arritura në një proces domethënës konsultimi) duhet të kërkohen për të siguruar një kombinim të

15 Komisioneri i Lartë i OSBE-së për Pakicat Kombëtare, Udhëzime të Lubjanës për Integrimin e Shoqërive Diverse, 2012, f. 3–4.

përshtatshëm në çdo shoqëri të caktuar të larmishme, por pa një ndarje paraprake midis 'neve' e pranueshme dhe 'atyre' problematike.

Arsimi është një fushë e rëndësishme për arritjen e qëllimit të ruajtjes, mbrojtjes dhe zhvillimit të identiteteve të pakicave dhe për arritjen e integrimit shoqëror. Në arsim, personat që u përkasin pakicave kanë të drejtë të mësojnë gjuhën e tyre ose në gjuhën e tyre dhe të mësojnë për komunitetin e tyre. E rëndësishmja, sidoqoftë, dokumentet ndërkombëtare siç është Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare nuk adresojnë vetëm personat që u përkasin pakicave. Përkundrazi, janë **të gjitha shoqëritë ato që duhet të përfshihen** në procesin e sigurimit të integrimit shoqëror përmes të drejtave të pakicave dhe të drejtave të njeriut në përgjithësi. E rëndësishmja, disa norma në ato që mund të shfaqen si instrumente të specializuara ligjore për të drejtat e pakicave, të tilla si Konventa Kornizë, kanë fushëveprimin më të gjerë të zbatimit dhe kështu aplikohen për të gjithë në një shoqëri, në vend se vetëm për personat që u përkasin pakicave të ndryshme, përfshirë edhe të komuniteteve të cenueshme/të margjinalizuara ose të ashtuquajturave pakica sociale. Në përgjithësi, këto norma gjithëpërfshirëse i referohen **promovimit të tolerancës (d.m.th. respektimit të diversitetit)** dhe **promovimit të dialogut ndërkulturor**, ku arsimi, kultura dhe media, janë fusha veçanërisht të rëndësishme për promovimin e këtyre objektivave.

Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (Neni 12) ligjërisht e detyrueshme përcakton kështu që arsimi dhe hulumtimi duhet të kultivojnë njohuri për historinë, kulturat, gjuhët dhe fetë e pakicave dhe të shumicës, duke adresuar në mënyrë të qartë shoqërinë në tërësi. Neni 12 më tej bën thirrje për zhvillimin e shkëmbimeve ndërkulturore dhe kompetencave përmes lehtësimit të "kontakteve midis nxënësve dhe mësimdhënësve të komuniteteve të ndryshme". Siç është shpjeguar nga Komiteti Këshillëdhënës,

> /i/nformacione adekuate mbi përbërjen e shoqërisë, përfshirë pakicat kombëtare dhe të tjera, duhet të jenë pjesë e kurrikulës publike dhe e teksteve shkollore dhe materialeve arsimore të përdorura në të gjitha shkollat në të gjithë territoret e shteteve palë, jo vetëm për të nxitur mirëkuptimin dhe respektin ndërkulturor tek të gjithë nxënësit, por edhe për të rritur prestigjin dhe vetë-ndërgjegjësimin e personave që u përkasin grupeve numerikisht më të vogla ose të pafavorizuara/të cenueshme ose të margjinalizuara.[16]

Personat që u përkasin pakicave duhet të jenë në gjendje të ruajnë identitetet e tyre edhe përmes arsimit, por arsimi duhet të **edukojë të gjithë**, përfshirë personat që i përkasin komunitetit ose komuniteteve shumicë (dominues), për të mësuar rreth pakicave si një **pjesë e barabartë, e vlerësuar dhe përbërëse e shoqërisë së larmishme**. **Prandaj, arsimi gjithëpërfshirës është shumë më tepër sesa thjesht prania e personave që u përkasin pakicave dhe parandalimi i diskriminimit të tyre për rezultatet e tyre arsimore do të varet nga vetë-perceptimi i tyre si persona që u përkasin pakicave jo-dominuese, shpesh të cenueshme/të margjinalizuara që nuk vlerësohen ose nuk shikohen si pjesë e vlerësuar e shoqërisë së larmishme.** Kjo kërkon aktivitete dhe përpjekje të koordinuara dhe të qëllimshme. Komiteti Këshillëdhënës ka shpjeguar kështu më tej se

> /m/aterialet arsimore që paraqesin përmbajtje për pakicat duhet të përgatiten më tej në konsultim të ngushtë me përfaqësuesit e grupeve përkatëse dhe nuk duhet të kufizohen në imazhe stereotipike. Prandaj, mundësitë dhe trajnimet adekuate për zhvillim profesional duhet të jenë në dispozicion për të gjithë mësimdhënësit për t'i përgatitur ata për trajtimin e mjediseve gjuhësisht dhe kulturalisht / si

16 Komiteti Këshillëdhënës, Komentari Tematik i Katërt: Konventa Kornizë: një mjet kryesor për menaxhimin e diversitetit përmes të drejtave të pakicave**.** Fushëveprimi i Zbatimit të Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, 2016, para. 59.

> dhe shoqërisht dhe socio-ekonomikisht të larmishme. Në lidhje me mësimdhënien e historisë në të gjitha shtetet palë, mendimi kritik dhe akomodimi i perspektivave të shumta duhet të promovohen në të gjitha përpjekjet.[17]

Dialogu ndërkulturor dhe multilingualizmi do të përfitojnë nga toleranca dhe respekti për diversitetin në shoqëri. Të dyjat mund dhe duhet të promovohen përmes(në tërë) sistemeve(et) arsimore.

Ekziston një lidhje e fortë e ndërsjellë midis **integrimit shoqëror dhe arsimit gjithëpërfshirës**. **Arsimi gjithëpërfshirës është kritik për integrimin shoqëror dhe për të siguruar që çdo individ, pavarësisht nga rrethanat e tij/saj personale, të zhvillojë potencialin e vet të plotë. Rezultatet arsimore të personave që u përkasin komuniteteve të cenueshme do të varen nga aftësia e autoriteteve në të gjitha nivelet për të adresuar dimensionin socio-ekonomik të cenueshmërisë, ndërsa nuk i injorojnë ose nuk i detyrojnë ata t'i braktisin identitetet e tyre kombëtare ose etnike, fetare ose gjuhësore.** Përkundrazi, **integrimi shoqëror presupozon respektimin e diversitetit dhe promovimin e tij aktiv përmes politikave të ndryshme**, përfshirë përdorimin e gjuhëve, edhe në arsim, dhe qasjen në informacion për të gjithë për komunitetet pakicë përmes kurrikulave.

Në këtë kontekst, dhe pa një analizë të hollësishme të legjislacionit në Kosovë,[18] është e rëndësishme të kujtojmë se diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike, gjuhësore, kulturore, fetare ose gjinore është i ndaluar në Kosovë. Për më tepër, legjislacioni i Kosovës për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe të të drejtave të personave që u përkasin komuniteteve është përgjithësisht në përputhje me normat evropiane, por ai duhet **të zbatohet më mirë**, veçanërisht në kontekstin e ndarjeve të forcuara midis komuniteteve dhe njëgjuhësisë së rritur.[19] Në të vërtetë, autoritetet janë të vetëdijshme për nevojën për të përmirësuar zbatimin,[20] i cili ka çuar në një "përhapje të strategjive dhe planeve të veprimit që synojnë personat që u përkasin pakicave kombëtare pa monitorimin e duhur, bashkërendimin, ndarjen e përgjegjësive dhe pa një zinxhir të qartë të përgjegjësisë", të cilat të gjitha "e minojnë efektivitetin e tyre".[21] Për më tepër, siç vërehet nga Komiteti Këshillëdhënës, këto

> dokumente të politikave që synojnë personat që u përkasin pakicave kombëtare shpesh duket se janë miratuar me qëllim që të përputhen me kërkesat ndërkombëtare dhe nuk pasqyrojnë gjithmonë një kuptim të qartë të asaj që nënkupton me të vërtetë përfshirjen e personave që u përkasin pakicave në një shoqëri demokratike. Ngjashëm, ngritja e kapaciteteve duket se nuk ka ardhur nga korniza e artikuluar institucionale. Shumëzimi i organeve që merren me punët e komuniteteve ka bërë një ndarje të paqartë të përgjegjësisë, duke përfshirë mbivendosjen e mandateve, ndërsa në të njëjtën kohë personeli i këtyre organeve nuk duket se është mjaft i trajnuar për t'i përmbushur detyrat e veta. Së fundmi, ka një mungesë të bashkërendimit dhe dialogut ndërinstitucional midis organeve të ndryshme të ngarkuara me punët e komuniteteve në nivelin qendror dhe ndërmjet niveleve qendrore dhe lokale. Sa i përket burimeve financiare të vëna në dispozicion për të përmirësuar qasjen në të drejtat e promovuara nga Konventa Kornizë, ekziston një mbështetje e gjerë në mjetet e siguruara nga donatorët ndërkombëtarë, të cilat dëmtojnë pronësinë e procesit të zbatimit nga ministritë dhe komunat.[22]

17 *Po aty*., para. 60.

18 Për analizën e kornizës ligjore, institucionale dhe të politikave të Kosovës, në nivelin kombëtar dhe lokal, shih, mes shumë raporteve të tjera, Perspektivat e të rinjve rom, ashkali dhe egjiptian mbi mundësitë dhe sfidat për punë të denjë në Kosovë, 2018, Kapitulli 4.

19 Komiteti Këshillimor për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Opinioni i Katërt mbi Kosovën*, miratuar më 8 mars 2017, ACFC/OP/IV(2017)001.

20 BE/KFOS: Zbatimi i Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017. Raporti i vlerësimit, 2017.

21 *Po aty*., Përmbledhje, shih edhe parag. 4.

22 *Po aty*., para. 4.

Këto probleme plotësohen nga mungesa e integrimit të menaxhimit të diversitetit përmes të drejtave të pakicave në politikat e tjera. Efekti praktik i këtij është bashkërendimi i vështirë i adresimit të punëve të komuniteteve nga njëra anë, dhe arsimi gjithëpërfshirës nga ana tjetër, i cili reflektohet në mungesën e progresit në lidhje me synimin 1.8 të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë (PSAK) 2017-2021 që merret me promovimin e diversitetit (shih seksionin 2.3 më poshtë).[23] Është e rëndësishme të kuptohet se integrimi shoqëror do të ndodhë vetëm nëse diversiteti, përfshirë diversitetin gjuhësor dhe etnik, kuptohet dhe respektohet si vlerë dhe komunitetet pakicë shihen si pjesë përbërëse dhe e vlerësuar e shoqërisë së larmishme - d.m.th. pikëpamjet dhe vlerat që duhet të promovohen në mënyrë aktive përmes arsimit. Madje programet ekzistuese siç janë Udhërrëfyesi për diversitetin dhe gjithëpërfshirjen në arsimin parauniversitar në Kosovë (2016), "nuk e kompensojnë Strategjinë për promovimin e dialogut dhe kontaktit ndëretnik ndërmjet komuniteteve dhe aktiviteteve të tjera siç janë planifikuar në PSAK 2017-2021 për të siguruar mekanizma dhe politika efektive për promovimin e diversitetit përmes një sistemi arsimor të integruar."[24]

2.3 Gjendja e përgjithshme në nivele të ndryshme të arsimit, e rëndësishme për përfshirjen e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë dhe për synimet strategjike

Qasja në arsimin cilësor të personave që u përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë ka qenë shumë e kufizuar dhe vazhdon të jetë e kufizuar përkundër përpjekjeve intensive të shumë aktorëve të përfshirë në arsim, përfshirë autoritetet në të gjitha nivelet, shoqërinë civile dhe aktorët ndërkombëtarë. Qasja në arsim cilësor është e kufizuar si në aspektin e gjithëpërfshirjes fizike të atyre personave në institucionet arsimore në të gjitha nivelet (ku përfaqësimi i tyre i pabarabartë në nivelet më të larta të arsimit është veçanërisht shqetësues), ashtu edhe në aspektin e rezultateve të tyre arsimore. Hendeku midis popullatës në përgjithësi dhe komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian mund të shihet tek treguesit e arsimit, të matur në 2013–2014, të paraqitur në tabelën më poshtë.[25]

23 KEEN: Vlerësimi afatmesëm: Zbatimi i Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021, nëntor 2019, f. 35.

24 *Po aty*.

25 Agjencia Kosovare e Statistikave (2014): Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë (RKSOKB 1244). Anketa Grupore me Shumë Tregues 2013-2014. Tabela është kopjuar nga: Perspektiva e të rinjve rom, ashkali dhe egjiptian mbi mundësitë dhe sfidat për punë të denjë në Kosovë, 2018, f. 20.

Tabela 5. Treguesit e arsimit, 2017			
Treguesi	**Përshkrimi**	**Rom, ash-kalinj dhe egjiptian (%)**	**Totali (%)**
Shkalla neto e reg-jistrimit në arsimin fillor	Përqindja e fëmijëve të moshës shkollore që hyjnë në klasë të parë të shkollës fillore	68.1	91.6
Raporti neto i vijueshmërisë së shkollës fillore	Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës fillore që aktualisht vijojnë arsimin fillor ose të mesëm	85.3	98.0
Raporti neto i vijueshmërisë së shkollës së mesme të ulët	Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës së mesme të ulët që aktualisht vijojnë shkollën e mesme të ulët ose arsimin e lartë	65.0	95.9
Raporti neto i vijueshmërisë së shkollës së mesme të lartë	Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës së mesme të lartë që aktualisht vijojnë shkollën e mesme të lartë apo arsimin e lartë	30.3	82.0
Raporti neto i vijueshmërisë së shkollës së mesme	Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës së mesme që aktualisht vijojnë shkollën e mesme apo arsimin e lartë	53.4	90.9
Shkalla e tranzi-cionit në shkollën e mesme të ulët	Numri i fëmijëve që kanë vijuar klasën e fundit të shkollës fillore gjatë vitit shkollor paraprak të cilët janë në klasën e parë të shkollës së mesme të ulët gjatë vitit shkollor aktual pjesëtuar me numrin e fëmijëve që kanë vijuar klasën e fundit të shkollës fillore gjatë vitit paraprak	91.1	99.6
Shkalla e tranzi-cionit në shkollën e mesme të lartë	Numri i fëmijëve që kanë vijuar klasën e fundit të shkollës së mesme të ulët gjatë vitit shkollor paraprak të cilët janë në klasën e parë të shkollës së mesme të lartë gjatë vitit shkollor aktual pjesëtuar me numrin e fëmijëve që kanë vijuar klasën e fundit të shkollës së mesme të ulët gjatë vitit paraprak	69.9	91.5

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës. 2014. Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë2013-2014

Tabela 6. Treguesit për matjen e arritjes së objektivit të MASHT për përfshirje		
Treguesit për matjen e arritjes së objektivit për përfshirje	Baza	Caku
Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në edukimin parafillor	53.9%	70%
Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin fillor	85.3%	95%
Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e mesëm të ulët	65%	85%
Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e mesëm të lartë	30.3%	50%
Shkalla e transicionit në arsimin e mesëm të lartë për fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian	69.9%	80%

Burimi: MASHT, 2017. Plani i Veprimit të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2020, E qasshme në: http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-action-plan.pdf.

Hendeku në treguesit e arsimit midis popullatës së përgjithshme dhe komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian bëri që MASHT-i të zhvillojë, në PSAK-un 2017-2021 në vitin 2017, një grup synimesh të matshme në lidhje me gjithëpërfshirjen e personave që u përkasin këtyre tri komuniteteve në nivele të ndryshme të arsimit, siç paraqitet në tabelën më poshtë.[26]

Ndërsa koha e caktuar për arritjen e këtyre qëllimeve në planin e veprimit po mbaron në 2021, do të jetë së shpejti e qartë nëse të gjitha këto synime janë arritur dhe cilat veprime specifike akoma mund të jenë të nevojshme për t'i përmbushur këto synime dhe për ta vazhduar punën ashtu që të arrihet barazia e plotë në qasjen në arsimin gjithëpërfshirës dhe cilësor për të gjithë, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike ose ndonjë rrethanë tjetër personale. Sipas raportit afatmesëm që e vlerëson zbatimin e PSAK-ut 2017-2021 nga Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim (KEEN; financuar nga BE-ja), i cili ka vlerësuar secilën nga tetë synimet brenda Objektivit Strategjik 1 (Pjesëmarrja dhe Gjithëpërfshirja), çështjet e mëposhtme janë veçanërisht të rëndësishme për arsimin gjithëpërfshirës, të zbatueshëm për komunitetet e cenueshme/e margjinalizuara:[27]

Synimi 1.1.: Pjesëmarrja në arsimin parashkollor cilësor arrin në 20% të fëmijëve të moshës 0–5 vjeç. Në Kosovë, kjo çështje mbetet sfidë (megjithëse synimi është vendosur relativisht modest) për shkak të **mungesës së investimeve adekuate, infrastrukturës dhe vetëdijesimit për rëndësinë** e arsimit cilësor parashkollor për të gjithë vertikalen arsimore. Vetëm 7.2% e fëmijëve janë të përfshirë në arsimin parashkollor dhe **prioritet** duhet t'iu jepet fëmijëve të moshës 3-5 vjeç (d.m.th. para hyrjes së tyre në shkollë). Vetëm 49.5% e grupmoshës 4 dhe 5 vjeç u përfshinë në arsimin parashkollor në 2018/19, që është një rritje e vogël në krahasim me vitet e mëparshme.[28] Shifrat më të fundit gjithashtu nuk janë inkurajuese.[29]

Synimi 1.2.: Të gjithë fëmijët 5-vjeçar janë të përfshirë në arsimin cilësor parafillor. Ka pasur progres drejt përmbushjes së këtij synimi, i cili u rrit në 92.7% (2018/19).[30] Pas një marrëveshje midis MASHT-it dhe Caritas-it Zviceran, 56 klasa parafillore në të gjithë Kosovën ishin pajisur me inventar dhe materiale në 2017–2019.[31] E rëndësishmja, **nuk ka të dhëna** në dispozicion për trajnimin e edukatorëve për zbatimin e kurrikulës, për monitorimin e kompetencave të edukatorëve dhe nuk është instaluar **asnjë**

26 Marrur nga: Perspektiva e të rinjve rom, ashkali dhe egjiptian mbi mundësitë dhe sfidat për punë të denjë në Kosovë, 2018, f. 21.

27 KEEN: Vlerësimi afatmesëm: Zbatimi i Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021, nëntor 2019, kapitulli 2.1.

28 *Po aty*., f. 17–18.

29 Sipas të dhënave më të fundit nga SMIA në 2019/20, 9 fëmijë romë janë pjesë e parashkollorit (duke mos përfshirë arsimin parafillor), 0 fëmijë ashkali dhe 7 fëmijë egjiptian, gjenden në http://masht-smia.net/Publikimet/40ALB.pdf, 2020, f. 27.

30 KEEN: Vlerësimi afatmesëm: Zbatimi i Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021, nëntor 2019, f. 22.

31 *Po aty*.

databazë vlerësimi në shkolla, gjë që e bën zbatimin e këtyre aktiviteteve të varura nga projektet e implementuara nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) dhe Save the Children.[32]

Synimi 1.3.: 50% e fëmijëve me nevoja të veçanta janë të përfshirë në sistemin arsimor parauniversitar. Vlerësimi i këtij synimi vuan nga **mungesa e të dhënave në dispozicion** për nxënësit me nevoja të veçanta në klasat e rregullta. Megjithëkëtë, numri i fëmijëve me nevoja të veçanta në klasa të rregullta ka shënuar rënie, ndërsa numri i tyre në qendrat burimore është në rritje e sipër. Për më tepër, përmbushja e këtij synimi gjithashtu vuan nga mungesa e asistentëve, duke vendosur kështu një barrë financiare për disa prindër që duhet t'i angazhojnë vetë, gjë që është veçanërisht problematike për familjet më të varfra. Për më tepër, trajnimi për vlerësimin e nevojave arsimore të fëmijëve me nevoja të veçanta nuk është implementuar në të gjithë Kosovën. Trajnimi i stafit mësimor mbi arsimin gjithëpërfshirës është mbështetur nga Save the Children dhe UNICEF, i bashkëfinancuar nga MASHT-i, dhe morën pjesë vetëm 556 mësimdhënës në 2018/19, gjë që lë **trajnimin e mësimdhënësve** si sfidë për t'u adresuar në mënyrë adekuate. Fenomeni i '**klasave të bashkuara**' ende ekziston dhe kalimi i tyre në qendrat burimore nuk ka përparuar më tej që nga viti 2018. **Angazhimi i asistentëve** për fëmijët me nevoja të veçanta nuk financohet sistematikisht (por varet nga granti), dhe **disa komuna nuk arrijnë të planifikojnë dhe raportojnë me kohë** në MASHT për nevojat e tyre për asistentë.[33]

Synimi 1.4.: Gjithëpërfshirja e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shkollën fillore është rritur me 10%, ndërsa në arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë është rritur me 20%. Pjesëmarrja në të gjitha nivelet ka treguar "një trend relativisht të qëndrueshëm", por "pjesëmarrja e fëmijëve në arsimin parashkollor, parafillor dhe të mesëm të lartë mbetet sfidë".[34] Procesi i institucionalizimit të qendrave mësimore nuk ka përfunduar, dhe 83 qendra mësimore në 20 komuna, duke përfituar 5,555 fëmijë në 2017/18, vazhdojnë të jenë kryesisht të varura nga donatorët ndërkombëtarë.[35] Brenda EU-SIMRAES 2, shumica e aktiviteteve të trajnimeve u kryen në 2017-2018. Komunat, me përjashtimin e vetëm të Obiliqit, nuk kanë hartuar **rregullore për të lehtësuar regjistrimin dhe vijueshmërinë e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në nivelin parashkollor dhe të mesëm të lartë**. Në 2018/19, 600 nxënës rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e mesëm të lartë morën bursë (brenda Fondit të Arsimit të Romëve MASHT-REF), dhe 150 të tjerë morën bursë të pjesshme (50%) nga programi i GIZ-it i zbatuar nga VoRAE, i cili është pothuajse 50% më shumë se në vitin e kaluar. Sidoqoftë, **kriteret e qarta për fitimin e një burse** në një dokument të unifikuar ende nuk janë miratuar.[36] **Një sistem i rregullt monitorimi** për regjistrimin e personave që u përkasin tri komuniteteve në arsimin parashkollor dhe të mesëm të lartë **ende nuk është zhvilluar**.[37] **Trajnimi për mësimdhënësit për mësimdhënie në gjuhën rome nuk është i organizuar në mënyrë sistematike** nga MASHT-i dhe është raportuar **mungesë e interesimit të mësimdhënësve**.[38] **Rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e regjistrimit dhe vijueshmërisë së shkollës** në mesin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është bërë nga një tryezë e rrumbullakët, broshura për arsimin e mesëm të lartë, disa takime me nxënës të klasave të nënta dhe një kamp veror ku morën pjesë 26 nxënës.[39]

32 *Po aty*., f. 23.

33 *Po aty*., f. 23–24.

34 *Po aty*., f. 26 dhe f. 25, respektivisht.

35 *Po aty*., f. 26–27.

36 *Po aty*., f. 27.

37 *Po aty*., f. 27–28.

38 *Po aty*., f. 28.

39 *Po aty*.

Synimi 1.5.: Të gjithë fëmijët e riatdhesuar janë përfshirë në sistemin arsimor dhe mekanizmat për organizimin e arsimit në diasporë janë forcuar. MASHT-i ka raportuar se të gjithë nxënësit e riatdhesuar janë përfshirë në sistemin arsimor, por ka probleme, ndër të tjera, me disponueshmërinë e të dhënave, **evidentimin në kohë, mbështetjen për mësimin plotësues dhe qasjen në trajnime adekuate** për zyrtarët komunalë dhe mësimdhënësit.[40] Asnjë informacion i veçantë nuk sigurohet për ndihmën për nxënësit e riatdhesuar që u përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe nevoja për një mbështetje të tillë mund të përcaktohet bazuar në të dhënat e fundit nga OSBE.[41]

Synimi 1.6.: Janë krijuar mekanizma efektivë për të parandaluar braktisjen dhe mos-regjistrimin në arsimin parauniversitar. Për të adresuar këtë problem, ekipet për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mos-regjistrimit (EPRBM) janë duke u krijuar në komuna dhe shkolla. U organizuan seanca informative dhe trajnime për ngritjen e kapaciteteve. Megjithëkëtë, sfidat mbeten dhe ato kryesisht përfshijnë aftësinë e ekipeve për EPRBM për të adresuar **gjendjen komplekse sociale** në mënyrë që rastet e referuara nga shkollat të mbështeten siç duhet dhe për të ndihmuar shkollat në **koordinim me prindërit** për të adresuar raste individuale. **Duhet të vazhdojë mbështetja e konsoliduar dhe monitorimi i vazhdueshëm i ekipeve komunale dhe shkollore, përfshirë këtu edhe shkollat e mesme të larta.** Instrumentet për mbledhjen e të dhënave për braktisjet dhe mos-regjistrimet ekzistojnë, por **planet e veprimit për parandalimin e braktisjeve dhe mos-regjistrimeve në shkolla duhet të hartohen në të gjitha komunat**. **Rritja e ndërgjegjësimit** në lidhje me arsimin e nxënësve të cenueshëm duhet të forcohet. **Monitorimi dhe vlerësimi i progresit** për parandalimin e braktisjeve dhe mos-regjistrimeve në shkolla duhet të **mbikëqyret më mirë**, përfshirë ngritjen e kapaciteteve të Inspektoratit të Arsimit. Duhet të përmirësohet **mësimnxënia e përshpejtuar për nxënësit që e kanë braktisur shkollën dhe identifikimi i hershëm** i rasteve të tilla.[42]

Synimi 1.8.: Ekzistojnë mekanizma dhe politika efektive për të promovuar diversitetin përmes një sistemi arsimor të integruar. Ky synim nuk është arritur pasi asnjë veprim nuk ka përfunduar. Aktiviteti i vetëm në 2017/18 nga Divizioni për arsimin gjithëpërfshirës, Zyra për komunitete, d.m.th. Udhëzimet për promovimin e dialogut midis komuniteteve, u hartua me mbështetje e OSBE-së, por nuk u nënshkrua nga ministri.[43] Ngjashëm, aktiviteti në lidhje me mësimdhënien në gjuhët e zonave lokale siç është parashikuar për vitin 2018 nuk u materializua dhe katër aktivitete të planifikuara për 2018 dhe 2019 nuk u realizuan: "(i) Zhvillimi i një Udhëzimi Administrativ për mësimdhënien në gjuhët e zonave lokale; (ii) Zhvillimi profesional i mësimdhënësve në gjuhën shqipe si gjuhë e dytë; (iii) Zhvillimi i materialeve përkatëse mësimore; dhe (iv) Vlerësimi i nevojave për zhvillimin e moduleve specifike të arsimit për komunitete."[44]

40 *Po aty*., f. 29.

41 OSBE: Pasqyra e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, 2020.

42 KEEN: Vlerësimi afatmesëm: Zbatimi i Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021, nëntor 2019, f. 31-32.

43 *Po aty*., f. 35.

44 *Po aty*.

3. Analiza e të gjitha raporteve përkatëse, ndërhyrjeve dhe arritjeve të bëra nga projekte të tjera të financuara nga donatorë ose organizata të shoqërisë civile në lidhje me gjendjen e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm

Qëllimi i këtij kapitulli është të analizojë raportet përkatëse, ndërhyrjet dhe arritjet e bëra nga projekte të tjera të financuara nga donatorë ose organizata të shoqërisë civile në lidhje me gjendjen e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm.[45] Analiza përqendrohet në çështjet e mbuluara nga këto projekte, në fushëveprimin e tyre gjeografik (dhe zonat e mundshme që mungojnë - të pambuluara nga projektet deri më tani), në kohëzgjatjen dhe qëndrueshmërinë e projekteve, në donatorët dhe preferencat e tyre në fushën e arsimit, në aktorët lokalë të përfshirë dhe në përfituesit (se sa individë ishin të përfshirë, se cilat ishin përfitimet e tyre të marra në bazë të projekteve individuale dhe për sa kohë ata mund të përfitonin nga projektet). Kapitulli përfundon me një vlerësim të përgjithshëm të 'peizazhit të projektit' në fushën e arsimit në tri nivelet e përfshira në projektin INCLUDE.

3.1 Peizazhi i projektit

3.1.1 Çështjet e mbuluara

Një numër projektesh janë përqendruar ekskluzivisht ose pjesërisht në çështjen e **mbledhjes së të dhënave**. Kjo është shumë e rëndësishme në mënyrë që të plotësojë regjistrimin e vitit 2011 dhe mbledhjen e rregullt të të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Projektet e mbuluan tërë Kosovën ose vetëm disa komuna (shumica e projekteve), disa u mbështetën në mbledhjen e të dhënave që ofrojnë informacion për statusin dhe gjendjen e këtyre komuniteteve dhe personave që u përkasin atyre, ndërsa shumë projekte gjithashtu kërkuan të kuptonin arsyet për të dhëna të caktuara (numrat) dhe pikëpamjet/perceptimet e palëve të ndryshme të interesit. Për këto qëllime, projektet zakonisht mbështeten në fokus grupe dhe intervista individuale (gjysmë të strukturuara), të cilat janë përdorur gjithashtu për të vlerësuar ndikimin (efektivitetin, efikasitetin) e projekteve.[46] Projektet për mbledhjen e të dhënave, nga njëra anë, kanë analizuar gjendjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, përfshirë arsimin me fokus në gjithëpërfshirjen e shkollave dhe përfundimin e shkollave, me të dhënat që pastaj shërbejnë për planifikimin e politikave konkrete thelbësore ose projekteve specifike për të adresuar disa nga problemet. Nga ana tjetër, disa projekte mblodhën të dhëna në kontekstin e një projekti specifik në një fushë të arsimit (p.sh. funksionimi i qendrave mësimore përmes shkallës së vijueshmërisë së fëmijëve

45 Një listë e projekteve përkatëse është në Shtojcën I më poshtë.

46 Shih një metodologji hulumtimi të strukturuar mirë të Studimit mbi ndikimin dhe qëndrueshmërinë e qendrave mësimore, 2015, f. 11–13.

dhe braktisjes së shkollës). Të dy llojet e analizave janë të vlefshme për planifikim të politikave dhe projekteve të mëtejshme nga autoritetet sepse kjo mund të bëhen vetëm në një mënyrë të informuar, bazuar në të dhëna të besueshme dhe gjithëpërfshirëse, të mbledhura gjatë kohës.

Disa projekte për mbledhjen e të dhënave që përqendrohen posaçërisht në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian dhe personat që u përkasin atyre siguruan fonde shtesë për Agjencinë e Statistikave të Kosovës që të jenë në gjendje të ofrojnë të dhëna të hollësishme për gjendjen e këtyre komuniteteve dhe personave që u përkasin atyre, duke marrë gjithashtu parasysh diversitetin brenda komuniteteve dhe perspektivën gjinore për mbledhjen e të dhënave. Një projekt i tillë gjithëpërfshirës, i cili e monitoroi gjendjen e fëmijëve dhe grave në këto komunitete, u krye në 2013–2014 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës,[47] i cili u mbështet financiarisht nga UNICEF-i, Austria, Luksemburgu, Fondi i Kombeve të Bashkuara mbi Popullsinë dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ndërsa mbështetja teknike u sigurua nga UNICEF-i (kjo anketë ishte pjesë e anketës grupore me shumë tregues, duke siguruar kështu mbledhjen e të dhënave globalisht të krahasueshme). Rezultatet e anketës (në të cilin u intervistuan 1,118 familje, 1,439 gra, 599 burra dhe 735 nëna (ose kujdestare) në emër të fëmijëve nën pesë vjeç), të paraqitura dhe të analizuara në një raport gjithëpërfshirës (më shumë se 300 faqe) ofruan një pasqyrë të hollësishme të gjendjes socio-ekonomike (karakteristikat e familjeve, vdekshmërinë e fëmijëve, ushqimin, shëndetin e fëmijëve, ujin dhe sanitarinë, shëndetit riprodhues, zhvillimin e fëmijërisë së hershme, shkrim-leximin dhe arsimin, mbrojtjen e fëmijëve, HIV/AIDS-in dhe sjelljen seksuale, qasjen në media masive dhe përdorimin e teknologjisë së informacionit/komunikimit, mirëqenien subjektive, përdorimin e duhanit dhe alkoolit).

Ndërsa një anketë e ndarë grupore me shumë tregues duke ndjekur të njëjtën metodologji u realizua për të gjithë Kosovën, rezultatet për tri komunitetet mund të krahasohen kundrejt popullatës së përgjithshme. Studimi demonstroi,[48] ndër të tjera, se vetëm 54% e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë që po vijonin klasën e parë të shkollës fillore kishin vijuar arsimin parashkollor vitin e kaluar (arsimi parashkollor ndiqej vetëm nga 16% e fëmijëve nga këto komunitete), ndërsa kjo përqindje ishte edhe më e ulët (48%) midis 60% të popullsisë më të varfër; vijueshmëria e shkollës ishte e ulët (15% e të gjithë fëmijëve të moshës së shkollës fillore ishin jashtë shkollës, me 38% të fëmijëve meshkuj të moshës 6-vjeçare që ishin jashtë shkollës; 21% e fëmijëve të moshës së shkollës së mesme të ulët ishin jashtë shkollës, me më shumë vajza që tani janë jashtë shkollës sesa djem - një ndryshim i trendit nga shkolla fillore; 70% e fëmijëve të moshës së shkollës së mesme të lartë ishin jashtë shkollës, nga këta 74% e fëmijëve femra ishin plotësisht jashtë shkollës në zonat rurale krahasuar me 45% të fëmijëve meshkuj), me barazinë gjinore në rënie; raporti djem - vajza ishte më shumë se 1.00 në shkollën fillore (pak më shumë vajza që vijonin shkollën fillore sesa djem), dhe ka rënë në 0.94 në kurriz të femrave në shkollën e mesme të ulët dhe në 0.80 në shkollën e mesme të lartë dhe madje në 0.41 në zonat rurale, që do të thotë se vajzat janë në mënyrë disproporcionale të cenueshme në shkollën e mesme të lartë në zonat rurale.[49]

47 Agjencia e Statistikave të Kosovës (2014): Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë (RKSOKB 1244). Anketa Grupore me Shumë Tregues 2013-2014.

48 Agjencia e Statistikave të Kosovë (2014): Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë (RKSOKB 1244). Anketa Grupore me Shumë Tregues 2013-2014, f. xxviii.

49 *Po aty*.

Meqenëse shumë projekte dhe strategji janë zbatuar që nga ky studim i madh, donatorët ndërkombëtarë duhet të ofrojnë çdo mbështetje të nevojshme për të mbledhur vazhdimisht të **dhëna të krahasueshme**, duke mundësuar kështu identifikimin e problemeve specifike me të cilat ballafaqohen këto komunitete dhe personat që u përkasin atyre, të problemeve që janë adresuar me sukses dhe të çështjeve që kanë nevojë për më shumë përpjekje ose për një qasje tjetër. Ky studim ofron një analizë gjithëpërfshirëse të faktorëve socio-ekonomikë, nga një **perspektivë gjinore**, si dhe duke marrë parasysh elementë të tjerë të **ndërthurjes**, siç janë vendbanimet rurale/urbane, por është e rëndësishme që të dhënat të kombinohen me të dhënat për **demografinë** (përkatësitë etnike, gjuhësore, fetare të popullatës) në mënyrë që të merret parasysh cenueshmëria e dyfishtë (statusi i pakicës së dyfishtë) të këtyre komuniteteve. Anketa në vazhdim e MICS 2019-20 nga UNICEF dhe të dhënat e saj do të ofrojnë një hap në drejtim të një mbledhje të krahasueshme të të dhënave në vazhdim, në mënyrë që të jenë në gjendje të vlerësojnë efektet e politikave dhe projekteve.

Rëndësia e arsimit gjithëpërfshirës cilësor për mundësitë e punës është demonstruar në një studim të vitit 2018 nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP) në komunat e Gjakovës, Fushë Kosovës dhe Graçanicës.[50] Fokus grupe të mbajtura me të rinj që u përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për të përcaktuar përvojën e tyre dhe perceptimin e pengesave për qasje të barabartë në tregun e punës - pas një projekti mbi Promovimin e mundësive për punë të denjë për të rinjtë romë në Evropën Qendrore dhe Lindore (zbatuar nga ONP dhe financuar nga Izraeli, 2015–2016) - kanë zbuluar një numër sfidash, përfshirë arritjet e ulëta në arsim, aftësitë joadekuate, varfërinë dhe diskriminimin, por edhe mungesën e njohurive të gjuhës shqipe në shumicën e të rinjve romë (por jo në mesin e ashkalinjëve dhe egjiptianëve) dhe 'normat kulturore' në lidhje me rolet e grave në shoqëri, të cilat ndikojnë negativisht në praninë e grave, aq më tepër të grave të reja, në tregun e punës që është përtej mundësive për shumë romë, ashkali dhe egjiptianë me normën e papunësisë prej 49% (e cila është 17% më e lartë sesa ajo e komuniteteve fqinje dhe 22% më e lartë se mesatarja kombëtare).[51]

Shqetësuese, 78% e personave që u përkasin tri komuniteteve të moshës midis 18 dhe 24 nuk ishin në arsim, punësim ose trajnim (NEET), në krahasim me 30% në shkallë vendi, gjë që kërkon mekanizma të gjerë dhe të koordinuar mirë të referimit për larguesit e hershëm nga shkolla.[52] E rëndësishmja, siç e ka theksuar kjo anketë (rezultatet e së cilës nuk mund të përgjithësohen për të gjitha komunitetet ose për tërë Kosovën për shkak të problemeve me përfshirjen e individëve në anketë)[53] dhe kjo është me rëndësi për projekte dhe aktivitete të tjera të zbatueshme për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në fusha të tjera, normat kulturore ndikojnë në pjesëmarrjen e grave në tregun e punës më shumë sesa përkatësia etnike ose arsimimi i tyre (gjë që i bën gratë rome, ashkali dhe egjiptiane veçanërisht të cenueshme), dhe perceptimet e individëve për institucionet (p.sh. besimi në institucione) ndikojnë në motivimin e tyre për bashkëpunim me institucionet.

Rezultatet pozitive në lidhje me përfshirjen e personave që u përkasin këtyre komuniteteve në fushën e punësimit janë arritur duke i përfshirë ato në procesin e hartimit të planeve lokale të veprimit në këtë fushë. Pjesëmarrja dhe bashkëpunimi i tyre me institucionet e hapën rrugën për ndërtimin e besimit të ndërsjellë dhe motivimin e tyre për të bashkëpunuar me institucionet publike.[54] Ky studim gjithashtu ka demonstruar se legjislacioni progresiv mund të zbatohet në mënyrë efektive vetëm nëse të gjithë sektorët dhe institucionet bashkëpunojnë në adresimin e

50 Perspektivat e të rinjve rom, ashkali dhe egjiptian mbi mundësitë dhe sfidat për punë të denjë në Kosovë, 2018.

51 Perspektivat e të rinjve rom, ashkali dhe egjiptian mbi mundësitë dhe sfidat për punë të denjë në Kosovë, 2018, Kapitulli 5.

52 *Po aty*., f. 18 dhe f. 45.

53 *Po aty*., f. 13–14 (mbi metodologjinë e hulumtimit).

54 *Po aty*., 2018.

sfidave me të cilat përballen personat që u përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, veçanërisht gratë e reja që janë më të pafavorizuara në tregun e punës.[55] Një perspektivë gjinore duhet të shkojë përtej mbledhjes së vetëm të të dhënave dhe duhet të bëjë që të gjitha programet dhe politikat "të adresojnë nevoja dhe shqetësime të ndryshme që krijohen për shkak të gjinisë ose përkeqësohen nga ajo".[56]

Pjesëmarrja efektive e personave që u përkasin komuniteteve që perceptohen zakonisht si përfitues është thelbësore për efektivitetin e masave të miratuara dhe zbatuara pasi pjesëmarrja e tillë hap rrugën për **ndërtimin e besimit**, **rrit motivimin** për t'u përfshirë dhe ndihmon adresimin e perceptimeve negative për institucionet dhe përvojën me to. Për më tepër, çështja e **gjinisë** duhet të **përfshihet** në të gjitha politikat dhe projektet pasi normat kulturore në lidhje me rolet e grave në shoqëri (negativisht) ndikojnë në përfshirjen e grave në shoqëri. **Institucionet publike duhet të bashkërendojnë** aktivitetet e tyre për të zbatuar në mënyrë efektive legjislacionin progresiv - projektet duhet ta marrin parasysh këtë dhe të mbështesin një **bashkëpunim të tillë ndër- dhe trans-sektorial**.

Analiza më e fundit dhe shumë gjithëpërfshirëse e gjendjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në 24 komuna (22 bazuar në rezultatet e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 dhe në Leposaviq dhe Mitrovicë Veriore, për secilën komunë veç e veç dhe të ndara sipas tri komuniteteve nëse janë në dispozicion, është përgatitur nga OSBE, bazuar në të dhënat e disponueshme në mars 2019.[57] Përmbledhja përfshin pesë fusha (strehimin dhe infrastrukturën, përfaqësimin në vendimmarrje, arsimin, punësimin dhe mirëqenien sociale dhe kujdesin shëndetësor) dhe përfshin informacione për romët në përdorim zyrtar në nivelin komunal, kur është e zbatueshme, dhe për çështjen e riatdhesimit. Këto të dhëna ofrojnë një pasqyrë shumë të rëndësishme të situatës në të gjitha komunat ku banojnë të tri komunitetet.

Shumica e projekteve në fushën e arsimit kanë adresuar nevoja specifike dhe probleme specifike me të cilat përballen personat që u përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Problemet më të mëdha në këtë drejtim, të cilat gjithashtu kanë tërhequr shumë vëmendje dhe mbështetje nga donatorët ndërkombëtarë janë: **vijueshmëria e parregullt e shkollës, nivelet e larta të braktisjes dhe mos-regjistrimit** (të ndara sipas niveleve të ndryshme të arsimit), **performanca jo e kënaqshme në shkollë dhe përfundimi i hershëm i arsimit**, si dhe **mungesa e përfshirjes sociale** (matur sipas treguesve të tillë si niveli bazë i mirëqenies, qasja e plotë në burime dhe aktivitete, pjesëmarrja shoqërore, mundësitë e barabarta, pranimi dhe njohja),[58] **gjë që ndikon negativisht në përfshirjen e shkollës**.[59]

Disa projekte kanë mbështetur **qendrat mësimore** (në vitin 2015, kishte mbi 40 qendra mësimore në 15 komuna,[60] ndërsa numri i tyre është rritur në 83 në 20 komuna në 2017/18[61]), të krijuara për të ndihmuar fëmijët **që të regjistrohen në shkolla të rregullta** (për t'u regjistruar ose ri-regjistruar), duke iu ndihmuar atyre me detyrat e shtëpisë, materiale edukative dhe pako shkollore, edukimin e fëmijëve që e kanë braktisur shkollën dhe ndihmën e tyre për të hyrë përsëri në shkollë, si dhe sigurimin e programeve parashkollore (në disa qendra mësimore) dhe

55 *Po aty*.

56 *Po aty*., f. 46.

57 OSBE: Pasqyra e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, 2020.

58 BE/KiE: Udhëzime për mësimdhënës për Përfshirjen Sociale të Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve në shkolla, 2015.

59 Shumë nga këto çështje janë adresuar brenda projekteve individuale dhe të mbështetura nga donatorë ndërkombëtarë siç renditen në seksionin 2.3 më lart.

60 Studimi mbi Ndikimin dhe Qëndrueshmërinë e Qendrave Mësimore, 2015.

61 KEEN: Vlerësimi afatmesëm: Zbatimi i Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021, nëntor 2019, f. 26-27.

aktivitete të tjera ekstra-kurrikulare (në sport, kulturë, arte), dhe për të **rritur ndërgjegjësimin** tek prindërit për rëndësinë e arsimit cilësor për të gjithë.[62] Në vitin 2015, një studim gjithëpërfshirës që mbulonte periudhën midis 2011 dhe 2015 arriti në përfundimin se qendrat mësimore luajtën rol të rëndësishëm pozitiv për fëmijët e të gjitha komuniteteve në fushën e arsimit, ku ky vlerësim u nda nga të gjitha palët e interesit, përfshirë donatorët, prindërit, mësimdhënësit, drejtorët e shkollave.[63] Kontributi pozitiv i qendrave mësimore është njohur vazhdimisht, por zhvendosja në mbështetjen e qendrave mësimore ka lëvizur në procesin e institucionalizimit të tyre (në përputhje me udhëzimet administrative qeveritare (MASHT): 12/2017[64]), i cili duhet t'i afrojë ata me shkollat, duke mundësuar kështu një bashkëpunim më të ngushtë me mësimdhënësit, dhe i cili duhet t'u sigurojë atyre një financim më të qëndrueshëm, përfshirë sa i përket disponueshmërisë së objekteve. Ky proces është ende për t'u kompletuar dhe mbështetur në mënyrë adekuate nga palë të ndryshme të interesit dhe kërkohet veprim i koordinuar, përfshirë nga donatorët, autoritetet (lokale dhe qendrore) dhe OJQ-të që i menaxhojnë qendrat mësimore siç rekomandohet në një studim gjithëpërfshirës të vitit 2018 të kryer në kuadër të projektit "Iniciativa e Kosovës për Integrim 2020 - KOSINT", mbështetur nga BE-ja dhe Fondacioni për Shoqëri të Hapur.[65]

> **Formimi dhe institucionalizimi** i qendrave mësimore duhet të vazhdojë dhe të përfundojë më shpejt në mënyrë që të zvogëlohet varësia e tyre nga donatorët individualë dhe të ndihmojë integrimin e tyre në sistemin arsimor, bazuar në standardet kombëtare, trajnimin dhe mbështetjen e duhur në mënyrë që ata të jenë në gjendje të vazhdojnë ofrimin e shërbimeve në mbështetje të qëllimeve strategjike arsimore në sistemin arsimor të Kosovës.

Programe trajnimi: Brenda programit të përbashkët midis BE-së dhe KiE-së "Rritja e Qasjes në Arsim dhe Mirëkuptim Ndërkulturor: Mbështetja e BE-së/KiE-së në fushën e arsimit për të kthyerit e detyruar dhe për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë*", u zhvillua një kurrikulë për kursin e trajnimit të mësimdhënësve në vend pune, me titull "Shkollat gjithëpërfshirëse që mbështesin arsimin e fëmijëve romë, ashkali, egjiptianë dhe të kthyer".[66] Kurrikula është hartuar për mësimdhënësit e të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar. Trajnimi do t'iu ofrohet ekipeve shkollore, të formuara dhe të mbështetura nga drejtori i shkollës dhe bordi i shkollës, dhe ekipet këshillohen të përbëhen nga tre mësimdhënës të arsimit fillor dhe tre të arsimit të mesëm, nga ata me përvojë dhe me më pak përvojë. Do të marrin pjesë në tri sesione trajnimi dhe nga pjesëmarrësit pritet të jenë të motivuar dhe të përkushtuar për të eksperimentuar me metoda të reja të mësimdhënies, për të zbatuar aktivitete dhe për të transferuar informacione dhe përvojë trajnimi tek kolegët e tyre.[67] Kjo kurrikulë është veçanërisht e dobishme pasi që adreson çështje të tilla si **bashkëpunimi me prindër, me ndërmjetësues dhe qendra mësimore, menaxhimi i konflikteve në punë ekipore në klasa** dhe çështje të tilla si **arsimi ndërkulturor dhe përfshirja sociale, roli i mësimdhënësve në riprodhimin e pabarazive, racizmit dhe diskriminimit, riatdhesimi dhe kthimi, fëmijët e cenueshëm, mbështetja emocionale, promovimi i vetëdijes për gjuhët dhe i diversitetit kulturor, arsimi ndërkulturor në të gjithë kurrikulën**.

62 Libri me ngjyra: Një tregim i Qendrave Mësimore (publikuar në katër gjuhë), një projekt i financuar nga BE-ja i menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë, implementuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur, 2012; Studim mbi ndikimin dhe qëndrueshmërinë e qendrave mësimore, 2015. I njëjti rekomandim është sugjeruar edhe në Fondacionin për Shoqëri të Hapur. Ndikimi i qendrave mësimore në gjithëpërfshirjen e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në arsim. Projekti "Iniciativa e Kosovës për Integrim 2020 - KOSINT", 2018, f. 47.

63 Studimi mbi Ndikimin dhe Qëndrueshmërinë e Qendrave Mësimore, 2015, Kapitulli 4.

64 Udhëzimi Administrativ (MASHT): 12/2017 për Themelimin dhe Funksionimin e Qendrave Mësimore), aprovuar nga MASHT më 28 gusht 2017, gjendet në: https://kosint2020.net/site/assets/files/1384/ua_masht_nr__12-2017_per_themelimin_dhe_funksionimin_e_qm_pdf.pdf.

65 Fondacioni për Shoqëri të Hapur. Ndikimi i qendrave mësimore në gjithëpërfshirjen e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në arsim. Projekti "Iniciativa e Kosovës për Integrim 2020 - KOSINT", 2018. Shih rekomandimet në f. 46-48.

66 BE/KiE: Kurrikula për kursin e trajnimit të mësimdhënësve në vend pune: Shkollat gjithëpërfshirëse që mbështesin arsimimin e fëmijëve romë, ashkali, egjiptianë dhe të kthyer, 2015.

67 Kjo është shumë e nevojshme duke pasur parasysh problemet e identifikuara nga hulumtuesit në të kuptuarit dhe mbi të gjitha në zbatimin e metodave moderne të mësimdhënies në klasa në Kosovë (shih, ndër të tjera, Zabeli, Anderson dhe Saqipi, 2018).

'Udhëzime për mësimdhënësit për Përfshirjen Sociale të Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve në shkolla', të shkruara brenda programit të përbashkët ACCESS: Rritja e Qasjes në Arsim dhe Mirëkuptim Ndërkulturor, financuar nga BE-ja dhe zbatuar nga Këshilli i Evropës,[68] u zhvilluan si rezultat i një procesi pune me pjesëmarrje në 11 shkolla pilot. Udhëzimet sigurojnë një analizë gjithëpërfshirëse të sfidave për përfshirjen sociale të nxënësve romë, ashkali dhe egjiptianë në shkolla, ato përqendrohen në parimet e përgjithshme dhe udhëzimet për përfshirjen sociale në shkollë siç janë korniza e të drejtave të njeriut, etika pozitive e shkollës, qasja pjesëmarrëse, vlerësimi i diversitetit, mirëpritja e fëmijëve të kthyer dhe të riatdhesuar.[69] Ato ofrojnë gjithashtu strategji dhe mjete për përfshirjen sociale në shkolla dhe për forcimin e saj. Ndërsa udhëzimet përqendrohen në promovimin e qasjes në arsim dhe në kultivimin e mirëkuptimit ndërkulturor midis të gjitha grupeve që jetojnë në Kosovë, ato mbesin shumë të rëndësishme në kontekstin e përmbushjes së objektivave strategjike në PSAK 2017-2021 për arsimin gjithëpërfshirës, përfshirë çështjen e promovimit të diversitetit. Udhëzimet janë informuar nga modeli i zhvillimit të shkollave gjithëpërfshirëse dhe të synuara për përfshirjen sociale të komuniteteve të cenueshme/të margjinalizuara dhe personave që u përkasin atyre, i cili bazohet në politikat gjithëpërfshirëse dhe të synuara dhe planet shkollore, zhvillimin e klasës, shërbimet mbështetëse dhe lidhjet e forta shkollë-prind-komunitet.[70] **Përfshirja sociale** kërkon **masa gjithëpërfshirëse** brenda **kornizës konceptuale për zhvillimin demokratik dhe gjithëpërfshirës të shkollave**.

> Programet dhe mundësitë e ndryshme të trajnimit duhet të **sistemohen** dhe zgjerohen në **programe të rregullta dhe përkatëse të trajnimit si pjesë thelbësore e zhvillimit profesional të mësimdhënësve, drejtorëve të shkollave dhe personelit tjetër arsimor**. Ngjashëm, trajnimi sistematik duhet të zhvillohet dhe t'u ofrohet rregullisht **zyrtarëve**, veçanërisht në nivelet komunale, që punojnë në fushën e arsimit gjithëpërfshirës siç zbatohet për komunitetet e cenueshme/të margjinalizuara dhe në përputhje me objektivat strategjike të Kosovës në fushën e arsimit. Programet e trajnimit duhet të jenë sistematike dhe **të përfshijnë audienca të tëra të synuara**, jo vetëm thjesht një numër të caktuar individësh në disa pjesë të Kosovës.

Mbështetja në zotimin moral të shkollave dhe edukimeve individuale ose në aktivitete të izoluara dhe iniciativa ekstra-kurrikulare nuk mund të kompensojë mungesën e masave gjithëpërfshirëse.[71] Këto udhëzime marrin një qasje sistematike pasi ato synojnë të mbështesin "përpjekjet e vazhdueshme të sistemit arsimor të Kosovës për të promovuar qasjen në arsim dhe përfshirjen sociale të nxënësve romë, ashkali dhe egjiptianë si dhe ri-integrimin e të kthyerve" - qoftë në mjedise të larmishme shkollore ose në shkolla homogjene pasi që udhëzimet "promovojnë idenë që të gjithë nxënësit kanë nevojë për arsim ndërkulturor për t'u përgatitur për të jetuar në një shoqëri multikulturore".[72] Udhëzimet synojnë të rrisin **vetëdijesimin e mësimdhënësve** për rolin dhe përgjegjësitë e tyre në këtë proces, të sigurojnë informacion mbi **qasjet dhe metodologjitë holistike**, të promovojnë strategji dhe aktivitete në shkolla dhe në klasa, të krijojnë mundësi edhe për **përfshirje aktive të mësimdhënësve në reflektim kritik ose praktikim të tyre, shkëmbime të përvojave ndërmjet kolegëve** dhe të krijojnë mundësi për **bashkëpunim me komunitetin e gjerë**.[73] Udhëzimet janë të nevojshme por jo të mjaftueshme për praktikimin efektiv të përfshirjes sociale; ato duhet të mbështeten me materiale trajnimi dhe për mësimdhënie, gjë që kërkon mbështetje nga politikë-bërësit dhe autoritetet arsimore.

68 BE/KiE: Udhëzime për mësimdhënës për Përfshirjen Sociale të Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve në shkolla, 2015.

69 *Po aty*., kapitulli 3.

70 *Po aty*., f. 7.

71 *Po aty*., f. 8.

72 *Po aty*., f. 9.

73 *Po aty*., f. 10.

Përfshirja në arsim, me fokus të veçantë në arsimin parashkollor dhe të mesëm të lartë: Ka pasur shumë aktivitete për të adresuar çështjen e vijueshmërisë së shkollës,[74] veçanërisht në arsimin parashkollor dhe të mesëm të lartë ku komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian vazhdojnë të jenë të nën-përfaqësuara. Si rrjedhojë, planet komunale të veprimit kanë parashikuar një numër masash (p.sh. kuota, transporti, paketa shkollore, bursa) për të përmirësuar vijueshmërinë e shkollës, por vetëm disa nga ato masa janë zbatuar.[75] Një projekt[76] i mëparshëm kishte zbuluar se një sërë faktorësh ndikojnë në vijueshmërinë e shkollës dhe ato mund të grupohen në faktorë individualë, faktorë në familje, faktorë në shkollë (përfshirë vlerat dhe qëndrimet e mësimdhënësve jo në përputhje me parimet e shoqërisë demokratike dhe arsimin gjithëpërfshirës) dhe faktorë socialë.[77] Si rrjedhojë, vetëm **një qasje multi-sektoriale, me shumë nivele dhe me shumë aktorë** mund të adresojë në mënyrë efektive këtë çështje, e cila vazhdoi pavarësisht nga shumë projekte dhe vëmendje e konsiderueshme që i kushtohej çështjes (edhe pse ca progres është arritur gjatë viteve). Një qasje e tillë e koordinuar është e nevojshme edhe në adresimin e problemit të mos-vijueshmërisë së shkollës nga qendra mësimore, ku autoritetet, donatorët, OJQ-të duhet të luajnë një rol proaktiv në alokimin e burimeve në mënyrë sistematike, pa dyfishim të punës, për të ndihmuar qendrat mësimore për të siguruar mbështetjen përkatëse dhe të nevojshme për fëmijët nga komunitetet në nevojë për të qenë në gjendje të vijojnë dhe të përfundojnë të gjitha nivelet e arsimit, ndërsa alokimi disproporcional i burimeve në qendrat mësimore duhet të shmanget nga donatorët dhe financimi i rregullt nga buxheti i shtetit duhet të avokohet dhe të sigurohet.[78]

> Meqenëse çështja e përfshirjes në shkollë (vijueshmëria e shkollës) i nënshtrohet shumë faktorëve, hendeku në lidhje me këtë çështje midis popullatës së përgjithshme dhe komuniteteve rom, ashkali, egjiptian ose komuniteteve të tjera të cenueshme/të margjinalizuara kërkon **një qasje multi-sektoriale, në shumë nivele dhe me shumë aktorë**. Vëmendje duhet t'i kushtohet **koordinimit dhe bashkëpunimit** të palëve përkatëse të interesit, në një kohë dhe në mënyrë sistematike për të siguruar vijueshmërinë e shkollës në të gjitha nivelet e arsimit për të gjithë individët.

Ngritja e vetëdijesimit: Megjithëse ndërgjegjësimi për rëndësinë e arsimit gjithëpërfshirës vazhdon të jetë i pamjaftueshëm (dhe ekziston nevoja për ngritjen e vetëdijes edhe për të luftuar diskriminimin),[79] përfshirë në mesin e prindërve,[80] ndërsa disa palë të tjera të interesit duket se kanë mungesë të të kuptuarit të plotë të arsimit gjithëpërfshirës dhe mjeteve për ta zbatuar atë në praktikë, projektet kanë dështuar të zhvillojnë dhe zbatojnë aktivitete sistematike dhe efektive të ndërgjegjësimit dhe në vend të kësaj janë përqendruar në ngjarje të veçanta. Disa projekte të tjera kanë demonstruar fuqinë e programeve[81] të synuara dhe të planifikuara mirë për rritjen e ndërgjegjësimit, kështu që ky aspekt duhet të forcohet.

74 KEC: Analizë e shpejtë. Përfshirja e fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parashkollor dhe fillor (Prizren, Gjakovë dhe Ferizaj), 2015.

75 KEEN: Gjendja e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunat e Kosovës. Raporti i monitorimit për zbatimin e planeve lokale të veprimit në fushën e arsimit dhe punësimit në gjashtë (6) komuna të Kosovës: Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë dhe Lipjan, 2019.

76 KEC: Analizë e shpejtë. Përfshirja e fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parashkollor dhe fillor (Prizren, Gjakovë dhe Ferizaj), 2015, f. 17-19.

77 Shih edhe Fondacioni për Shoqëri të Hapur. Ndikimi i qendrave mësimore në gjithëpërfshirjen e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në arsim. Projekti "Iniciativa e Kosovës për Integrim 2020 - KOSINT", 2018.

78 *Po aty*., rekomandimet në f. 46-48.

79 BE/KFOS: Zbatimi i Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017. Raporti i vlerësimit, 2017.

80 *Po aty*.

81 P.sh. GIZ: Studim shoqërues për zbatimin e aktiviteteve të projektit CDBE të GIZ-it. Komponenti për përfshirjen arsimore të të kthyerve dhe pakicave etnike, GIZ, 2018.

Rritja e ndërgjegjësimit duhet të bazohet në një plan veprimi në mënyrë që të kalojë nga ngjarjet individuale në një **strategji gjithëpërfshirëse** që do të kërkojë **të synojë palë individuale të interesit** bazuar në vlerësimin e nevojave dhe në përputhje me qasjen më të mirë për kategorinë specifike të palëve të interesit dhe rolin e tyre të pritur në ndihmën për të përmbushur objektivat strategjike të arsimit në Kosovë.

Trajnimi i komunave/zyrtarëve komunalë: Një nga projektet e (më të) rralla që përqendrohet te zyrtarët komunalë me qëllim të përmirësimit të ofrimit të arsimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian është manuali i përgatitur nga Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve (ECMI) në Kosovë në vitin 2012.[82] Manuali u përgatit si pjesë e projektit Përmirësimi i Ofrimit të Arsimit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës (2011–2012), mbështetur nga UNICEF-i, me synimin për të forcuar kapacitetet e zyrtarëve komunalë për të zbatuar pjesën e arsimit në planin komunal të veprimit brenda Strategjisë së mëparshme kombëtare për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2009–2015. Megjithëse manuali është përgatitur në një kornizë specifike të politikave, qasja e tij sistematike për përgatitjen, funksionalizimin, zbatimin dhe monitorimin e një plani veprimi komunal siguron një kornizë shumë të dobishme për çdo objektiv specifik në ofrimin e shërbimeve në nivelin komunal, i cili përfshin rekomandime për **mbledhje të të dhënave, vlerësim dhe hulumtim të nevojave, shtrirje, bashkërendim dhe bashkëpunim ndërmjet palëve përkatëse të interesit** dhe për mënyrën e përgatitjes së **monitorimit, vlerësimit dhe raportimit gjithëpërfshirës** (nëse kërkohet). Si i tillë, manuali mund të shërbejë si bazë për çdo program trajnimi që i ndihmon zyrtarët komunalë t'i përmbushin objektivat e arsimit.

Meqenëse komunat luajnë rol shumë të rëndësishëm në të gjithë sistemin arsimor, **trajnimi i synuar për zyrtarët komunalë** duhet të zhvillohet dhe të ofrohet si pjesë thelbësore e **zhvillimit profesional** të tyre. Trajnimi i tillë duhet të zhvillohet bazuar në vlerësimin e nevojave reale dhe me synimin për të përmirësuar **kapacitetin dhe kompetencat** e tyre në përmbushjen e objektivave strategjike të arsimit në lidhje me cilësinë dhe arsimin gjithëpërfshirës, të zbatueshëm për komunitetet e cenueshme/të margjinalizuara dhe **duke marrë parasysh diversitetin e një konteksti lokal specifik dhe nevojat e larmishme të personave që u përkasin atyre komuniteteve**.

Përgatitja e planeve lokale të veprimit dhe monitorimi i tyre: Pjesa më e madhe e projekteve të analizuara mbulojnë zhvillimin e planeve lokale të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian (p.sh. në Fushë Kosovë,[83] Ferizaj,[84] Gjakovë,[85] Graçanicë,[86] Lipjan,[87] Prizren[88]),[89] planet e zhvillimit të arsimit në komuna (p.sh. në Ferizaj,[90] Gjakovë,[91] Gjilan,[92] Mitrovicë,[93] Pejë,[94]

82 ECMI në Kosovë: Përmirësimi i ofrimit të arsimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian: Manual i praktikave të mira dhe rekomandimeve për zyrtarët komunalë, 2012.

83 Plani lokal i veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës 2018-2021.

84 Plani lokal i veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Ferizajt 2017-2021.

85 Plani lokal i veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Gjakovës, 2018-2022.

86 Plani lokal i veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Graçanicës 2018-2022.

87 Plani lokal i veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Lipjanit 2018-2022.

88 Plani lokal i veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prizrenit 2019-2023.

89 Vini re se të gjitha dokumentet referohen duke ndjekur titujt e tyre realë, prandaj në shumë raste, emrat e komunave shfaqen vetëm në një gjuhë.

90 Plani i zhvillimit të arsimit i Komunës së Ferizajt 2018-2022.

91 Plani i zhvillimit të arsimit i Komunës së Gjakovës 2017-2021.

92 Plani i zhvillimit të arsimit i Komunës së Gjilanit 2017-2021.

93 Plani i zhvillimit të arsimit i Komunës së Mitrovicës 2018-2022.

94 Plani i zhvillimit të arsimit i Komunës së Pejës 2018-2022.

Prishtinë,[95] Prizren,[96] Suharekë[97]), dhe monitorimin[98] e zbatimit të atyre planeve lokale të veprimit. Të gjitha këto aktivitete janë mbështetur nga projekti i financuar nga BE-ja "Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim - KEEN", i zbatuar nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në bashkëpunim me disa partnerë: Agjensioni i Përkrahjes së Punësimit Kosovë (APPK), Balkan Sunflowers Kosova (BSFK), Academy for Training and Technical Assistance (ATTA) dhe Stichting SPARK. Shqetësuese, **zbatimi i tyre është problematik**: "komunat i kushtojnë shumë pak vëmendje zbatimit të aktiviteteve të parashikuara me planet strategjike", "objektivat strategjike të përcaktuara në fushën e arsimit dhe punësimit mbeten larg përmbushjes, kryesisht për shkak të mungesës së vullnetit politik dhe burimeve financiare dhe njerëzore për të zbatuar aktivitetet" dhe bashkërendimi i dobët midis niveleve qendrore dhe lokale dhe OShC-ve të përqendruara në terren, kështu që nuk është për t'u habitur që "shumica e aktiviteteve të realizuara janë kryesisht ato të kryera nga OShC-të dhe partnerët e zhvillimit të angazhuar në këtë fushë, gjë që dëshmon mungesën e vullnetit të autoriteteve lokale për të zbatuar aktivitetet."[99] E rëndësishmja, disa plane përmbajnë aktivitete që janë të vështira për t'u zbatuar, kështu që ekziston nevoja për rishikimin e tyre bazuar në nevojat dhe kompetencat e komunave.[100]

3.1.2 Fushëveprimi gjeografik i projekteve

Në Kosovë, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë të shpërndarë, kryesisht duke jetuar në 24 komuna, por ata janë më të përqendruar në komunat e Ferizajt, Fushë Kosovës, Gjakovës, Pejës dhe Prizrenit. Prandaj, projektet në fushën e arsimit që përqendrohen në këto komunitete janë kryer në të gjitha këto (më rrallë) ose në disa prej këtyre komunave. Disa komuna duket se janë veçanërisht të përfshira në këto projekte. Në këtë aspekt, është bërë përpjekje e madhe në planet lokale të veprimit në fushën e arsimit dhe punësimit në komunat e Prizrenit, Gjakovës, Ferizajt, Fushë Kosovës, Graçanicës, Lipjanit, Pejës, Prishtinës, Mitrovicës, Gjilanit dhe Suharekës.[101] Këto plane veprimi për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe planet e zhvillimit të arsimit ofrojnë një pamje shumë gjithëpërfshirëse të situatës në komuna individuale dhe të nevojave (çështjeve) për t'u zbutur, por zbatimi i tyre ka qenë jashtëzakonisht i pamjaftueshëm.[102]

Në lidhje me disa çështje specifike që duhet të adresohen, duket se ekziston nevoja për të kaluar nga projektet me bazë komunale në një qasje **më sistematike** (me bazë në Kosovë) që duhet të plotësohet me projekte të mbështetura nga donatorë individualë, në vend se të udhëhiqen nga disa prej donatorëve ndërkombëtarë thelbësorë.

> **Planet komunale të veprimit dhe planet e zhvillimit të arsimit** janë përgatitur bazuar në vlerësimin e nevojave në terren, por ato tani **duhet të zbatohen në mënyrë efektive**. Për këtë qëllim, **vullneti dhe zotimi politik** duhet të përmirësohen ndjeshëm dhe, si rrjedhojë, **burimet e duhura financiare dhe njerëzore të alokuara** për zbatimin e tyre. Në këtë kontekst, donatorët ndërkombëtarë duhet të promovojnë **pronësinë lokale** dhe të mbështesin iniciativa dhe orientimin strategjik në këtë drejtim.

95 Plani i zhvillimit të arsimit i Komunës së Prishtinës 2018-2022.

96 Plani i zhvillimit të arsimit i Komunës së Prizrenit 2017-2021.

97 Plani i zhvillimit të arsimit i Komunës së Suharekës 2019-2023.

98 KEEN: Gjendja e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunat e Kosovës. Raporti i monitorimit për zbatimin e planeve lokale të veprimit në fushën e arsimit dhe punësimit në gjashtë (6) komuna të Kosovës: Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë dhe Lipjan, 2019.

99 KEEN: Gjendja e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunat e Kosovës. Raporti i monitorimit për zbatimin e planeve lokale të veprimit në fushën e arsimit dhe punësimit në gjashtë (6) komuna të Kosovës: Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë dhe Lipjan, 2019, f. 8.

100 KEEN: Gjendja e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunat e Kosovës. Raporti i monitorimit për zbatimin e planeve lokale të veprimit në fushën e arsimit dhe punësimit në gjashtë (6) komuna të Kosovës: Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë dhe Lipjan, 2019, f. 9.

101 Shih listën e projekteve në Shtojcën I.

102 KEEN: Gjendja e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunat e Kosovës. Raporti i monitorimit për zbatimin e planeve lokale të veprimit në fushën e arsimit dhe punësimit në gjashtë (6) komuna të Kosovës: Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë dhe Lipjan, 2019.

3.1.3 Kohëzgjatja e projekteve dhe vazhdimësia

Projektet e analizuara në këtë studim kanë pasur gjatësi shumë të ndryshme, por ajo që është e përbashkët për ta është se gjatësia varet nga ciklet e financimit të donatorëve, sesa nga nevojat në terren. Sidoqoftë, disa donatorë janë përfshirë për një periudhë më të gjatë, por me projekte të përsëritura mjaft afatshkurtra. Shumë projekte zgjatën vetëm një vit ose dy vjet. Ndërsa ndihma dhe mbështetja e donatorëve ka qenë thelbësore dhe vazhdon të jetë thelbësore, ciklet e tilla afatshkurtra të projekteve janë në shumë aspekte të vështira për partnerët zbatues si dhe për efektivitetin e politikave që kërkojnë një mbështetje dhe përfshirje të vazhdueshme afatgjate.

3.1.4 Donatorët dhe fokusi i tyre specifik

Është e pamundur të deshifrosh ndonjë fokus specifik të donatorëve për disa aspekte, apo edhe mosgatishmërinë e tyre të mundshme për të mbështetur iniciativa të tjera, si dhe pjesën e tyre në fondet e përgjithshme të siguruara për funksionimin e programeve, aktiviteteve individuale ose për të adresuar problemet individuale të tri komuniteteve (komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian) dhe të personave që u përkasin atyre me të cilat përballën. Megjithëkëtë, BE-ja ka mbështetur financiarisht shumë iniciativa të bazuara në sistem, të zbatuara shpesh nga KiE-ja dhe organizatat lokale të shoqërisë civile profesionale që punojnë në fushën e arsimit gjithëpërfshirës cilësor. Nisma të tilla të bazuara në sistem kanë përfshirë zhvillimin e udhëzimeve, kurrikulave ose dokumenteve të politikave, përfshirë planet e veprimit, por edhe monitorimin e zbatimit të tyre, përfshirë në nivelin e komunave. Zhvillimi i planeve lokale të veprimit në fushën e arsimit dhe punësimit dhe monitorimi i tyre bien në sy si në këtë aspekt, por edhe vetë mbështetja për Rrjetin e Kosovës për Arsim dhe Punësim (KEEN).

Në lidhje me çështje të veçanta të zbatueshme për përmirësimin e qasjes në arsimin gjithëpërfshirës, zakonisht, disa donatorë mbështesin programe individuale dhe është e paqartë nga raportet në dispozicion nëse ekziston ndonjë konkurrencë e përgjithshme ose mungesë koordinimi midis tyre ose midis partnerëve vendorë zbatues dhe donatorëve. Një çështje që shfaqet nga analiza e donatorëve për programe të tilla si qendrat mësimore është një numër relativisht i lartë i donatorëve për qendrat e drejtuara nga OJQ individuale: p.sh. 25 donatorë ndërkombëtarë (organizata ndërkombëtare dhe organizata bamirësie), shtetërorë (MASHT-i) dhe donatorë lokalë (komuna) për qendrat mësimore të Balkan Sunflowers (pesë në katër komuna).[103] Një numër kaq i lartë i donatorëve ka shumë të ngjarë të ndikojë në funksionimin e qendrave për shkak të barrës administrative dhe bashkërendimit me kaq shumë donatorë. Në të vërtetë, një numër i lartë i donatorëve që mbështesin qendrat mësimore u shënua nga "mungesa e dukshme e bashkëpunimit dhe koordinimit midis tyre".[104] Përfaqësuesit e organizatave donatore, në intervista për të vlerësuar funksionimin dhe financimin e qendrave mësimore, vetë pranuan se kishte dyfishim të financimit të projekteve të njëjta ose të ngjashme dhe se kishte nevojë që autoritetet (komunat) t'i koordinojnë donatorët, dhe që autoritetet qendrore t'i sjellin këto qendra në sistemin arsimor formal, të zhvillojnë një strategji për këtë qëllim,[105] dhe ta zbatojnë në mënyrë efektive udhëzimin administrativ 12/2017.[106]

103 Studimi mbi ndikimin dhe qëndrueshmërinë e qendrave mësimore, 2015, f. 15-16.

104 Po aty., f. 31.

105 Po aty. Shih edhe Fondacioni për Shoqëri të Hapur. Ndikimi i qendrave mësimore në gjithëpërfshirjen e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në arsim. Projekti "Iniciativa e Kosovës për Integrim 2020 - KOSINT", 2018.

106 Udhëzimi Administrativ (MASHT): 12/2017 për Themelimin dhe Funksionimin e Qendrave Mësimore), aprovuar nga MASHT-i më 28 gusht 2017.

Nga ana tjetër, Qendrat Mësimore të Terre des Hommes (shtatë në katër komuna) janë mbështetur nga dy donatorë kryesorë: Ndihma e Kishave Zvicerane dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.[107] Në përgjithësi (dhe jo domosdoshmërisht i zbatueshëm për këtë rast), kjo paraqet një rrezik të varësisë nga interesat dhe vlerat specifike të një donatori të vetëm, si dhe rrezikun e harxhimit të fondeve nëse ky donator (ose një numër i vogël i tyre) vendos të tërheqë mbështetjen e tij për programet specifike. Një rrezik i tillë rritet në mungesë të ndonjë udhëzuesi kombëtar për një aktivitet ose program specifik, i cili në rastin e qendrave mësimore në periudhën e analizuar (2011–2015) do të thoshte që funksionimi i tyre varej nga OJQ-të, komunitetet lokale ose donatorët.[108] Në të vërtetë, ky rrezik është njohur nga MASHT-i, i cili e ka mbajtur premtimin për të hartuar një udhëzim administrativ për formimin dhe funksionimin e qendrave mësimore,[109] me miratimin në gusht 2017 të udhëzimit administrativ 12/2017.[110]

Në përgjithësi, disa organizata ndërkombëtare (p.sh. BE-ja, OKB-ja me agjenci dhe fonde, programe dhe truste, KiE-ja, OSBE-ja), qeveri (p.sh. Austria, Luksemburgu, Mbretëria e Bashkuar, Finlanda, Holanda, Norvegjia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Republika Çeke, Zvicra dhe të tjera) dhe OJQ dhe donatorë të tjerë ndërkombëtarë (të bazuar në qeveri) (p.sh. GIZ-i,[111] Instituti për Shoqëri të Hapur - OSI,[112] Fondacioni për Shoqëri të Hapur - OSF,[113] Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve - ECMI, USAID) paraqiten më shpesh si donatorë në projekte që adresojnë aspekte të ndryshme të qasjes në arsim cilësor për personat që u përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian si dhe komuniteteve të tjera të cenueshme. Këto projekte, të zbatuara shpesh nga KiE-ja dhe OJQ-të lokale/OSHC-të dhe rrjete (të tilla si rrjeti KEEN, Qendra për Arsim e Kosovës - KEC, Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur - KFOS,[114] VoRAE, HEKS, REF dhe të tjerë) janë veçanërisht efektive kur ato janë krijuar dhe realizuar **për të mbështetur strategjitë kombëtare** (në arsim ose në lidhje me përfshirjen e personave që u përkasin komuniteteve pakicë) për të ndihmuar këto komunitete dhe personat që u përkasin atyre t'i adresojnë cenueshmëritë e tyre dhe të arrijnë barazinë në qasjen në arsim cilësor me qëllim të arritjes së rezultateve të tyre të barabarta arsimore. Ngjashëm, kur **problemet specifike janë identifikuar nga organet ndërkombëtare të monitorimit** (të tilla si Komiteti Këshillëdhënës nën Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare të KiE-së),[115] ato mund të trajtohen drejtpërdrejt nga projekte individuale, gjë që nuk ka qenë rasti i projekteve të analizuara për këtë Studim hulumtues.

Problemi që po rishfaqet nëpër projekte të ndryshme është problemi i **varësisë nga donatorët** për zbatimin e shumë aspekteve të arsimit gjithëpërfshirës, veçanërisht për shkak të mungesës së burimeve financiare dhe njerëzore në nivelin lokal, por edhe të mungesës së vullnetit politik për t'i siguruar ato dhe për të zbatuar plane lokale të veprimit në fushën e arsimit.[116] Në lidhje me

107 Studimi mbi ndikimin dhe qëndrueshmërinë e qendrave mësimore, 2015, f. 17-18.

108 *Po aty*., f. 24.

109 *Po aty*.

110 Udhëzimi Administrativ (MASHT): 12/2017 për Themelimin dhe Funksionimin e Qendrave Mësimore), aprovuar nga MASHT-i më 28 gusht 2017.

111 P.sh. GIZ: Studim shoqërues për zbatimin e aktiviteteve të projektit CDBE të GIZ-it. Komponenti për përfshirjen arsimore të të kthyerve dhe pakicave etnike, GIZ, 2018.

112 Shih, ndër shumë të tjerë, Fondacioni për Shoqëri të Hapur BE/Kosovë: Libri me ngjyra: Një tregim i Qendrave Mësimore (publikuar në katër gjuhë), një projekt i financuar nga BE i menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë, implementuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur, 2012.

113 Fondacioni për Shoqëri të Hapur. Ndikimi i qendrave mësimore në gjithëpërfshirjen e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në arsim. Projekti "Iniciativa e Kosovës për Integrim 2020 - KOSINT", 2018.

114 BE/KFOS: Zbatimi i Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017. Raporti i vlerësimit, 2017.

115 Perspektivat e të rinjve rom, ashkali dhe egjiptian mbi mundësitë dhe sfidat për punë të denjë në Kosovë, 2018, f. 41; Komiteti Këshillimor për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Opinioni i Katërt mbi Kosovën* - miratuar më 8 mars 2017, ACFC/OP/IV(2017)001.

116 KEEN: Gjendja e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunat e Kosovës. Raporti i monitorimit për zbatimin e planeve lokale të veprimit në fushën e arsimit dhe punësimit në gjashtë (6) komuna të Kosovës: Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë dhe Lipjan, 2019, f. 9.

mbështetjen e donatorëve për qendrat mësimore, një ndryshim ka ndodhur me kalimin e viteve.[117] Gjegjësisht, autoritetet (MASHT-i, drejtoritë komunale të arsimit dhe qendrat mësimore) kanë nënshkruar një numër memorandumesh për të siguruar hapësirë shkollore për qendrat mësimore dhe për të kompensuar kostot mujore për qiranë, energjinë elektrike, ngrohjen etj. Ky është një hap i rëndësishëm në të paktën dy aspekte: së pari, për të kapërcyer problemin e varësisë nga donatorët për funksionimin e qendrave dhe për rritjen e financave për aktivitetet reale në vend të infrastrukturës bazë; së dyti, që fëmijët të vizitojnë qendrat mësimore dhe të vijojnë aktivitete të ndryshme në shkollë ose për t'i sjellë përsëri në shkolla. Sidoqoftë, është e rëndësishme që qendrat mësimore të mos bëhen (të mos perceptohen si) hapësira të ndara vetëm për fëmijët që u përkasin komuniteteve të cenueshme. Në vend të kësaj, duhet të sigurohet mbështetje p.sh. për aktivitete ekstra-kurrikulare për të gjithë fëmijët me interesime specifike (p.sh. në sport, art, muzikë), pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike. Projekte të tilla do të kontribuojnë në ndërveprime dhe kompetenca ndërkulturore dhe ndërmjet kulturave, dhe përfundimisht në integrimin shoqëror.

3.1.5 Aktorët lokalë të përfshirë (implementimi i projekteve)

Shumë prej projekteve janë implementuar nga shoqëria civile (OJQ/OSHC), lokale/kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat luajtën dhe vazhdojnë të luajnë role të rëndësishme në aspekte të ndryshme të mbështetjes së arsimit gjithëpërfshirës. Për shembull, organizatat që ishin pjesë e rrjetit[118] KEEN luajtën rol kryesor në zhvillimin e planeve komunale të veprimit dhe planeve të zhvillimit të arsimit për periudhat ndërmjet 2017 dhe 2023, në varësi të komunave individuale (shih më poshtë), KEC dhe shumë OSHC të tjera. Për më tepër, qendrat mësimore u menaxhuan plotësisht nga gjashtë OJQ në periudhën 2011–2015: Balkan Sunflowers Kosova, Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve, Caritas Kosova, The Ideas Partnership, dhe OSHC ndërkombëtare si Terre des Hommes, dhe Bethany Christian Services.[119] Një projekt për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parashkollor dhe fillor në komunat e Prizrenit, Gjakovës dhe Ferizajt u implementua nga KEC-i.[120] Rrjeti i romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve kosovarë për zhvillimin e fëmijërisë së hershme (KRAEEYN) është ende aktiv.[121]

3.1.6 Përfituesit (numri, përfitimet, kohëzgjatja)

Nuk mund të ketë përfundim të përgjithësuar në lidhje me përfituesit; në të vërtetë, raportet e ndryshme rreth projekteve vështirë se diskutojnë këto çështje, përveç kur aktivitete specifike kryhen personalisht dhe numri i përfituesve të drejtpërdrejtë (p.sh. nxënësit, mësimdhënësit, komunat) mund të sigurohet. Sidoqoftë, një përjashtim i dukshëm nga kjo janë disa analiza që janë kryer për efektivitetin dhe efikasitetin e qendrave mësimore, të cilat zakonisht janë njohur se kanë luajtur rol shumë pozitiv në ndihmën ndaj personave që u përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian pasi gjithnjë e më shumë edhe fëmijë të tjerë të margjinalizuar nga komunitetet në nevojë (pakica të tjera ose fëmijë emigrantësh), kanë qasje në arsim cilësor, si në aspektin e shkuarjes në shkollë rregullisht ashtu edhe në aspektin e rezultateve arsimore. Megjithëse është e vështirë të vendosësh një lidhje të drejtpërdrejtë midis përfshirjes së një fëmije në një qendër mësimore dhe performancës së tij/saj më të mirë në sistemin arsimor formal, gjë që pretendojnë disa studime,[122] efektet e tyre janë padyshim pozitive. Kjo është demonstruar në një vlerësim tre-

117 Studimi mbi ndikimin dhe qëndrueshmërinë e qendrave mësimore, 2015, f. 24.

118 Rrjeti KEEN ishte një projekt i financuar nga BE-ja i menaxhuar nga një koalicion i OJQ-ve, KEC dhe organizata partnere, Akademia për Trajnim dhe Ndihmë Teknike (ATTA), Balkan Sunflowers Kosova (BSFK) dhe SPARK.

119 Studimi mbi Ndikimin dhe Qëndrueshmërinë e Qendrave Mësimore, 2015.

120 KEC: Analizë e shpejtë. Përfshirja e fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parashkollor dhe fillor (Prizren, Gjakovë dhe Ferizaj), 2015.

121 Shih https://www.facebook.com/kraeeyn/.

122 Libri me ngjyra: Një tregim i Qendrave Mësimore (publikuar në katër gjuhë), një projekt i financuar nga BE i menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë, implementuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur, 2012.

vjeçar të performancës shkollore të rreth 50 fëmijëve që vijuan arsimin fillor (klasat 1 deri në 5) dhe programet në një qendër mësimore.[123] Veçanërisht, numri i fëmijëve të përfshirë në këto qendra është i konsiderueshëm. Ndërmjet periudhës 2011 dhe 2015, aktivitetet në rreth 40 qendra mësimore në 15 komuna, të menaxhuara nga gjashtë OJQ, i vijuan rreth 8,310 fëmijë, me një kosto mesatare për fëmijë që ishte 123.10 EUR,[124] ndërsa 83 qendra mësimore ekzistuese në 2017/18 në 20 komuna raportohet të kenë përfituar 5,555 fëmijë.[125] Më tej, ndikimi i punës së qendrave mësimore është matur vazhdimisht në përmirësimin e niveleve të braktisjes dhe vijueshmërisë së shkollës (ku faktorë të tjerë mund të kenë luajtur gjithashtu një rol në këtë proces).[126]

Meqenëse projektet kanë një fokus tjetër, përfituesit do të ndryshojnë domosdoshmërisht. Ata që janë më të orientuar në aktivitete, zakonisht ofrojnë numra të saktë dhe informacione të tjera rreth asaj se kush ka përfituar dhe si. Por këto janë edhe projekte tipike afatshkurtra që kanë fushëveprim të kufizuar dhe adresojnë një çështje specifike në një hapësirë relativisht të ngushtë (një ose disa komuna). Projekte që, nga ana tjetër, synojnë të adresojnë më shumë objektiva strategjike në lidhje me arsimin gjithëpërfshirës nga një qasje e bazuar në sistem (p.sh. zhvillim i një kurrikule ose udhëzimesh që do të miratohen ose promovohen nga qeveria, ose zhvillim i një plani komunal veprimi) kanë një fushëveprim shumë më të gjerë të zbatimit dhe potencialisht do të përfshijnë një grup shumë më të gjerë përfituesish. Duke pasur parasysh çështjet sistematike të identifikuara nga shumë raporte dhe analiza sa i përket zbatimit të kornizës legjislative dhe të politikave adekuate për arsimin gjithëpërfshirës në Kosovë, janë me të vërtetë **çështje të tilla sistematike** që ende nuk janë adresuar në mënyrë strategjike nga autoritetet dhe mbështetur nga donatorët ndërkombëtarë, me qëllim për të ndihmuar autoritetet e Kosovës në të dy nivelet për të siguruar një mjedis të përshtatshëm për qasje efektive në arsimin gjithëpërfshirës për të gjithë, përfshirë personat që u përkasin komuniteteve të cenueshme/të margjinalizuara.

Në kontekstin e vlerësimit dhe matjes së ndikimit të projekteve individuale në përfshirjen reale të fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë dhe të të kthyerve në sistemin arsimor, një studim nga GIZ duhet të përmendet pasi ka siguruar një kornizë për matjen e ndikimit të tillë.[127] Studimi mori parasysh zërat e përfituesve dhe palëve të interesit në aktivitetet në lidhje me përfshirjen arsimore. Ngjashëm, një studim i financuar nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur (OSF)[128] vlerësoi punën reale të qendrave mësimore dhe ndikimin e tyre në përfshirjen e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në arsim dhe sugjeroi një numër rekomandimesh për të përmirësuar punën e tyre dhe ndikimin në terren, duke përfshirë nevojën për **mbështetje më sistematike nga donatorët dhe institucionet qendrore** në mënyrë që qendrat mësimore të pasurojnë aktivitetet, programet e tyre dhe t'i ngritin kapacitetet e tyre (përmes trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve për stafin dhe mësimdhënësit e qendrave), nevojën që OJQ-të aktivisht të shmangin çdo dyfishim të punës, rritje të bashkëpunimit me prindërit, sigurim të mbështetjes ekonomike për nxënësit në rrethana të rënda, fushata ndërgjegjësimi dhe shumë të tjera.[129]

123 Studimi mbi ndikimin dhe qëndrueshmërinë e qendrave mësimore, 2015, f. 28-29.

124 *Po aty*., f. 30.

125 KEEN: Vlerësimi afatmesëm: Zbatimi i Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021, nëntor 2019, f. 26-27.

126 Shih, ndër shumë të tjerë, Fondacioni për Shoqëri të Hapur BE/Kosovë: Libri me ngjyra: Një tregim i Qendrave Mësimore (publikuar në katër gjuhë), një projekt i financuar nga BE i menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë, implementuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur, 2012; KEEN: Vlerësimi afatmesëm: Zbatimi i Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021, nëntor 2019.

127 P.sh. GIZ: Studim shoqërues për zbatimin e aktiviteteve të projektit CDBE të GIZ-it. Komponenti për përfshirjen arsimore të të kthyerve dhe pakicave etnike, GIZ, 2018.

128 Fondacioni për Shoqëri të Hapur. Ndikimi i qendrave mësimore në gjithëpërfshirjen e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në arsim. Projekti "Iniciativa e Kosovës për Integrim 2020 - KOSINT", 2018.

129 *Po aty*., f. 46–48.

3.2 Vlerësimi i përgjithshëm i fushëveprimit të projekteve të financuara nga donatorët dhe i ndërhyrjeve të tjera në fushën e arsimit të fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë nga nivelet parafillore në ato të mesme

Organizatat ndërkombëtare, si donatorë dhe/ose agjenci zbatuese, kanë ndërmarrë shumë iniciativa për të adresuar problemet me të cilat përballen personat që u përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, nga të cilat ato në arsim janë shumë të ndjeshme dhe me pasoja të rënda afatgjata për individët, komunitetet dhe shoqërinë në përgjithësi. Problemet më të mëdha janë vijueshmëria e ulët e shkollës, niveli i lartë i braktisjes, performanca më e ulët në shkollë dhe përfundimi i hershëm i arsimit. Megjithëse është arritur shumë, këto probleme vazhdojnë dhe arsimi vazhdon të jetë një sfidë për 'komunitetet e cenueshme' dhe personat që u përkasin atyre. Varësia nga donatorët është shfaqur si problem kryesor në shumë projekte dhe aktivitete me disa që mbështeten nga shumë donatorë të ndryshëm, gjë që ka rezultuar e vështirë për t'u koordinuar (në mesin e donatorëve dhe ndërmjet donatorëve, palëve të tjera të interesit dhe përfituesve) si dhe duke paraqitur një barrë të konsiderueshme administrative mbi individët që luftojnë për të realizuar aktivitetet dhe për të ndihmuar personat që u përkasin komuniteteve të margjinalizuara të arrijnë sukses në arsim.

Megjithëse janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të zhvilluar kornizat legjislative dhe të politikave në nivelet qendrore dhe komunale për arsimin gjithëpërfshirës cilësor, **zbatimi mbetet problem** i identifikuar në të gjitha studimet më të fundit të vlerësimit dhe nga organet ndërkombëtare të monitorimit. Meqenëse implementimi është një problem i tërë sistemit, projektet e financuara nga donatorët do të duhet të mbështesin zhvillimin e **qasjeve në tërë sistemin për të përmirësuar dhe monitoruar zbatimin** e planeve arsimore të zhvilluara mirë. Ky proces do të kërkojë **bashkëpunim të ngushtë ndërmjet autoriteteve dhe donatorëve** në identifikimin e nevojave për përmirësimin e zbatimit. Donatorët ndërkombëtarë do të jenë thelbësor, por është edhe përgjegjësi e tyre të punojnë me autoritetet se si t'i adresojnë më mirë çështjet sistematike dhe në çfarë kohe, duke pasur parasysh ato të prekshmet (p.sh. të dhëna për braktisjet e shkollës, ose faktorë socio-ekonomikë që ndikojnë në familjet individuale dhe nxënësit) ose probleme të paprekshme (p.sh. **qëndrimet** e zyrtarëve dhe mësimdhënësve mbi arsimin gjithëpërfshirës, ose prindërve për rëndësinë e arsimit cilësor për të gjithë, ose qëndrimet e nxënësve ndaj diversitetit në përgjithësi, ose diversitetit të shkollës në veçanti, si dhe normave kulturore që ndikojnë në përfshirjen arsimore, veçanërisht në nivelet më të larta të arsimit). Ngjashëm, në mjedise specifike lokale duhet të merren parasysh **nevojat dhe shqetësimet specifike të përfituesve** (komunitetet e cenueshme dhe personat që u përkasin atyre, ku diversiteti brenda komunitetit nuk duhet të injorohet, duke përfshirë **hendekun gjinor** të dukshëm në përfshirjen dhe rezultatet arsimore). Në frymën e **pjesëmarrjes efektive** të të gjithë aktorëve, mund të pritet një **ndjenjë e rritur e pronësisë lokale**, si dhe një **ndjenjë e forcuar e përgjegjësisë lokale** për të zbatuar planet e veprimit dhe strategjitë me qëllim arritjen e qëllimeve strategjike të arsimit në Kosovë, të zbatueshme për arsimin gjithëpërfshirës cilësor për të gjithë, përfshirë personat që u përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

4. Analizimi i qëllimeve të projekteve, sukseseve (praktikave të mira), vështirësive dhe pengesave

Ky kapitull bazohet në një analizë cilësore të rezultateve të projekteve të analizuara në kapitullin tre më sipër. Analiza fokusohet në qëllimet e tyre dhe përmbushjen e këtyre qëllimeve dhe në praktikat e mira të përgjithshme që janë krijuar brenda projekteve individuale dhe mund të përdoren në planifikimin e ardhshëm të projekteve të mbështetura ose të implementuara ndërkombëtarisht, përfshirë projektin INCLUDE. Për më tepër, ky kapitull analizon gjithashtu pengesat me të cilat ballafaqohen gjatë zbatimit të këtyre projekteve si dhe vështirësitë e mundshme në arritjen e qëllimeve të këtyre projekteve. Përsëri, qëllimi i këtij vlerësimi është që të shmanget ballafaqimi me të njëjtat probleme në projektet e tanishme dhe të ardhshme në fushën e arsimit gjithëpërfshirës cilësor dhe të kërkojë zgjidhje të mundshme për tejkalimin e pengesave të identifikuara për arsimin gjithëpërfshirës të fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në nivelet e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm. Kapitulli përfundon me mësimet e nxjerra nga projektet e zbatuara tashmë dhe ai kërkon të identifikojë hendeqet që mungojnë në zbatimin efektiv të arsimit gjithëpërfshirës për personat që u përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

4.1 Praktikat e mira dhe pengesat në arritjen e qëllimeve të projekteve

Në përgjithësi, projektet që kanë prodhuar rezultate të mira ose që janë vlerësuar nga përfituesit dhe palët e tjera të interesit janë mbështetur në **individë të përkushtuar, kompetentë** që kryejnë projekte të tilla, ato janë **mbështetur nga institucioni përkatës** (drejtorët, stafi komunal), ato projekte janë përgatitur ose zbatuar më vonë në **bashkëpunim ndërmjet donatorëve dhe përfituesve ose partnerëve zbatues**, ato kanë siguruar të paktën një nivel minimal të **qëndrueshmërisë** dhe ato kanë mundësuar një margjinë **fleksibiliteti**. Për më tepër, projektet u vlerësuan si të mira nëse ato **mbulonin kostot reale** dhe çuan në ndonjë **vlerësim ose njohje të individëve** të përfshirë në zbatimin e tyre.

Praktikat e mira të identifikuara specifikisht përfshijnë **pjesëmarrjen dhe përgjegjësinë e të gjitha komuniteteve shkollore** (p.sh. të mësimdhënësve dhe stafit të shkollës, të nxënësve ku nxënësit romë, ashkali dhe egjiptianë ishin gjithmonë të pranishëm, të ndërmjetësuesve dhe të prindërve të cilët konsiderohen si partnerë përmes të cilëve duhet t'iu sigurohet mbështetje e veçantë prindërve më pak të arsimuar dhe, nëse është e nevojshme, interpretim/përkthim për të lehtësuar komunikimin) - p.sh. në hartimin dhe zbatimin e një plani veprimi shkollor në Gjakovë, i cili ndihmoi në transformimin e kulturës shkollore në një kulturë gjithëpërfshirëse, gjithashtu me ndihmën e aktiviteteve të tilla si mentorimi ndërmjet kolegëve dhe mbështetja ndërmjet kolegëve,[130] mentorimi dhe tutorimi,[131] ndërmjetësimi, mësime plotësuese për nxënës të cilët kishin braktisur shkollën dhe orë mësimore plotësuese për nxënës të riatdhesuar,[132] si

130 KEC: Analizë e shpejtë. Përfshirja e fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parashkollor dhe fillor (Prizren, Gjakovë dhe Ferizaj), 2015, f. 22.

131 P.sh. GIZ: Studim shoqërues për zbatimin e aktiviteteve të projektit CDBE të GIZ-it. Komponenti për përfshirjen arsimore të të kthyerve dhe pakicave etnike, GIZ, 2018.

132 BE/KiE: Udhëzime për mësimdhënësit për Përfshirjen Sociale të Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve në shkolla, 2015, f. 32.

dhe vizita të mësimdhënësve në familjet rome, ashkali dhe egjiptiane.[133] Suksesi i qendrave mësimore ishte pjesërisht për shkak - jo vetëm të aktiviteteve të tyre arsimore, të tilla si ndihma për detyrat e shtëpisë, por edhe për një kuzhinë funksionuese dhe aktivitete ekstra-kurrikulare të tilla si sportet dhe artet,[134] të cilat të gjitha mund të ndihmojnë fëmijët dhe të rinjtë të zhvillojnë shkathtësi dhe kompetenca të ndryshme që do t'iu ndihmojnë atyre të ndërtojnë një identitet pozitiv për vetveten dhe që përfundimisht do t'i fuqizojë ata në arsimin formal, si dhe për shkak të mbështetjes psikosociale dhe mentorimit të siguruar nga ndërmjetësuesit.[135] Kështu që, meqenëse problemet në arsim janë **komplekse**, duhet të ketë qasje drejt adresimit të tyre. Kjo presupozon **të kuptuarit e plotë të gjendjes, të nevojave për adresimin e çështjeve dhe bashkëpunim të shpejtë dhe të mirë ndërmjet të gjithë aktorëve relevantë në fushën e arsimit.** Përveç veprimeve afatshkurtra, **aktivitetet e vazhdueshme afatgjata duhet të kryhen për të adresuar qëndrimet negative ndaj diversitetit ose personave që u përkasin komuniteteve specifike të cenueshme/të margjinalizuara**. Kjo përfshin **të kuptuarit e diversitetit si vlerë**, dhe jo si problem, **nga të gjithë**.

Një shembull i mirë i përgjithshëm i zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në planin e saj komunal të veprimit ka qenë komuna e Gjakovës, ku ekziston një **bashkëpunim i mirë** midis DKA-ve, ZKKK-ve, OJQ-ve dhe institucioneve arsimore.[136] Një praktikë tjetër e mirë e identifikuar në një projekt në nivelin e komunave është **një linjë e re buxhetore** për zbatimin e një plani veprimi për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Prizrenit.[137] Megjithëkëtë, këto praktika të mira nuk sugjerojnë që personat që u përkasin komuniteteve të cenueshme/të margjinalizuara përfitojnë njëlloj nga arsimi cilësor në këto komuna, por ato sigurisht ndihmojnë në krijimin e **qëndrimeve pozitive dhe besimit në institucionet komunale**, gjë që nuk duhet të injorohet si faktor që ndikon në qasjen në arsimin gjithëpërfshirës.

Ndër pengesat më të mëdha për qasje efektive në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për personat që u përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe komuniteteve të tjera të cenueshme/të margjinalizuara mbeten **mungesa e burimeve financiare dhe njerëzore, mungesa e vullnetit dhe zotimit politik** për të zbatuar në mënyrë efektive legjislacionin ekzistues dhe politikat, përfshirë strategjitë dhe planet e veprimit në nivelet qendrore dhe lokale, dhe **mungesa e koordinimit** ndërmjet palëve të ndryshme të interesit.[138] **Mungesa e të dhënave të ndara**, të ndara sipas komunave, gjithashtu paraqet një pengesë për planifikimin efektiv të politikave për arsimin gjithëpërfshirës siç aplikohet për komunitetet e cenueshme/të margjinalizuara dhe personat që u përkasin atyre. Disa projekte specifike kanë pësuar nga mungesa e udhëzimeve[139] adekuate për funksionimin e aktiviteteve të caktuara, mundësia e edukatorëve të përfshirë në zbatimin e projekteve të cilët nuk kanë certifikatë apo kompetenca adekuate, dhe mungesa e ndonjë mundësie për trajnim ose certifikim adekuat të edukatorëve. Për sa i përket financave,

133 KEC: Analizë e shpejtë. Përfshirja e fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parashkollor dhe fillor (Prizren, Gjakovë dhe Ferizaj), 2015, f. 23.

134 Shih, ndër shumë të tjerë, Fondacioni për Shoqëri të Hapur BE/Kosovë: Libri me ngjyra: Një tregim i Qendrave Mësimore (publikuar në katër gjuhë), një projekt i financuar nga BE i menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë, implementuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur, 2012.

135 P.sh. GIZ: Studim shoqërues për zbatimin e aktiviteteve të projektit CDBE të GIZ-it. Komponenti për përfshirjen arsimore të të kthyerve dhe pakicave etnike, GIZ, 2018.

136 KEEN: Gjendja e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunat e Kosovës. Raporti i monitorimit për zbatimin e planeve lokale të veprimit në fushën e arsimit dhe punësimit në gjashtë (6) komuna të Kosovës: Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë dhe Lipjan, 2019, f. 104.

137 KEC: Analizë e shpejtë. Përfshirja e fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parashkollor dhe fillor (Prizren, Gjakovë dhe Ferizaj), 2015, f. 21.

138 KEEN: Gjendja e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunat e Kosovës. Raporti i monitorimit për zbatimin e planeve lokale të veprimit në fushën e arsimit dhe punësimit në gjashtë (6) komuna të Kosovës: Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë dhe Lipjan, 2019.

139 Studimi mbi ndikimin dhe qëndrueshmërinë e qendrave mësimore, 2015, f. 40.

problemi më i madh është **mungesa e qëndrueshmërisë** e krijuar nga varësia në donatorët dhe projektet individuale.

Numri i projekteve të vazhdueshme jo vetëm që krijon **pasiguri** (e cila paraqet një pengesë për planifikimin afatgjatë që është thelbësor në arsim, p.sh. për të trajnuar mësimdhënës kompetentë) por gjithashtu paraqet një barrë të konsiderueshme administrative për punonjësit tashmë të paguar pak dhe të mbingarkuar ose për vullnetarët. Problemi i **burimeve njerëzore të pamjaftueshme** të siguruara nga autoritetet ka çuar në **kontraktim të aktiviteteve dhe përgjegjësisë tek OJQ/ OSHC-të dhe partnerët për zhvillim** - d.m.th. palët e interesit që duhet të jenë partnerë, në vend se aktorë kryesorë zbatues kur bëhet fjalë për përgjegjësinë në përmbushjen e objektivave strategjike bazë të arsimit në Kosovë.

Ndërsa **sistemi arsimor** i Kosovës **vazhdon të ndahet** me sistemin paralel serb që nuk njeh institucionet e Kosovës, kjo paraqet një pengesë për zbatimin e plotë të objektivave strategjike si dhe projekteve individuale në të gjithë Kosovën. Kur përmbushja e synimeve varet nga bashkëpunimi me sistemin paralel serb, zbatimi i aktiviteteve të tilla ka pësuar dhe synimet nuk mund të përmbushen, kështu që ekziston nevoja për t'i rregulluar ato në një mënyrë që të jenë të matshme dhe të zbatueshme (ndërsa zgjidhjet politike kërkohen të adresojnë mu këtë çështje në radhë të parë).[140]

Meqenëse shumë prej aktiviteteve janë kontraktuar tek donatorët dhe OJQ-të/OSHC-të, ekziston **problemi i pronësisë lokale**, si dhe **mungesa e caktuar e ndjenjës së përgjegjësisë nga autoritetet në të gjitha nivelet** për të zbatuar legjislacionin ekzistues për arsimin gjithëpërfshirës. Kjo mbështetje afatgjate tek donatorët gjithashtu ul efikasitetin e fondeve të alokuara. Përfaqësuesit e organizatave donatore, në intervista për të vlerësuar funksionimin dhe financimin e qendrave mësimore, vetë pranuan se kishte dyfishim të financimit të projekteve të njëjta ose të ngjashme dhe se kishte nevojë që autoritetet (komunat) t'i koordinojnë donatorët, dhe që autoritetet qendrore t'i sjellin plotësisht këto qendra në sistemin arsimor formal dhe të zhvillojnë një strategji për këtë qëllim.[141]

4.2 Mësimet e nxjerra dhe hendeqet që mungojnë

Pasuria e shumë projekteve të larmishme, shumë prej të cilave janë shqyrtuar për qëllimin e këtij studimi, siguron një themel të fortë për planifikimin e ardhshëm të projekteve pasi disa mësime mund të nxirren nga projektet e zbatuara më parë dhe praktikat e mira që janë identifikuar ose mund të identifikohen. Gjithashtu, ka disa hendeqe që mungojnë në mbulimin dhe fushëveprimin e projekteve që kanë të bëjnë me arsimin gjithëpërfshirës cilësor, të zbatueshëm për personat që u përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe komuniteteve të tjera të cenueshme.

Projektet do të jenë më të dobishme kur ato **të promovojnë dhe mbështesin programe dhe strategji kombëtare dhe/ose të adresojnë probleme specifike** të identifikuara si hendeqe në përmbushjen e standardeve dhe normave evropiane. E rëndësishmja, autoritetet qendrore luajnë rol thelbësor duke siguruar një **kornizë** (me udhëzime të përgjithshme) mbi fushëveprimin dhe

140 KEEN: Gjendja e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunat e Kosovës. Raporti i monitorimit për zbatimin e planeve lokale të veprimit në fushën e arsimit dhe punësimit në gjashtë (6) komuna të Kosovës: Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë dhe Lipjan, 2019, f. 104-105.

141 Studimi mbi ndikimin dhe qëndrueshmërinë e qendrave mësimore, 2015, f. 31; Fondacioni për Shoqëri të Hapur. Ndikimi i qendrave mësimore në gjithëpërfshirjen e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në arsim. Projekti "Iniciativa e Kosovës për Integrim 2020 - KOSINT", 2018.

funksionimin e aktiviteteve dhe programeve individuale. Projektet mund të mbështesin hartimin e udhëzimeve të tilla ose dokumenteve të tjera kombëtare, bazuar në një vlerësim të gjendjes dhe **nevojave ekzistuese**, në nivelet qendrore ose lokale, për të adresuar një çështje specifike. Kjo është e rëndësishme në mënyrë që projektet **të sinkronizohen** me qëllimet e përgjithshme në fushën e arsimit gjithëpërfshirës cilësor (p.sh. qëllimet strategjike të arsimit në Kosovë) në përputhje me standardet dhe normat ndërkombëtare (evropiane), në vend se të varen nga prioritetet individuale të donatorëve ose OJQ-ve/OSHC-ve ose palëve të tjera të interesit.

Ekziston nevoja për të ndihmuar autoritetet qendrore në zhvillimin e **masave efektive në të gjithë vendin**, që aplikohen në tërë sistemin arsimor, që do të promovojnë angazhimin dhe performancën e të gjitha palëve të interesit të përfshira në sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës në përgjithësi, dhe veçanërisht pasi të aplikohen për personat që u përkasin komuniteteve të cenueshme. Këto masa janë veçanërisht të nevojshme për **përmirësimin e zbatimit**, në të dy nivelet, atë të legjislacionit të zhvilluar mirë dhe të dokumenteve të politikave, siç janë strategjitë kombëtare dhe planet e veprimit në nivelet kombëtare/qendrore dhe lokale/komunale. **Pjesëmarrja aktive** e të gjitha palëve të interesit, përfshirë komunat, shkollat dhe stafin e tyre, si dhe të personave që u përkasin komuniteteve të cenueshme, ndërsa duke marrë parasysh diversitetet brenda grupeve, siguron një garanci më të mirë për hartimin e masave që do të adresojnë nevojat reale në terren.

Meqenëse nevojat janë të ndryshme për komunitete të ndryshme dhe për personat që u përkasin atyre, përfshirë diversitetin që lidhet me gjininë, një **diversitet i tillë duhet të përfshihet në të gjitha proceset** që synojnë të sigurojnë arsim gjithëpërfshirës cilësor për të gjithë, përfshirë personat që u përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. **Barazia e bazuar në gjini** mund të sigurohet përmes integrimit gjinor në mënyrë që çdo aspekt i politikave arsimore të vlerësohet dhe rregullohet edhe nga perspektiva e efekteve në rezultatet arsimore për nxënësit e gjinive të ndryshme.

Mungesa e vullnetit politik si një nga pengesat kryesore, së bashku me **mungesën e burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare** dhe **qëndrimet problematike**,[142] parandalon zbatimin efektiv të politikave arsimore dhe kështu shkakton efekte afatgjata negative për tërë shoqërinë dhe për anëtarët e saj, veçanërisht për ata që u përkasin komuniteteve të cenueshme/të margjinalizuara. Për zbatimin efektiv të qëllimeve strategjike arsimore në Kosovë, kjo mungesë e vullnetit politik dhe pengesat e tjera duhet të adresohen sistematikisht, të cilat pastaj duhet të rezultojnë në alokim më të mirë të stafit të trajnuar dhe burimeve financiare në të gjitha nivelet. Nga ana tjetër, kjo do të sigurojë **një kuptim më të mirë të pronësisë lokale** të objektivave strategjike arsimore.

Ngjashëm, përvoja me qendrat mësimore të themeluara si në shkollë ose si në institucione jashtë shkollës ka treguar se sjellja e këtyre institucioneve dhe aktivitetet e tyre brenda sistemit arsimor formal është e dobishme. Kjo është për shkak të disa faktorëve, përfshirë afërsinë dhe kushtet më të mira, por edhe bashkëpunimin me mësimdhënësit dhe mundësinë për të monitoruar përparimin e fëmijëve nga edukatorët në qendrat mësimore dhe në shkolla. Kjo demonstron nevojën **për të sjellë projekte dhe donacione të ndryshme brenda sistemit arsimor formal** dhe në këtë mënyrë adresimin e problemeve me të cilat përballen personat që u përkasin 'komuniteteve të cenueshme' **në mënyrë sistematike**, në tërë Kosovën dhe **në mënyrë të qëndrueshme**. Kjo përfshin nevojën që qeveria qendrore të zhvillojë më tej **një kornizë për zbatimin e programeve dhe aktiviteteve**

142 Shih kapitullin 5 më poshtë.

specifike, duke përfshirë një program zyrtar certifikimi për edukatorët e përfshirë në programe dhe adresimin e nevojave të ndryshme të përfituesve, përfshirë çështjet gjuhësore (d.m.th. me qëllim të promovimit të diversitetit si vlerë). Këto programe dhe aktivitete do të funksionojnë më mirë nëse ato janë në përputhje me sistemin e detyrueshëm arsimor si aktivitete plotësuese që kërkojnë të ndihmojnë fëmijët të arrijnë rezultate më të mira (pra të barabarta) në mësimnxënie në sistemin arsimor formal, në të gjitha nivelet.

Ndërsa **donatorë të shumtë ndërkombëtarë** janë të mirëpritur dhe kontributi i tyre financiar është thelbësor për të ndihmuar autoritetet për të adresuar problemet e qasjes në arsim cilësor për të gjithë, prania dhe praktika e tyre ka demonstruar se ekziston nevoja për **koordinim më të mirë të donatorëve dhe aktiviteteve të tyre** ashtu si për të shmangur dyfishimin e punës dhe për të përmirësuar veprimtaritë e tyre ndaj problemeve më relevante të vazhdueshme. Prandaj është e **nevojshme që autoritetet të përcaktojnë prioritete dhe të koordinojnë, në nivel kombëtar dhe lokal, donatorët dhe aktivitetet e tyre, në mënyrë strategjike dhe duke marrë parasysh dimensionin kohor** (çfarë kërkon vëmendje urgjente dhe se si autoritetet mund të sigurojnë financime të qëndrueshme afatgjata të programeve dhe aktiviteteve të caktuara dhe si rezultat **qëndrueshmërinë** e tyre). Qëndrueshmëria nuk mund të arrihet duke u mbështetur vetëm te donatorët, prandaj është thelbësore që autoritetet (qeveria qendrore dhe komunat) të përgatisin dhe zbatojnë plane për aktivitetet dhe programet mbështetëse të donatorëve për të cilat autoritetet, në vend të donatorëve, të marrin **përgjegjësinë** kryesore.

Në përgjithësi, projektet e zbatuara janë përqendruar në personat që u përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian si komunitete të cenueshme/të margjinalizuara, por **cenueshmëria ka qenë në masë të madhe një-dimensionale** - d.m.th. e lidhur me gjendjen e tyre socio-ekonomike (varfërinë, mungesën e strehimit të duhur, infrastrukturën e dobët etj.). Dimensioni etno-gjuhësor i këtyre komuniteteve dhe personave që u përkasin atyre është anashkaluar në masë të madhe (siç ka demonstruar ai në dështimin e zbatimit të qëllimit 1.8 për promovimin e diversitetit në PSAK 2017-2021). Megjithëkëtë, mund të përmenden disa përjashtime të dukshme, por projektet që u ndihmuan fëmijët të mësojnë dhe madje të përdorin gjuhët e tyre të para (në fushat ku gjuhët e tjera janë zyrtare) shpesh kanë qenë të kufizuara në aktivitete ekstra-kurrikulare dhe në ambientet jashtë shkollës. Ky është një **hendek i rëndësishëm, veçanërisht në sistemin arsimor formal**, që kërkon më shumë vëmendje. Është veçanërisht e rëndësishme për personat që i përkasin çdo komuniteti të pakicave kombëtare, duke përfshirë komunitetet e cenueshme të shënjuara me një status të pakicës së dyfishtë, **të ndihen rehat në shprehjen e identiteteve të tyre etnike, gjuhësore, kulturore dhe/ose fetare** (gjë që mbetet problem për shumë persona që u përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian që nuk vetë-identifikohen si të tillë nga frika e paragjykimeve[143]), në vend që të ndihmohen vetëm si komunitete socio-ekonomikisht të cenueshme. Për më tepër, mungesa e njohurive të një gjuhe zyrtare mund të paraqesë pengesë për çdo nxënës me një gjuhë të parë të ndryshme të ketë sukses.

Ngjashëm, ky aspekt i sigurimit të **qasjes në të drejtat e pakicave** me qëllim që t'u mundësojë personave që u përkasin këtyre komuniteteve të ruajnë dhe zhvillojnë identitetet e tyre etnike, gjuhësore, kulturore dhe/ose fetare në fushën e arsimit është hequr gjithashtu në projektet e shqyrtuara në këtë Studim hulumtues (përveç në zhvillimin e një kurrikule dhe udhëzimeve brenda programit të përbashkët të financuar nga BE-ja dhe të zbatuar nga KiE-ja). Në veçanti, që të drejtat e pakicave të gëzohen në mënyrë efektive, e gjithë shoqëria duhet të marrë pjesë. Prandaj ekzistojnë

143 Shih Perspektiva e të rinjve rom, ashkali dhe egjiptian mbi mundësitë dhe sfidat për punë të denjë në Kosovë, 2018, f. 43.

mundësi dhe nevoja për donatorët që të mbështesin **zhvillimin e 'kurrikulave të orientuara drejt integrimit'** dhe zbatimin e tyre në praktikë (me të gjitha aspektet e këtij procesi, përfshirë trajnimin e mësimdhënësve para dhe në vend pune, përgatitjen e materialeve për mësimdhënie dhe mësimnxënie, duke ngritur ndërgjegjësimin midis të gjithë prindërve dhe palëve të tjera të interesit për rëndësinë e vlerësimit të diversitetit për integrimin shoqëror) - d.m.th. kurrikula që do të trasojë rrugën për **integrimin shoqëror si proces që çon në koherencën shoqërore ndërsa respekton diversitetin si pjesë e vlerësuar dhe përbërëse e shoqërisë**.

5. Anketa në lidhje me qëndrimet e shkollave ndaj aspekteve të ndryshme të arsimit cilësor gjithëpërfshirës

Qëllimi i kësaj ankete (të realizuar nga Hana Zylfiu-Haziri) ka qenë të përcaktojë qëndrimet e palëve të interesit në sistemin arsimor dhe kështu edhe të palëve të interesit të projektit INCLUDE në lidhje me arsimin gjithëpërfshirës (me fokus specifik në gjithëpërfshirjen e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në arsim në të gjitha nivelet) dhe në lidhje me projektet e ndryshme të kryera në këtë aspekt. Metodologjia fillestare dhe mostra e anketës (siç shpjegohet në seksionin 5.1) janë përshtatur me pandeminë Covid-19 pasi qasja fizike në shkolla ishte e kufizuar, kështu që të dhënat u mblodhën kryesisht përmes video-konferencave (platforma zoom) dhe me ndihmën e pyetësorëve me shkrim.

Anketa ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të gjendjes në katër komuna të Kosovës, siç perceptohet nga fëmijët, mësimdhënësit, drejtorët e shkollave, qendrat mësimore, autoritetet lokale dhe autoritetet qendrore. Si rezultat, anketa ka analizuar rëndësinë e arsimit gjithëpërfshirës në pikëpamjet dhe qëndrimet nga palë të ndryshme të interesit, në lidhje me arsimin gjithëpërfshirës dhe mënyrat e sigurimit të tij (përfshirë përmes projekteve të ndryshme të mbështetura nga donatorë dhe përmes programeve të tjera). Rezultatet kanë treguar ndryshime të konsiderueshme në perceptimin e arsimit gjithëpërfshirës të mbajtur nga palë të ndryshme të interesit dhe në komuna të ndryshme, gjë që ngre një numër çështjesh për ndërhyrje të mëtejshme në këtë fushë. Është me rëndësi thelbësore të punohet në **ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e arsimit gjithëpërfshirës** midis nxënësve, si dhe në **ndërtimin e sinergjive** ndërmjet palëve të ndryshme të interesit me qëllim që të sigurohen rezultate të qëndrueshme dhe afatgjata të ndërhyrjes në arsimin gjithëpërfshirës cilësor për të gjithë.

5.1 Metodologjia dhe mostrat

Një mostër nga katër komuna u përdor për të mbledhur informacionin për këtë studim, duke synuar përzgjedhjen e katër shkollave fillore me nivele të ndryshme të përfshirjes sociale dhe ndërhyrjeve nga donatorët për secilën komunë në Gjakovë, Prizren, Fushë Kosovë dhe Obiliq. Procesi i përzgjedhjes ndoqi një grup kriteresh të paracaktuara, të cilat përfshinin: vendbanime rurale dhe urbane; një zonë gjeografike e vendbanimeve rome, ashkali dhe egjiptiane; dhe praninë e donatorëve që mbështesin projekte për arsimin gjithëpërfshirës.

Në të katër komunat e përzgjedhura, në anketë kanë marrë pjesë nxënës, mësimdhënës, drejtorë shkollash, përfaqësues të komunave dhe përfaqësues të qendrave mësimore. Për më tepër, anketa përfshiu intervista me përfaqësues të institucioneve të nivelit qendror: zyrtarë për komunitete nga Ministria (e sapo-riemëruar) e Arsimit dhe Shkencës (MASH).

Shkollat e mëposhtme janë përfshirë në anketë: Zef Lush Marku, Brekoc-Gjakovë, Daut Bogujevci, Fushë Kosovë, Abdyl Frashëri, Prizren, Pandeli Sotiri, Plemetin-Obiliq. Anketa përfshiu djem dhe vajza nga klasat 7, 8 dhe 9; Morën pjesë 22 vajza dhe 8 djem. Nga 36 mësimdhënës që morën pjesë në anketë, ishin 19 mësimdhënës nga shkollat fillore dhe 17 nga shkollat e mesme të ulëta. Sa i përket gjinisë, 20 ishin femra dhe 16 meshkuj.

Përfaqësuesit e komunave që morën pjesë në anketë ishin: një zyrtar për komunitete në Gjakovë; një drejtor i drejtorisë së DKA-së në Fushë Kosovë: një zyrtar për komunitete në Prizren; dhe një drejtor i drejtorisë së DKA-së në Plemetin-Obiliq.

5.2 Gjetjet dhe analizimi i tyre

5.2.1 Perceptimet e nxënësve për gjithëpërfshirjen sociale në shkollë

Ndërsa të gjitha intervistat u organizuan virtualisht, nxënësit hezituan të përgjigjen në pyetjet, dhe zakonisht pas një përgjigje në pyetjen, të tjerët ranë dakord me përgjigjen e tij/saj. Përgjigjet në pyetjen nëse shkolla e tyre është mirëpritëse dhe e sigurt për të gjithë nxënësit, në të gjitha grupet, të gjithë nxënësit deklaruan se shkolla e tyre ishte një vend i sigurt dhe ata ndiheshin të mirëpritur. Në pyetjen nëse vizualitetet multikulturore shfaqen në shkollën e tyre, ata të gjithë thanë se nuk kishin vizualitete të shfaqura në shkollën e tyre përkatëse. Vetëm një nxënës në Fushë Kosovë u përgjigj se shkollat duhet t'u mundësojnë fëmijëve nga të gjitha komunitetet etnike të ndjehen të respektuar në shkollë dhe duhet të shfaqen piktura dhe fotografi që përfaqësojnë grupe të ndryshme etnike dhe komunitete të larmishme.

Në përgjithësi, është e dukshme që nxënësit nuk i kuptojnë mirë projektet që po ndodhin në shkollat e tyre. Kur nxënësit u pyetën nëse dinin për ndonjë projekt që ka ndodhur në shkollat e tyre, ata zakonisht u referoheshin aktiviteteve që po ndodhin në shkollë ose aktiviteteve ekstra-kurrikulare. Kur u pyetën për ndryshimet e mundshme që projektet kanë krijuar në shkolla, nxënësit menduan vetëm për ndryshime fizike, të tilla si rregullimet e oborrit, dekorimin e mureve, vizitat jashtë shkollës.

Kur nxënësit u pyetën nëse kishin miq nga komunitetet e tjera etnike, asnjë nxënës nuk iu përgjigj pyetjes. Ndërsa në një shkollë në Plemetin ku përgjigjet u dhanë me shkrim, të gjithë nxënësit kanë pohuar të shoqërohen me fëmijë të një komuniteti tjetër. Në të katër shkollat, e vetmja kohë që nxënësit iu referuan mbështetjes dhe mbledhjes me personat që u përkasin komuniteteve të tjera etnike është gjatë aktiviteteve ekstra-kurrikulare, të tilla si mbledhja e rrobave për njerëzit në nevojë, pastrimi i kopshtit, vizita të ndryshme. As edhe një nxënës i vetëm nuk pohoi se ata e kaluan pushimin ndërmjet orëve mësimore së bashku me dikë me përkatësi të ndryshme etnike.

Kur u pyetën nëse mësimdhënësit janë miqësorë me të gjithë nxënësit, shumica e pjesëmarrësve u përgjigjën me "shumë", ndërsa në shkollën në Fushë Kosovë nxënësit pohuan se mësimdhënësit janë miqësorë vetëm me "nxënësit e mirë".

5.2.2 Mësimdhënësit

Mësimdhënësit kryesisht e lidhin problemin e arsimimit të fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë me tri çështje: 1) kushtet e vështira socio-ekonomike; 2) niveli i arsimimit të prindërve; 3) mosha e disa fëmijëve që e tejkalon moshën e bashkëmoshatarëve të tyre. Kur u pyetën për pengesat e nxënësve romë, ashkali dhe egjiptianë në procesin arsimor, mësimdhënësit kryesisht besojnë se pengesa kryesore është mungesa e mbështetjes në shtëpi, dhe dështimi i tyre për të marrë pjesë në programet parashkollore, të cilat ua vështirësojnë gjendjen atyre që në fillim të shkollimit. Disa fëmijë mungojnë në shkollë për një kohë të gjatë dhe ka raste që nxënësit e klasave të dyta ose të treta ende nuk dinë të lexojnë ose të shkruajnë.

Në Fushë Kosovë, qëndrimet e mësimdhënësve ndaj rezultateve të dobëta akademike të nxënësve që u përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian u atribuohen familjeve të nxënësve; ata besojnë se prindërit romë, ashkali dhe egjiptianë nuk e kuptojnë rëndësinë e arsimit. Këtë qëndrim e ndajnë disa mësimdhënës edhe në shkolla të tjera.

Lidhur me problemet me të cilat po ballafaqohet procesi arsimor, regjistrimi i fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në klasën e parë nuk shihet më si problem ose konsiderohet si një problem shumë i vogël pasi që të gjithë nxënësit e klasave të para janë regjistruar dhe vijojnë shkollën. Në shkollën e Brekocit, krahasimi është bërë në lidhje me numrin e rritur të nxënësve (d.m.th. 12) të cilët janë regjistruar në klasën parashkollor vitin e kaluar shkollor, ndërsa në vitet e mëparshme, kishte vetëm një ose dy nxënës. Kjo rritje i është atribuuar zotimit të qendrave mësimore dhe donatorëve. Në shkollat e Prizrenit dhe Plemetinit, mësimdhënësit gjithashtu deklaruan se mungesa e një psikologu dhe një pedagogu po shkakton probleme, dhe nxënësit nga komunitetet e cenueshme mund të përfitojnë ndjeshëm po që se do të sigurohej mbështetja e duhur nga profesionistët.

Kur u pyetën se kush i mbështet ata në punën e tyre me nxënës të cenueshëm, mësimdhënësit janë përgjigjur se ata shpesh përpiqen t'i zgjidhin vetë problemet e tyre sociale, ata përpiqen të ndihmojnë fëmijët dhe familjet e tyre me rroba, çanta shkollore, mjete shkollore. Mësimdhënësit në shkollat në Brekoc dhe Plemetin kanë theksuar se ata praktikojnë takime me prindër dhe vizita familjare. Një mësimdhënës në Brekoc ka theksuar se "Projekte të ndryshme kanë rritur ndërgjegjësimin si tek mësimdhënësit ashtu edhe tek nxënësit dhe donatorët kanë lënë gjurmë në shkollat e tyre dhe rezultatet e projekteve vlerësohen duke krahasuar shkollën me dhjetë vjet më parë." Kjo ka ndodhur për shkak të donatorëve dhe organizatave që fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë janë tani të pranishëm në shkollë. Mësimdhënësit në Plemetin deklaruan se edhe prindërit janë më të interesuar tani në krahasim me gjendjen në të kaluarën, por prapëseprapë, ka shumë më tepër për të bërë, veçanërisht prindërit kanë nevojë për më shumë mbështetje.

Shumica e mësimdhënësve mendojnë se ata personalisht kanë përfituar nga projektet, si në menaxhimin e marrëdhënieve me nxënësit dhe profesionistët e tyre. Kur u pyetën se si i vlerësojnë projektet që drejtohen nga donatorët, një mësimdhënës në Plemetin ka theksuar se "Projektet që zgjasin një ose dy vjet, pasi të përfundojnë, nuk kanë shumë ndikim. Një projekt zakonisht përfshin mësimdhënës të caktuar, por ne kemi shumë lëvizje të mësimdhënësve në shkolla të tjera, dhe bashkë me ta shkojnë iniciativat që dalin nga projektet". Një mësimdhënës në Prizren deklaroi se "projektet duhet të përqendrohen në aktivitete ekstra-kurrikulare për të krijuar lidhje më të forta midis nxënësve nga komunitete të ndryshme". Dy mësimdhënës nga Prizreni nuk shohin ndonjë përfitim që buron nga projektet dhe ata nuk janë të gatshëm të marrin pjesë në to. Në Prizren,

mësimdhënësit gjithashtu mendojnë se është më e rëndësishme të punosh me prindërit sesa të angazhohesh në një projekt të bazuar në shkollë. Në Plemetin, mësimdhënësit vlerësojnë se falë projekteve gjithëpërfshirja në shkolla është më e lartë dhe shkolla përgatitet më mirë me mjete pedagogjike. Në Brekoc, mësimdhënësit deklaruan se ata përfituan nga trajnimet që kanë rezultuar në përmirësimin e cilësisë dhe ata janë më aktivë në aktivitete ekstra-kurrikulare.

Kur u pyetën se si përzgjidhen mësimdhënësit për të marrë pjesë në projekte, 80% e mësimdhënësve thanë se ai që bën përzgjedhjen ishte drejtori, ndërsa 20% thanë se përzgjedhja ishte bërë nga fushat kurrikulare ose nga një këshill mësimdhënësish.

Mësimdhënësit besojnë se qendrat mësimore duhet të mbeten një urë lidhëse midis prindërve dhe shkollave. Mësimdhënësit në Plemetin në përgjithësi vlerësojnë punën e qendrës mësimore dhe ata theksojnë se kanë një bashkëpunim shumë të mirë me lehtësuesin për çështjen e vijueshmërisë së shkollës nga nxënësit, përmes së cilit organizohen takime në qendrën mësimore me prindërit e nxënësit. Në Brekoc, mësimdhënësit rregullisht ndajnë plane mësimore me lehtësuesit në mënyrë që ata të mund të ndjekin punën e nxënësve në shkollë dhe të kuptojnë se çfarë pritet nga nxënësit. Nga ana tjetër, mësimdhënësit nga shkolla në Fushë Kosovë nuk bashkëpunojnë me qendrën mësimore dhe ata nuk shohin ndonjë përfitim në një bashkëpunim të tillë. Një mësimdhënës deklaroi: "Në qendrën mësimore, fëmijët vetëm luajnë, ata nuk mësojnë fare."

Disa mësimdhënës përdorën shprehjen "magjup" ose "rae" gjatë intervistave dhe ata besojnë se nuk është ofenduese t'i thërrasësh nxënësit romë, ashkali dhe egjiptianë me ata emra. Mësimdhënësit në Prizren gjithashtu besojnë se në shkollën e tyre, kurrë nuk ka pasur ndonjë ndarje ose pengesë midis nxënësve, ose siç deklaroi një mësimdhënës: "Fëmijët nuk e dinë kush është rom, ashkali ose shqiptar, ne nuk flasim për origjinën e tyre."

Megjithëse shkollat kanë marrë pjesë në projekte të ndryshme arsimore, ka ende hendeqe në vlerësimin e nxënësve në mënyrë të barabartë dhe në drejtim të rritjes së pjesëmarrjes së nxënësve nga komunitetet në nevojë. Zakonisht, mësimdhënësit që kanë qenë pjesë e një projekti nuk ndajnë informacionin me kolegët e tyre të mbledhur brenda projekteve. Gjithashtu, disa mësimdhënës nuk i dinë konceptet themelore të gjithëpërfshirjes në arsim dhe nuk janë të vetëdijshëm se ndryshimi është i nevojshëm në shkollën e tyre. Mësimdhënësit nuk mund ta bëjnë dallimin midis nxënësve si burim që ka nevojë për mbështetje në mësimnxënien e tyre; në vend të kësaj, ata i shohin nxënësit nga komunitetet e cenueshme/të margjinalizuara si problem që duhet të kapërcehet.

5.2.3 Drejtorët e shkollave

Drejtorët e të gjitha shkollave kanë qenë shumë të hapur për diskutim. Ata kanë theksuar se projektet janë gjithmonë të mirëseardhura dhe donatorët kanë bërë një punë të shkëlqyeshme me ndërhyrjet e tyre. Të gjithë drejtorët kanë theksuar që ndërhyrjet e donatorëve përmes projekteve kanë ndikuar në numrin e braktisjeve dhe regjistrimeve në klasën e parë: aktualisht, 100% e fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian fillojnë shkollimin. Sipas drejtorëve të shkollave, donatorët më prominent janë GIZ, KiE, USAID, KFOS, KEC, BSFK dhe BCS. Kur u pyet për motivimin për të aplikuar për këto lloje të projekteve, një drejtor i shkollës në Plemetin theksoi se përfitimet janë të shumta, fëmijët kthehen në shkollë, mësimdhënësit përfitojnë nga trajnimi, përmirësohet qasja e mësimdhënësve ndaj fëmijëve. Në Plemetin dhe Brekoc, shkollat gjithashtu

kanë përfituar nga pajisjet teknologjike. Drejtori në Plemetin deklaroi: "Pajisja e shkollës me mjete moderne ka motivuar mësimdhënësit që kanë kurajo të jenë më aktivë."

Lidhur me pyetjen se si shkolla i gjen donatorët, të gjithë drejtorët konfirmuan se ata janë kontaktuar nga organizata të ndryshme dhe ata nuk kanë nevojë të gjejnë vetë donatorë. Vetëm drejtori nga Plemetini ka theksuar se ka raste kur ai ndjek faqet e internetit të KEC dhe MASH ku gjen informacion në lidhje me mundësitë për projekte. Kur u pyet se cili donator ishte më i përshtatshmi për shkollën e tij, ai deklaroi se më i përshtatshmi ishte KiE-ja me një projekt "Mbështetja e Qasjes në Arsim" 2015 (Supporting Access to Education), kur ata patën një shans të ishin pjesë e vizitave studimore, trajnimit dhe ata morën mjete të ndryshme teknologjike. Nga ana tjetër, i njëjti drejtor mendon se Banka Botërore ka shumë procedura dhe për shkak të shumë sfidave, ka të ngjarë që projekti të ndërpritet. Drejtorët e tjerë janë të kënaqur me secilin projekt dhe donator. Lidhur me pyetjen për vazhdimin e aktiviteteve të projektit pas përfundimit të tyre, drejtorët e Prizrenit dhe Brekocit kanë deklaruar që kryesisht aktivitetet përfundojnë me projektet, ose me largimin e stafit të tyre që ishin përfshirë në projekte në shkolla të tjera. Kjo sugjeron që stafi i përfshirë në projekte nuk ndan gjithmonë ide me të tjerët dhe shkollat nuk kanë ndonjë strategji se si të organizojnë tërë qasjen e shkollës kur marrin pjesë në projekt.

Në përzgjedhjen e stafit për të marrë pjesë në projekte, të gjithë drejtorët kanë theksuar që zakonisht këshillat profesionalë përzgjedhin pjesëmarrës në projekte, por ka raste kur ata duhet të ndërhyjnë dhe të përcaktojnë se kush do të marrë pjesë, në varësi të rëndësisë së projektit. Ata gjithashtu kanë theksuar se projektet kanë një ndikim të madh tek mësimdhënësit të cilët po ndryshojnë në drejtim të adaptimit të qasjeve të ndryshme ndaj nxënësve. Kjo përfshin aftësinë e tyre për t'iu dhënë fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë më shumë hapësirë dhe respekt. Gjithashtu, ata të gjithë besojnë se marrëdhëniet midis nxënësve nga komunitete të ndryshme janë shumë komplekse. Drejtori nga Prizreni ka theksuar se ka shumë nevojë për të punuar me prindërit, për t'i ndihmuar ata që të përfshihen në arsimimin e fëmijëve të tyre.

5.2.4 Përfaqësuesit e komunave

Të gjithë zyrtarët e komunave janë mirënjohës ndaj donatorëve për projektet e implementuara që mbështesin komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, veçanërisht për projektet në lidhje me arsimin. Në varësi të komunës, qasja ndaj donatorëve ndryshon ndjeshëm. Komuna më e mirë-organizuar në këtë drejtim është Gjakova, e cila gjithashtu ka një grup këshillues përgjegjës për planifikimin e veprimit për fushatat, aktivitetet si dhe për koordinimin e punës nga organizata të ndryshme. Ky plan rishikohet çdo vit, në prill. Një praktikë e tillë është iniciuar nga Terre Des Hommes dhe është zbatuar për katër vjet. Në Gjakovë, komuna duket se po ndjek nga afër aktivitetet e projektit dhe ata kanë përmirësuar bashkërendimin. Zyrtari për komunitete vlerëson shumë punën e organizatave: "Organizatat kanë ndihmuar shumë më tepër sesa institucionet. Institucionet shpesh varen nga organizatat, siç janë krijimi i qendrave mësimore dhe asistimi i fëmijëve, dhe kështu ato janë të pazëvendësueshme për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë."

Sipas një zyrtari për komunitete, një qasje krejtësisht e ndryshme aplikohet nga komuna e Prizrenit, ku donatorët kryesisht janë në kontakt me OJQ Nevo Koncepti, e cila është e përqendruar në arsimimin e komuniteteve, duke vepruar edhe në Suharekë dhe Gjakovë. Viteve të fundit, fokusi kryesor ka qenë tek nxënësit që kthehen nga vendet perëndimore. Donatorët kryesorë janë GIZ, USAID, KFOS. Në Prizren, organizata më e theksuar është Caritas-i Zviceran, i cili në bashkëpunim

me VoRAE dhe MASH-in u jep bursa nxënësve të shkollave të mesme. Gjithashtu, REF konsiderohet donator që mbështet komunitetet.

Në komunën e Fushë Kosovës, drejtori i DKA-së ka theksuar se projektet aktuale kanë një qasje krejtësisht të ndryshme. Në fillim, ata mbështetën shkrim-leximin, duke inkurajuar arsimimin e vajzave, ndërsa në ditët e sotme, ata janë më të përqendruar në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirje. Në komunën me numrin më të lartë të personave që u përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, shumë donatorë, të tillë si USAID dhe GIZ, kanë qenë të përfshirë, por organizata të tilla si Ballkan Sunflowers dhe Ide Partnership kanë qenë shumë aktive që nga fillimi dhe vazhdojnë të jenë të tilla.

Një sfidë e vërejtur nga një zyrtar është kohëzgjatja e shkurtër e projekteve në Gjakovë. Ajo ka theksuar se "projektet fillojnë dhe mbarojnë, ndërsa institucionet nuk marrin përgjegjësi për të vazhduar atë që organizatat kishin filluar dhe ndërtuar". Kjo është e dukshme në të gjitha komunat e përfshira në këtë anketë. Komunat nuk marrin përsipër të ndjekin dhe monitorojnë aktivitetet pas përfundimit të projekteve, prandaj shumë iniciativa humbin gjurmët e progresit pas një kohe. Edhe në Obiliq, drejtori i DKA-së ka theksuar që pas përfundimit të një projekti, vështirë se sigurohet vazhdimi i aktiviteteve dhe projektet nuk ndiqen.

Kur u pyetën se si i gjejnë donatorët, të gjithë zyrtarët kanë thënë se donatorët janë ata që e kontaktojnë komunën. Të gjithë zyrtarët theksuan se donatorët i kanë qëllimet e veta dhe kur kontaktohen, projektet janë të hartuara tanimë, kështu që komuna kontaktohet për fazën e implementimit të projekteve. Detajet përcaktohen më pas në një memorandum mirëkuptimi. Në Obiliq dhe Gjakovë, donatorët kryesisht e kontaktojnë kryetarin e komunës dhe pastaj çështja e komuniteteve adresohet përmes DKA-së ose zyrës për komunitete. Komuna e Gjakovës ka një projekt me GIZ-in për të cilin komuna kishte iniciuar aplikimin për projektin dhe ata kishin identifikuar nevojat me një plan veprimi dhe kishin ftuar organizatat që të merrnin pjesë në zbatimin e planit.

Kur u pyetën nëse këto projekte i përmbushin nevojat që dalin nga Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021, Gjakova konsideron që Plani i Veprimit i miratuar nga asambleja komunale, që aplikohet për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, ndihmon organizatat dhe donatorët në kryerjen e aktiviteteve të tyre. Të gjithë zyrtarët mendojnë se jo të gjithë donatorët i bazojnë projektet e tyre në Strategji. Lidhur me donatorët dhe duke marrë parasysh sfidat me të cilat përballen projektet, një zyrtar nga Gjakova ka deklaruar se ka organizata që janë shumë serioze, por ka disa që nuk janë shumë të përkushtuara për të punuar, duke mos i arritur qëllimet e planifikuara. Zyrtarët e komunave të tjera deklaruan se janë të kënaqur me donatorët. Gjakova është komuna e vetme me një strategji për të ndjekur ndikimin e projekteve në shkolla: "Ne i shqyrtojmë raportet vjetore dhe kuptojmë se çfarë është bërë nga cila organizatë dhe pastaj bëjmë një plan pune për vitin vijues. Nëse ndonjë plan nuk mund të përmbushet, ne përpiqemi ta vazhdojmë atë. Kjo është iniciativë e zyrës dhe jo ajo që kërkon komuna. Kjo na mban të azhurnuar dhe na ndihmon të ndjekim punën e organizatave."

Kur u pyetën se çfarë tjetër u nevojitet shkollave të tyre për të mbështetur komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, të gjithë zyrtarët komunalë kanë theksuar se puna me prindër duhet të vazhdojë, por edhe se ata kanë nevojë për mjete arsimore, çanta shkollore, veshmbathje, transport dhe pajisje dhe mjete të TI-së. Një zyrtar nga Gjakova mendon se funksionimi i mirë i qendrave mësimore ose

aktiviteti pas orëve mësimore për mbështetjen e nxënësve me detyrat e shtëpisë duhet të jetë në dispozicion në secilën shkollë.

Në krahasim me komunat e tjera, zyrtari nga Gjakova, kur u pyet nëse nxënësit romë, ashkali dhe egjiptianë monitorohen gjatë pandemisë, e cila paraqet një sërë ngarkesash disproporcionale për komunitetet e cenueshme, ajo u përgjigj se "fëmijët që ishin joaktiv në shkollë vazhduan të jenë joaktiv edhe gjatë mësimit online. Të gjithë të tjerët ishin aktiv." Komunat e tjera kryesisht mbështeten në mbështetjen e qendrave mësimore, nga të cilat ata gjithashtu kërkojnë raporte për vijueshmërinë e nxënësve gjatë pandemisë.

Fatkeqësisht, asnjë nga komunat nuk ka një strategji për të mbështetur lehtësuesit dhe tutorët që varen nga donatorët. Kjo është shumë problematike dhe nuk ka zgjidhje të parashikuar. Një zyrtar nga Prizreni ka theksuar se qendrat mësimore kërkojnë ndihmë nga komuna sepse nuk kanë mjete, por komuna nuk mund të ndihmojë shumë ose të sigurojë staf, gjë që shpesh rezulton në largimin e stafit nga qendra.

Komunat u janë shumë mirënjohëse donatorëve. Komunat nuk janë të përfshira në zhvillimin e projekteve, megjithëse nevojat janë shumë të mëdha. Meqenëse nuk janë pjesë e proceseve zhvillimore të projekteve, për pasojë ato nuk marrin përgjegjësi për të monitoruar ndikimin e projekteve pasi të mbarojnë. Komunat janë shumë të interesuara për mirëfunksionimin e qendrave mësimore, por ato nuk kanë linja të veçanta buxhetore për këtë.

5.2.5 Përfaqësuesit e qendrave mësimore

Në katër komuna, përfaqësuesit e qendrave mësimore u kontaktuan virtualisht. Në kohën e intervistës, të katër qendrat mësimore nuk ishin të hapura për aktivitete me fëmijë për shkak të pandemisë Covid-19. Kur u pyetën se cilat projekte dhe donatorë arritën të plotësojnë nevojat e qendrave mësimore, në komuna të ndryshme kanë qenë të pranishëm donatorë të ndryshëm. Në Brekoc, një përfaqësues i qendrës mësimore ka thënë se të gjitha këto projekte kishin një fokus të ndryshëm.

> Në përgjithësi, fondet e projekteve nuk ishin të mëdha, kështu që ishin në gjendje t'i menaxhonin ato lehtësisht. EUSIMRAE si projekt më i madh, në dy faza, u menaxhua nga KEC dhe ishte e lehtë për ne të kryenim aktivitete me fëmijë. Gjithashtu me KFOS, ne vazhdojmë të kemi projekte të ndryshme të cilat përfshijnë edhe prindërit; ndërsa kohët e fundit, së bashku me UNICEF-in, ne mbështesim fëmijët parashkollorë. Në rajonin e Gjakovës, ne kemi themeluar katër qendra të tjera mësimore me GIZ-in, ndërsa projekti KRAEEYN-KEC vazhdon të mbështesë drejtpërdrejt tutorët dhe lehtësuesit në punën e tyre. Në Fushë Kosovë, shumë donatorë mbështetën shkrim-leximin, si Diakonia nga Austria, Ambasada Britanike, Ambasada Norvegjeze e cila financoi programin parashkollor.

Përfaqësuesi i qendrës mësimore në Fushë Kosovë beson se "rezultatet e fëmijëve që vijojnë programin e qendrës dëshmojnë të jenë më të mira në klasën e parë në krahasim me fëmijët e tjerë. Kjo për shkak se shkollat fillore në Fushë Kosovë nuk kanë programe parashkollore". Gjithashtu, GIZ-i ka projekte që e mbështesin qendrën.

Vlerësohet se në Prizren, "projektet i kanë përmbushur shumë nevojat e komuniteteve, veçanërisht në arsim". Sot, "90% e fëmijëve vijojnë arsimin fillor, dhe kjo është mbështetur shumë nga projekti EUSIMRAE". Në vitin 2003, niveli i arsimit të mesëm të lartë kishte vetëm 12 nxënës, por aktualisht ka rreth 200 nxënës. Numri i vajzave në shkollat e mesme është rritur në pak më shumë se 50%. Në

vitin 2004, ishte vetëm një nxënës, ndërsa sot, 60 nxënës janë aktiv, nga të cilët 60% janë nxënëse femra. Projekte të ndryshme i kanë ndihmuar këto zhvillime: KFOS ka mbështetur në kryerjen e detyrave të shtëpisë, arsimin parashkollor Save the Children, edukatorët Cartas-i Zviceran, etj. Të gjitha këto rezultuan në ulje të braktisjes së shkollës. Është bërë shumë punë edhe në media, d.m.th. në radio dhe TV dhe ka shfaqje në gjuhën rome.

Kur u pyetën nëse ka projekte që nuk kanë arritur të plotësojnë nevojat e komuniteteve, përfaqësuesi i qendrës mësimore në Fushë Kosovë mendon se "donatorët përmbushin qëllimet e tyre, por nevojat nuk plotësohen kurrë, sepse ka shumë". Në Prizren dhe Plemetin, projektet konsiderohen të shkurtra dhe ndikimi i tyre në terren është gjithashtu afatshkurtër. Lidhur me mënyrën se si qendrat mësimore e menaxhojnë përfshirjen në projekte, qendra mësimore në Brekoc është aktivizuar fillimisht nga KFOS, dhe më vonë nga donatorë të tjerë. Por në përgjithësi, donatorët u janë drejtuar përfituesve. Përfaqësuesit e qendrave mësimore në Fushë Kosovë, Prizren dhe Plemetin mendojnë se rezultatet e mira dhe nevojat në terren kanë sjellë donatorë. Një përfaqësues në Fushë Kosovë ka theksuar se fatkeqësisht nuk ka thirrje për projekte të dedikuara për qendrat mësimore, kështu që ato varen nga interesat e donatorëve. Komuna nuk ndërmerr asnjë iniciativë për të aplikuar për projekte që do të mbështesnin qendrat mësimore.

Lidhur me pyetjen nëse është e lehtë të punosh me projekte dhe se si menaxhohen ato, në Plemetin, ata mendojnë se kjo është një rutinë, megjithatë, kur donatorët dhe zyrtarët ndryshojnë, gjithçka nis nga fillimi. Në Fushë Kosovë, përfaqësuesi i qendrës mësimore e konsideron si problem faktin që donatorët tani preferojnë të financojnë një projekt të madh të zbatuar nga një organizatë, ndërsa organizatat e vogla më pas ftohen të marrin pjesë por me përfitime më të vogla. Ata gjithashtu kanë theksuar se "gjatë punës me komunitete, shumë komponentë duhet të mbulohen (shkollat, fëmijët, ndërmjetësuesit, prindërit) dhe shpesh këto nuk planifikohen në projekte."

Lidhur me marrëdhëniet me Ministrinë e arsimit dhe komunën, dhe nëse ato mbështeten nga këto institucione, zyrtarë nga Brekoci kanë shpjeguar se ata janë mbështetur nga MASHT-i gjatë viteve 2003–2007 në arsimimin e nxënësve më të vjetër dhe personave që u përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të cilët përfunduan dy vite akademike në një vit. Nga ana tjetër, komuna siguroi objektin për qëllimin e qendrës mësimore. Asnjë mbështetje tjetër konkrete nuk u dha. Qendra mësimore në Fushë Kosovë nuk është mbështetur nga institucionet. Mbështetja e vetme e përmendur ishin dy grante simbolike deri në 2,000 EUR. Në Prizren, megjithatë, ata hezitojnë të bashkëpunojnë me komunën për shkak të interesave të ngushta politike. Ndërsa bashkëpunimi më i mirë me MASH-in ishte në lidhje me arsimin opsional siç janë orët mësimore të gjuhës rome, por ky është ndalur. Të gjithë përfaqësuesit e qendrave mësimore janë të bindur se komuniteti i konsideron qendrat mësimore si shumë të rëndësishme për edukimin e fëmijëve. Shkolla gjithashtu i konsideron ato shumë të rëndësishme për ndërlidhje, megjithatë nga ana e komunës, megjithëse janë të vetëdijshëm për rëndësinë e tyre, nuk u ndërmor asnjë iniciativë për t'i mbështetur ato.

Kur u pyetën nëse përfshirja në shkolla është si rezultat i projekteve, përfaqësuesi i qendrës mësimore në Brekoc ka afirmuar dhe dhënë shembullin e drejtorit të shkollës që kishte ndryshuar shumë qëndrimin si rezultat i zotimit të projekteve dhe të qendrave mësimore. Gjithashtu, ai mendon se qasja e mësimdhënësve ndaj fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë ka ndryshuar dhe ata kanë mësuar se si t'i pranojnë këta fëmijë. Përfaqësuesi i Fushë Kosovës gjithashtu mendon se projektet kanë ndikuar që shkollat të jenë më gjithëpërfshirëse, por jo ende mjaftueshëm: "Politikat kanë ndryshuar, por ka raste që tregojnë se mentaliteti i mësimdhënësve dhe fëmijëve

nuk ka ndryshuar aspak." Në Plemetin, gjendja është pak më ndryshe. Ata theksojnë se shkolla është shumë më e hapur, jo vetëm për fëmijët, por edhe për qendrën. Mësimdhënësit vizitojnë qendrën herë pas here dhe marrin pjesë në aktivitetet e qendrës.

Sfida aktuale në Brekoc është një sfidë sociale, veçanërisht puna me prindërit. Shpesh fëmijët që nuk vijojnë shkollën, punojnë në rrugë. Prindërit janë më të përkushtuar, krahasuar me periudhën e mëparshme, megjithatë, ende duhet të bëhet shumë punë. "Aktualisht, sfida kryesore në qendrën tonë është se ne nuk kemi shumë projekte. Tani kemi vetëm një program parashkollor me UNICEF-in. Përmes projekteve, ne shohim se shumë fëmijë nuk janë regjistruar dhe as vaksinuar. Ky është një tregues që duhet adresuar përmes projekteve." Në Fushë Kosovë, qëndrueshmëria është identifikuar si problemi kryesor:

> Ne kemi programe për fëmijë por ka ende nevojë për më shumë programe. Fëmijët që u larguan nga vendi disa vite më parë, janë kthyer, por rezultatet e tyre janë prapa atyre të fëmijëve të tjerë, prandaj ne duhet të gjejmë mënyra për t'i mbështetur ata. Ne kemi një problem me funksionimin e qendrës. Ka raste kur ne i paguajmë punëtorët me orar të shkurtuar dhe për këtë arsye ka raste kur ata largohen. Ne kurrë nuk arrijmë të mbulojmë 100% të shpenzimeve.

Përfaqësuesi gjithashtu ka deklaruar se për sa kohë që nuk ka fonde specifike për qendra mësimore, nuk ka asnjë koordinim, është mungesa e rrjetëzimit të qendrave mësimore dhe mungesa e koordinimit në nivelin qendror.

Në Prizren, përfaqësuesi i qendrës mësimore gjithashtu ndan nevojën për të siguruar qëndrueshmëri, prandaj tarifa e anëtarësimit konsiderohet si një opsion. Paragjykimet konsiderohen gjithashtu një sfidë që kërkon vëmendje të veçantë: "Megjithëse ndonjëherë përpiqeni dhe punoni shumë, paragjykimet ende ekzistojnë dhe shkollat na thonë 'klasa juaj' kur u referohen qendrave mësimore." Përfaqësuesi gjithashtu konsideron se nganjëherë masat afirmative nuk janë zgjidhja më e mirë. Për shembull, ushqimi i siguruar nga një projekt donator nuk vazhdon me një donator tjetër dhe ky paraqet një problem për fëmijët dhe prindërit e prekur. Në të vërtetë, asnjë qendër nuk ka një mekanizëm për të vazhduar aktivitetet e projektit. Ata mendojnë se për të siguruar këtë, regjistrimi i qendrave mësimore do të ndihmonte sepse do të obligonte institucionet të ishin më të përgjegjshme.

Të gjithë përfaqësuesit nxjerrin në pah katër probleme kur u pyetën në lidhje me mbështetjen që shkollat duhet t'u sigurojnë komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian: 1) mbështetje me materiale shkollore që është e vazhdueshme; 2) shkollat duhet të punojnë dhe të kenë takime më të shpeshta me një numër të vogël prindërish; 3) shkollat duhet të bashkëpunojnë më shumë me qendrat mësimore për krijimin e programeve të përbashkëta dhe aktiviteteve ekstra-kurrikulare; 4) shkollat duhet të bashkëpunojnë më shumë me EPRBM. Për më tepër, përfaqësuesi në Prizren ka theksuar se diskriminimi indirekt është ende i pranishëm në shkolla dhe për këtë arsye është një problem që gjithashtu duhet të adresohet.

Megjithëse qendrat mësimore bëjnë punë të shkëlqyeshme për fëmijët që u përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, ata prapë varen nga donatorët. Sfida kryesore për ta është të punojnë me prindërit dhe të bashkëpunojnë me shkollat, të cilat janë gjithashtu dy aspekte që ndikojnë thelbësisht në gjithëpërfshirjen e nxënësve në arsim. Ata gjithashtu vlerësojnë se duhet bërë shumë punë me shkollat në mënyrë që mësimdhënësit t'i pranojnë dhe t'i trajtojnë barabartë fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë. Paragjykimet dhe diskriminimi janë akoma të pranishme në shkolla dhe prandaj duhet të adresohen siç duhet.

5.2.6 Zyrtari për komunitete i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës

Një përfaqësues i MASH-it i cili është zyrtar për komunitete ka deklaruar se donatorët kryesisht kanë agjendën dhe planet e tyre, dhe kur bien në kontakt me ministrinë, ata tashmë kanë përcaktuar se ku dhe si do të veprojnë. Donatorët kryesorë që ajo ka përmendur janë ata që ndihmojnë me bursa nxënësit, të tillë si KOFS/KEC (projekti EUSIMRAES), VoRAE dhe REF, prej të cilave VoRAE është organizata me të cilën ajo ka më shumë kontakte. GIZ ka dhënë një kontribut të madh në hartimin e Udhëzimit Administrativ për Qendrat Mësimore dhe KiE-ja kryesisht ka pasur projekte që janë zbatuar drejtpërdrejt në shkolla, dhe tani me projektin e ri INCLUDE do të mbështeten edhe qendrat mësimore. REF-i është gjithashtu një donator shumë aktiv që ka disa projekte/programe me disa organizata, dhe kohët e fundit OSBE-ja dhe Roma Versitas Kosova kanë siguruar dy praktikantë në MASH.

Si rezultat i dukshëm në mbështetjen e këtyre komuniteteve, përfaqësuesi i MASH-it vlerëson zbatimin e Udhëzimit Administrativ për qendrat mësimore, përmes së cilës 11 qendra kanë aplikuar për regjistrim, nga të cilat nëntë janë nën shqyrtim. Kur u pyetën se si i gjejnë donatorët dhe si hartohen projektet, zyrtari i MASH-i është përgjigjur se zakonisht, donatorët shprehin interesim gjatë kontaktimit të tyre, gjithmonë sipas planit të projektit që ata kanë. Donatori i përcakton nevojat dhe prioritetet në projekte, varësisht nga misioni i tyre. Mund të ketë takime me ministrin (dhe kabinetin e ministrit), por jo me zyrtarë për ta hartuar projektin. Kur u pyet nëse këto projekte i plotësojnë nevojat e Strategjisë për Përfshirje të Komuniteteve Rom dhe Ashkali, ajo nuk ka qenë në gjendje të bëjë një vlerësim në mungesë të ndonjë raporti. Zyra për Qeverisje të Mirë organizon takime të rregullta me donatorë, por informacioni specifik mbi projektet nuk ndahet. Mos-raportimi konsiderohet sfida më e madhe me donatorët sipas saj. Një shembull është projekti REF që ndihmon me bursa, por edhe pasi të ketë filluar viti shkollor, ata ende nuk janë të sigurt nëse do të jenë në gjendje të ofrojnë bursa. Ajo gjithashtu tregon se pas përfundimit të një projekti, nuk ka asnjë mekanizëm për të monitoruar vazhdimësinë e ndikimit të tyre në shkolla.

Zyrtari beson se shkollat ende kanë nevojë për mbështetje financiare dhe pajisje teknologjike për të mbështetur fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë për të siguruar që ata mund të vijojnë mësimin në distancë të shkaktuar nga pandemia. Kur u pyet nëse ka monitorim për shkak të pandemisë, ajo deklaroi: "Ai është bërë përmes komunave, ne nuk kemi shumë informata. Organizatat punojnë drejtpërdrejt në terren dhe i vlerësojnë nevojat. MASH-i ofron mësim në distancë për të gjithë fëmijët, përfshirë ata që u përkasin pakicave."

Lidhur me ndonjë plan ose strategji të MASH-it për të mbështetur personat që u përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, veçanërisht si tutorë dhe lehtësues, puna e të cilëve është në rrezik, zyrtari ka theksuar që edhe pse Udhëzimi Administrativ për qendrat mësimore kërkon që personeli të ketë të përfunduar arsimin e lartë, përvoja tani ka lejuar t'u ndihmojë lehtësuesve dhe tutorëve që të mos e rrezikojnë vendin e tyre të punës, ndërsa mbështeten nga organizata të ndryshme me paga.

6. Përfundime dhe rekomandime për autoritetet përkatëse

Përqendrohuni në **zbatimin efektiv** të kornizës legjislative dhe të politikave në lidhje me arsimin gjithëpërfshirës cilësor në përgjithësi, dhe gjithëpërfshirjen sociale të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në veçanti. Në këtë kontekst, **adresoni sistematikisht pengesat**, në nivelin qendror dhe lokal, për të përmbushur qëllimet strategjike në fushën e arsimit gjithëpërfshirës pasi ato zbatohen për personat që u përkasin komuniteteve të cenueshme/të margjinalizuara siç janë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Ndër pengesat që kanë nevojë për vëmendje urgjente dhe sistematike janë mungesa e vullnetit politik, mungesa e burimeve njerëzore dhe financiare dhe qëndrimet dhe perceptimet negative (stereotipike) për komunitetet e cenueshme dhe personat që u përkasin atyre dhe për vlerën e diversitetit si të tillë.

Merrni **përgjegjësinë** për përmbushjen e objektivave strategjike të arsimit brenda afateve të miratuara kohore dhe **planifikoni burimet në përputhje me rrethanat**. **Bashkërendoni aktivitetet me donatorë** në mënyrë që projektet e mbështetura nga donatorët të kontribuojnë në qëllime specifike siç janë planifikuar nga autoritetet përkatëse dhe palët e tjera të interesit (të cilat do të ndihmojnë në kapërcimin e problemit të veprimtarive të udhëhequra nga donatorët dhe në rritjen e **pronësisë lokale** të projekteve dhe rezultateve). Planifikoni aktivitete duke marrë parasysh **qëndrueshmërinë** e tyre dhe **nevojat ekzistuese**, të cilat përcaktohen nga procedurat adekuate për vlerësimin e nevojave. Zhvilloni **mekanizma efektivë të monitorimit** për vlerësimin e zbatimit dhe progresit në lidhje me synimet specifike.

Zhvilloni **veprime specifike** që do të mbështesin autoritetet në nivelin qendror dhe lokal (komunal) për të zbatuar strategjitë kombëtare që aplikohen për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian dhe personat që u përkasin atyre dhe për arsimin gjithëpërfshirës cilësor, dhe/ose veprimet që do të adresojnë problemet specifike të identifikuara nga organet ndërkombëtare të monitorimit, të gjitha në një koordinim të ngushtë me autoritetet në mënyrë që të **shmangin çdo dyfishim** të punës dhe të **rrisin ndikimin** e veprimeve duke e mbështetur **pronësinë kombëtare dhe lokale** të veprimeve, përfshirë përmes një procesi të gjerë pjesëmarrës.

Kapërceni të kuptuarit kryesisht një-dimensional të cenueshmërive dhe zhvilloni programe që do të adresojnë statusin e pakicës së dyfishtë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe personave që u përkasin atyre, si dhe të çdo komuniteti tjetër të cenueshëm/të margjinalizuar. Për këtë qëllim, gjatë hartimit të masave konkrete, vlerësoni përfituesit duke zbatuar konceptin e **ndërthurjes** duke marrë kështu parasysh, ndër të tjera, gjininë, statusin socio-ekonomik, por edhe aftësitë gjuhësore dhe kulturat. E rëndësishmja, pasi që të drejtat e pakicave janë pjesë e të drejtave të njeriut, promovimi dhe mbrojtja e identiteteve kulturore të personave që i përkasin çdo komuniteti duhet të jenë në përputhje me të drejtat e njeriut. Praktikat kulturore që janë diskriminuese ose jo në përputhje me të drejtat universale të njeriut dhe liritë themelore nuk mund të promovohen si të drejta të pakicave.

Aplikoni **qasje të ndjeshme ndaj gjinisë** në të gjitha nivelet, duke përfshirë politikë-bërjen në Ministrinë e Arsimit, për të mbështetur luftimin e niveleve të larta të braktisjes së shkollës nga vajzat që u përkasin këtyre komuniteteve të cenueshme dhe për të synuar në mënyrë efektive

nën-përfaqësimin e vajzave në arsimin parashkollor, si dhe në nivelet më të larta të arsimit (arsimi i mesëm i lartë). **Integrimi gjinor** duhet të aplikohet në të gjitha politikat dhe veprimet në mënyrë që t'i kushtohet vëmendje ndjeshmërive specifike gjinore në fushën e arsimit gjithëpërfshirës, siç aplikohet për personat që u përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Gjatë adresimit të statusit të pakicës së dyfishtë përmes kërkimit të rrugëve për të **ndihmuar personat që u përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për të ruajtur dhe zhvilluar identitetet e tyre etnike, gjuhësore, kulturore dhe/ose fetare**, për të shmangur folklorizimin dhe prezantimin stereotipik, me paragjykim gjinor të komuniteteve të tyre, kulturave dhe historive, dhe për të aplikuar standardet dhe normat ndërkombëtare (të Këshillit të Evropës) në lidhje me të drejtat e pakicave dhe **për të promovuar kompetencat për kulturë demokratike** pasi këto janë thelbësore për zhvillimin e një mjedisi më të gjerë shoqëror që do të pranojë dhe vlerësojë diversitetin dhe në të cilin të gjithë individët do të jenë në gjendje të kontribuojnë në qëllime të tilla si parakusht thelbësor për një shoqëri të larmishme të integruar që do të jetë koherente por edhe e larmishme. E rëndësishmja, zhvilloni programe dhe materiale për mësimdhënie dhe mësimnxënie që do të rrisin vetëdijesimin për këto komunitete si pakica kombëtare në mesin e tërë popullatës dhe perceptimin e këtyre komuniteteve si pjesë përbërëse e vlerësuar e shoqërisë së Kosovës, jo vetëm si komunitete socio-ekonomike që do të (ose duhet të) integrohen në shoqërinë dominuese.

Siguroni që **parimi i pjesëmarrjes efektive** të ndiqet në të gjitha fazat e zhvillimit, zbatimit dhe vlerësimit të projektit. Kjo vlen veçanërisht për personat që u përkasin komuniteteve të cenueshme, si dhe për të gjitha palët e tjera të interesit. Kjo vlen edhe për individë ose zyra përgjegjëse për arsim cilësor dhe për marrëdhënie me komunitete (mbrojtja e pakicave). Në terma praktikë, pjesëmarrja efektive do të fillojë me **vlerësimin e nevojave të të gjitha palëve të interesit**. Palët e interesit do të jenë përfituesit si dhe autoritetet përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, arsimit gjithëpërfshirës për të gjithë, dhe aktorët e tjerë në fushën e arsimit. Shumë projekte janë bazuar në vlerësimin e nevojave të përfituesve ('komunitetet e cenueshme' dhe personat që u përkasin atyre). Është e rëndësishme që këto të vlerësohen rregullisht, por po aq të rëndësishme janë edhe nevojat e atyre që do të ndihmojnë në adresimin e nevojave të atyre përfituesve (autoritetet në të gjitha nivelet, administrata publike, organizatat e shoqërisë civile dhe palët e interesit në sistemin arsimor - mësimdhënësit, drejtorët e shkollave, personeli i shkollës). Kjo të bëhet në bazë të vlerësimit të nevojave të tilla që duhet të zhvillohen veprime të mëtejshme specifike.

Aplikoni një **qasje multi-sektoriale** dhe me **shumë aktorë** për të siguruar arsim cilësor gjithëpërfshirës për të gjithë. Në të njëjtën kohë, përfshini administratën publike që merret me arsim, si dhe administratën publike përgjegjëse për marrëdhënie me komunitete, ose për çështje të grave, ose fëmijët me nevoja të veçanta (arsimore). Zhvilloni një sistem të pjesëmarrjes dhe bashkërendimit efektiv midis të gjitha palëve përkatëse të interesit. Në këtë kontekst, **institucionalizimi i qendrave mësimore** duhet të përshpejtohet dhe të sigurohet mbështetje gjithëpërfshirëse në të gjitha instancat e mos-vijueshmërisë së shkollës ose hendeqeve në rezultatet e arsimit midis popullatës së përgjithshme dhe personave që u përkasin komuniteteve të cenueshme/të margjinalizuara.

Zhvilloni dhe implementoni projekte që miratojnë **qasjen që përfshin tërë shkollën**, që mundësojnë zhvillimin e komuniteteve mësimnxënëse midis mësimdhënësve me një transmetim ndërmjet kolegëve të metodave të mësimdhënies që janë thelbësore për arsimin gjithëpërfshirës.

Zhvilloni aktivitete dhe **programe për forcimin e ekspertizës** brenda ministrive dhe komunave për të qenë në gjendje të mbështesin më mirë shkollat për të zbatuar politikat për arsimin gjithëpërfshirës, si dhe menaxhimin e diversitetit me qëllim të arritjes së integrimit shoqëror duke vlerësuar diversitetin. Kjo duhet të zbatohet për të gjitha nivelet e arsimit, dhe veçanërisht ato ku personat që u përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nuk performojnë mirë bazuar në treguesit e gjithëpërfshirjes sociale.

Aktivitetet e ndërgjegjësimit janë të nevojshme në të gjitha nivelet dhe në kontekste të ndryshme (shoqëria e gjerë, administrata publike, mësimdhënësit dhe personeli i shkollës, prindërit, përfshirë ata që i përkasin komunitetit shqiptar, si dhe nxënësit), mbi të gjitha për të ndihmuar në promovimin dhe mbështetjen e të kuptuarit të diversitetit të shoqërisë kosovare dhe të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe të gjitha komuniteteve të tjera si pjesë e saj e vlerësuar dhe përbërëse, si dhe në aspektin e të kuptuarit dhe zbatimit të arsimit cilësor gjithëpërfshirës për të gjithë.

Punoni me **individë të përkushtuar të cilët kanë qasje të mirë për komunitetet** (ata e kuptojnë gjendjen, janë në gjendje të komunikojnë në një gjuhë të komunitetit, janë të përgatitur të ndërmarrin hapin shtesë për të adresuar nevojat e çdo përfituesi ndërsa kuptojnë kornizën institucionale dhe normative). Projektet dhe rezultatet do të varen kryesisht nga individë të tillë, të cilët duhet të përzgjedhen me kujdes, të trajnohen dhe të shpërblehen në mënyrë adekuate për punën e tyre. Një perspektivë e bazuar në gjini duhet të merret parasysh. Pastaj vlerësoni se si motivimi i individëve mund të mbështetet brenda sistemit, dhe të jetë i zbatueshëm për të gjithë.

Lista e burimeve (përveç projekteve dhe burimeve të renditura në Shtojcën I)

Komiteti Këshillëdhënës, Komentari Tematik i Katërt: Konventa Kornizë: një mjet kryesor për menaxhimin e diversitetit përmes të drejtave të pakicave**.** Fushëveprimi i Zbatimit të Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, 2016.

Komiteti Këshillimor për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Opinioni i Katërt mbi Kosovën* - miratuar më 8 mars 2017, ACFC/OP/IV(2017)001.

Udhëzimi Administrativ (MASHT): 12/2017 për Themelimin dhe Funksionimin e Qendrave Mësimore), aprovuar nga MASHT më 28 gusht 2017, https://kosint2020.net/site/assets/files/1384/ua_masht_nr__12-2017_per_themelimin_dhe_funksionimin_e_qm_pdf.pdf.

Plani Strategjik i Arsimit në Kosovës 2017-2021, korrik 2016, https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-kesp-2017-2021-1.pdf.

Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021, prill 2017, https://www.rcc.int/romaintegration2020/docs/27/strategy-for-inclusion-of-roma-and-ashkali-communities-in-the-kosovo-society-2017-2021--kosovo.

Komisioneri i Lartë i OSBE-së për Pakicat Kombëtare, Udhëzime të Lubjanës për Integrimin e Shoqërive Diverse, 2012, https://www.osce.org/hcnm/ljubljana-guidelines.

Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, A/RES/70/1, Rezoluta e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme më 25 shtator 2015, para. 25, https://www.un.org/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/RES/70/1&Lang=E.

UNESCO: Përfshirja në arsim, https://en.unesco.org/themes/inclusion-in-education.

Zabeli, Naseri, Jeffrey Alvin Anderson dhe Blerim Saqipi. 2018. Drejt zhvillimit dhe zbatimit të arsimimit me nxënës në qendër në Kosovë. *Journal of Social Studies Education Research*, 19(4), f. 49–64.

Shtojca I: Lista e raporteve rreth ndërhyrjeve dhe arritjeve të projekteve të tjera të financuara nga donatorët dhe/ose organizatat e shoqërisë civile në lidhje me gjendjen (veçanërisht në arsim) të fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë

1. Raporti i hulumtimit: Gjendja e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve në 3 komuna, KEC http://www.kec-ks.org/wp-content/uploads/2018/11/A2.1.5.3.-Need-Assessment-ENG-Final-Report.pdf.

2. Regional Synthetical Report, EU-OSI http://www.kec-ks.org/wp-content/uploads/2016/05/Regional-synthesis.pdf.

3. Përfshirja e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parashkollor, KEC http://www.kec-ks.org/wp-content/uploads/2016/04/ENGLISH.pdf.

4. Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021 https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/ANG-STRATEGJIA_P%C3%8BR_P%C3%8BRFSHIRJEN_E_KOMUNITETEVE_ROM_DHE_ASHKALI_N%C3%8B_SHOQ%C3%8BRIN%C3%8B_KOSOVARE_2017-2021.pdf.

5. Anketa Grupore me Shumë Tregues 2013-2014, Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, UNICEF https://microdata.worldbank.org/index.php/catalog/2537 2014 MICS-UNICEF

6. Pasqyra e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, 2020 OSBE https://www.osce.org/mission-in-kosovo/443587.

7. Gjendja e komuniteti rome, ashkali dhe egjiptian ne Kosove, KFOS http://kfos.org/wp-content/uploads/2011/10/Gjendja_e_komuniteteve-Rome_Ashakali_dhe_Egjiptas_ne_Kosove_Raport_i_hulumtimit.pdf.

8. Muri i Antigjipsizmit, Mbrojtësit e të Drejtave Civile https://crd.org/wp-content/uploads/2018/03/The-Wall-of-Anti-Gypsyism-Roma-in-Kosovo.pdf.

9. Historia e Romëve, KiE https://www.coe.int/t/dg4/education/roma/Source/FS/7.0_corr.pdf

10. Historia e Egjiptianëve të Ballkanit, KiE/BE https://www.coe.int/t/dg4/education/ibp/source/FS_1_10.5.pdf.

11. Jetëgjatësia mes romëve, ashkalive dhe egjiptianëve, Balkan Sunflowers Kosova dhe Solidar Suisse Kosovo
http://www.balkansunflowers.org/en/news/life-expectancy-among-roma-ashkali-and-egyptians-in-kosovo/

12. Jetëgjatësia dhe shëndeti në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës, 2016, Balkan Sunflowers Kosova me Solidar Suisse
http://www.balkansunflowers.org/site/assets/files/1103/kosana_annual_report_2015_web.pdf

13. Historia e Identitetit të Ashkalinjëve, KiE/BE
https://www.coe.int/t/dg4/education/ibp/source/2.0_ashkali_albanian_corr.pdf

14. Një hulumtim që shqyrton të drejtat e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë, Save the Children
https://resourcecentre.savethechildren.net/library/research-looking-roma-ashkali-and-egyptian-child-rights

15. Statistikat e arsimit në Kosovë - Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim 2018 -2019

16. Analiza e gjendjes së fëmijëve dhe grave në Kosovë (RKSOKB 1244), tetor 2017, UNICEF
https://www.unicef.org/kosovoprogramme/media/211/file/Raporti_unicef_ENG.pdf.

17. Vlerësimi i Popullsisë së Kosovës 2011
https://ask.rks-gov.net/media/2129/estimation-of-kosovo-population-2011.pdf.

18. Të zhvendosur nga të drejtat. Kthimi i detyrueshëm i romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve nga Evropa Perëndimore, tetor 2010, Human Rights Watch
https://www.hrw.org/report/2010/10/27/rights-displaced/forced-returns-roma-ashkali-and-egyptians-western-europe-kosovo.

18. Kosova e pasluftës dhe politikat e saj ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, 2014, Shkolla e Shëndetit Publik të Harvardit
https://childhub.org/en/system/tdf/library/attachments/fxb-kosovo-report-july-2014.pdf?file=1&type=node&id=10511

19. Ndikimi i qendrave mësimore në gjithëpërfshirjen e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në arsim (2018) Projekti "Iniciativa e Kosovës për Integrim 2020 - KOSINT"https://www.keen-ks.net/site/assets/files/1446/qm_ne_kosove-_eng.pdf.

20. KEEN: Vlerësimi afatmesëm: Zbatimi i Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021, nëntor 2019, http://kosovoprojects.eu/wp-content/uploads/2020/02/Implementation-of-Kosovo-Education-Strategic-Plan.pdf

21. Analizë e shpejtë. Përfshirja e fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parashkollor dhe fillor (Prizren, Gjakovë dhe Ferizaj), KEC, dhjetor 2015 http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2016/04/ENGLISH.pdf.

22. Perspektiva e të rinjve rom, ashkali dhe egjiptian mbi mundësitë dhe sfidat për punë të denjë në Kosovë: Gjakovë, Fushë Kosovë dhe Graçanicë, ONP https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/wcms_648875.pdf.

23. Anketë mbi arsimin gjithëpërfshirës në dhjetë shkolla fillore të Kosovës, Projekti i Përbashkët BE/KiE "ACCESS" https://www.coe.int/documents/3843514/13597853/Survey+on+Inclusive+Education+in+Ten+Primary+Schools.pdf/da34373b-ee22-443a-b21b-f6fb55f68cd4

24. STUDIMI MBI NDIKIMIN DHE QËNDRUESHMËRINË E QENDRAVE MËSIMORE, UBO Counsulting nën projektin e BE/KiE-së "ACCESS" http://www.coe.int/documents/3843514/13597853/Study_on_Impact_and_Sustainability_of_the_Learning_Centers-En.pdf/4a76eefe-21d0-432c-800c-ad234f77f4a2

25. Libri me ngjyra: Historia e Qendrave Mësimore, KFOS dhe KEC
http://kfos.org/wp-content/uploads/2013/03/The-Colorful-Book-4-languages.pdf

Plani lokal i veprimit 2017-2021 për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, zhvilluar nën rrjetin KEEN

26. Plani lokal i veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Ferizajt 2017-2021

27. Plani lokal i veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës 2018-2022

28. Plani lokal i veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Lipjanit 2018-2022

29. Plani lokal i veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Gjakovës, 2018-2022

30. Plani lokal i veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Graçanicës 2018-2022

31. Plani lokal i veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prizrenit 2019-2023

Të gjitha planet gjenden këtu: https://www.keen-ks.net/en/publications/local-action-plans-for-communities.

32. Raporti i Vlerësimit mbi Zbatimin e Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017, i krijuar nën rrjetin KEEN
https://www.keen-ks.net/en/publications/raportet-e-monitorimit/

33. Gjendja e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunat e Kosovës. Raporti i monitorimit për zbatimin e planeve lokale të veprimit në fushën e arsimit dhe punësimit në gjashtë (6) komuna të Kosovës: Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë dhe Lipjan, nga projekti "Rrjeti

i Kosovës për Arsim dhe Punësim" - KEEN", nëntor 2019, https://www.keen-ks.net/site/assets/files/1475/raporti_i_monitorimit_per_komunitetet_eng.pdf.

34. Gjendja e arsimit në komunat e Kosovës - Raporti i monitorimit të zbatimit të planeve strategjike të arsimit në nëntë (9) komuna të Kosovës: Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë, Dragash dhe Suharekë, projekti "Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim - KEEN". https://www.keen-ks.net/en/publications/raportet-e-monitorimit-2018/.

35. Planet Zhvillimore të Arsimit në Komuna. Planet Zhvillimore të Arsimit u përgatitën në nëntë komuna të Kosovës: Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë, Dragash dhe Suharekë. Kjo është bërë nën projektin "Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim - KEEN".

Për të gjitha planet shih: https://www.keen-ks.net/en/publications/education-strategic-plans/

36. Komiteti Këshillimor për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Opinioni i Katërt mbi Kosovën* - miratuar më 8 mars 2017, ACFC/OP/IV(2017)001, gjendet në http://rm.coe.int/fourth-opinion-on-kosovo-adopted-on-8-march-2017/1680779af8

37. Studim shoqërues për zbatimin e aktiviteteve të projektit CDBE të GIZ-it. Komponenti për gjithëpërfshirjen arsimore të të kthyerve dhe pakicave etnike, GIZ, nëntor 2018.

38. Përmirësimi i ofrimit të arsimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian: Praktikat më të mira dhe Rekomandimet, Doracak për Zyrtarët Komunalë, Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë, 2012, http://www.ecmikosovo.org/en/Studies-and-handbooks/Improving-the-Delivery-of-Education-for-Roma--Ashkali-and-Egyptian-Communities-Good-Practices-and-Recommendations

39. Programi i përbashkët ndërmjet BE-së dhe Këshillit të Evropës: "Ngritja e qasjes në arsimim dhe mirëkuptimi ndërkulturor: Mbështetja e BE/KiE-së në fushën e arsimit për të kthyerit e detyruar dhe për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë*". Është zhvilluar kurrikula për kursin e trajnimit të mësimdhënësve në vend pune, me titull Shkollat gjithëpërfshirëse që mbështesin arsimin e fëmijëve romë, ashkali, egjiptianë dhe të kthyer, Prishtinë, 2015.

40. Mbështetja e qasjes në arsim dhe mirëkuptimi ndërkulturor: Udhëzime për mësimdhënësit për Përfshirjen Sociale të Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve në shkolla, financuar nga BE-ja dhe zbatuar nga Këshilli i Evropës, 2015.

Më shumë informata
www.coe.int/education

Kontakti
Zyra e Këshillit të Evropës
17/18 Rruga Bedri Pejani
10000 Prishtinë

Email: **coe.pristina@coe.int**
Tel: 383 (0) 38 407 750
Faksi: +383 (0) 38 407 751

ALB

Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku njohuritë, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ato kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm duke ruajtur diversitetin kulturor, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është zotuar të shkëmbejë arritjet dhe vlerat e veta me vendet dhe popujt përtej kufijve të tij.

www.europa.eu

Këshilli i Evropës është organizatë lidere e kontinentit për të drejtat e njeriut. Ai përbëhet nga 47 shtete anëtare, duke i përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat i projektuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikëqyr zbatimin e Konventës në shtetet anëtare.

www.coe.int

EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE